

(3) Gjykatësi i gjykatës së shkallës së parë merr vendimin mbi kërkesën për përsëritjen e procedurës (neni 406 paragrafi 1) dhe paraqet propozimin me rastin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit (neni 414 paragrafi 3).

(4) Organi kompetent republikan, respektivisht krahinor cakton gjykatat nga paragrafi 1 i këtij neni, pranë të cilave do të aplikohen dispozitat e paragrafeve 1 deri 3 të këtij neni.

Neni 556

Kur në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është në rrjedhim e sipër ndonjë afat, ky afat do të llogaritet sipas dispozitave të këtij ligji, përveç kur afati i gjertanishëm është më i gjatë.

Neni 557

Dispozitat e nenit 445 të këtij ligji do të aplikohen nga dita e caktuar me ligjin republikan, respektivisht krahinor.

Neni 558

(1) Dispozitat e Kodit mbi procedurën penale që kanë të bëjnë me ndjekjen për veprat penale me propozimin e të dëmtuarit, do të aplikohen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, po që se deri në atë kohë, në bazë të propozimit të paraqitur, akuzë është ngritur.

(2) Kur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me rastin e mjetit të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm juridik është prishur aktgjykimi ose është lejuar përsëritja e procedurës për veprën penale që ndiqet me propozimin e të dëmtuarit, dhe e cila pas hyrjes në fuqi të këtij ligji ndiqet kryesisht, i dëmtuari nuk mundet më të heqë dorë nga propozimi. Kur kjo vepër penale pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndiqet sipas padisë private, propozimi i të dëmtuarit do të konsiderohet si padë private dhe procedura e mëtejshme do të zbatohet sipas kësaj padie.

Neni 559

Kur i dëmtuari ka hequr dorë nga propozimi për ndjekje deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, procedura për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, parashikuar në nenin 92 paragrafi 5 të Kodit mbi procedurën penale, do të zbatohet edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, po që se deri atëherë nuk ka rrfunduar.

Neni 560

(1) Kur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është marrë vendimi kundër të cilit sipas dispozitave të Kodit mbi procedurën penale është lejuar mjeti juridik, e ky vendim ende nuk u është dërguar personave që kanë të drejtën e mjetit juridik, ose ende rrjedh afati për paraqitjen e mjetit juridik, ose mjeti juridik është paraqitur, por lidhur me të ende nuk është vendosur, do të aplikohen lidhur me të drejtën e mjetit juridik dhe me procedurën sipas mjetit juridik, dispozitat e Kodit mbi procedurën penale.

(2) Kur në Gjykatën Federative në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji gjenden të pazgjidhura lëndët, sipas mjetit juridik për zgjidhjen e të cilave nuk është më kompetent ajo gjykatë, këto lëndë do të dërgohen gjykatës kompetente për vendosjen sipas këtij ligji.

Neni 561

Në pikëpamje të kompensimit të dëmit personave të dënuar paarsyeshëm dhe të privuar pa baza nga liria, dispozita e nenit 7 të Ligjit hyrës për Kodin mbi procedurën penale («Gazeta zyrtare e RFPJ», nr. 40/53) aplikohet edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 562

Dispozita e nenit 6 e Ligjit hyrës për Kodin mbi procedurën penale («Gazeta zyrtare e RFPJ», nr. 40/53) do të aplikohet edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në përsëritjen e procedurës penale të përfunduar në formë të prerë para 1 janarit të vitit 1954.

Neni 563

Dispozitat e neneve 425 deri 429 të këtij ligji do të zbatohen vetëm në pikëpamje të aktgjykimit për veprat penale të kryera pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 564

Kur me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, ditën e hyrjes së tij në fuqi çfuqizohen Kodi mbi procedurën penale («Gazeta Zyrtare e RSFJ», nr. 50/67, 54/70 dhe 6/73), rregullat që janë nxjerrë në bazë të këtij kodi dhe dispozitat e rregullave të tjera që janë në kundërshtiri me këtij ligj.

Neni 565

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 1977.

37.

Në mbështetje të nenit 337 pika 1 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nxjerrim këtë

D E K R E T

MBI SHPALLJEN E LIGJIT MBI PROCEDURËN KONTTESTIMORE

Shpallet Ligji mbi procedurën kontestimore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 24 dhjetor 1976.

PR Nr. 555

Beograd, më 24 dhjetor 1976

Kryetari i Republikës,

Josip Broz Tito, d. v.

Kryetari
i Kuvendit të RSFJ
Kiro Gligarev, d. v.

L I G J

MBI PROCEDURËN KONTTESTIMORE

Pjesa e parë

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kreu i parë

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj caktohen rregullat e procedurës në bazë të të cilave gjykata ordinare shqyrton dhe vendos në kontestet nga marrëdhëniet personale e familjare, nga marrëdhëniet e punës, si dhe nga marrëdhëniet pasurore dhe nga marrëdhëniet e tjera civilo-juridike të personave fizikë e të personave civilë juridikë, të bashkësive shoqërore-politike, të organizatave të punës së bashkuar e të personave shoqërorë-juridikë të tjerë, përveç në qoftë se disa nga kontestet e theksuara janë vënë me ligj të veçantë në kompetencë të gjykatës tjetër ose të organit shtetëror, respektivisht të organit shoqëror.

Neni 2

Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë vënë në procedurë.

Gjykata nuk mund të refuzojë të vendos mbi kërkesën për të cilën është kompetente.



Neni 3

Palët mund të disponojnë lirisht kërkesat që i kanë shtruar gjatë procedurës.

Ato mund të heqin dorë nga kërkesa e vet, ta njohin kërkesën e kundërshtarit dhe të pajtohen.

Gjykata nuk do t'i aprovojë disponimet e palëve:

1) që janë në kundërshtim me dispozitat imperative mbi të drejtat vetëqeverisëse të punonjësve, mbi disponimin e mjeteve shoqërore dhe me dispozitat të tjera imperative;

2) që janë në kundërshtim me rregullat e moralit të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste.

Neni 4

Gjykata vendos mbi kërkesë-padinë, si rregull, në bazë të shqyrtimit verbal, direkt dhe publik.

Neni 5

Gjykata do t'i japë mundësi secilës palë që të deklarohej rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

Vetëm kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj, gjykata është e autorizuar të vendos mbi kërkesën mbi të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohej.

Neni 6

Procedura kontestimore zhvillohet në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe shkrimin e vet dhe t'u dërgohen letrat në gjuhët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë në pajtim me dispozitat e ligjit.

Neni 7

Gjykata ka për detyrë që krejtësisht dhe saktësisht të vërtetojë faktet kontestuese, nga të cilat vare bazueshmëria e kërkesës.

Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet në të cilat i bazojnë kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat i përcaktojnë këto fakte.

Gjykata është e autorizuar të paraqes edhe prova të cilat palët nuk i kanë propozuar, po që se këto prova kanë rëndësi për marrjen e vendimit.

Gjykata është e autorizuar t'i vërtetojë edhe faktet të cilat nuk i kanë paraqitur palët, në qoftë se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët shkojnë drejt asaj që të disponojnë kërkesa të cilat nuk mund t'i disponojnë (neni 3 paragrafi 3).

Neni 8

Se cilat fakte do t'i marrë si provues vendos gjykata sipas bindjes së vet, në bazë të çmuarjes së ndërgjegjshme e të kujdesshme të çdo prove veç e veç dhe të të gjitha provave së bashku, si dhe në bazë të rezultetit të krejt procedurës.

Neni 9

Palët kanë për detyrë që para gjykatës të flasin të vërteten dhe t'i shfrytëzojnë me ndërgjegje të drejtat që u janë njohur me këtë ligj.

Neni 10

Gjykata ka për detyrë të përpigjet që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe me sa më pak shterzime e të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të drejtash që u takojnë palëve në procedurë.

Neni 11

Gjykata do ta paralajmërojë palën, e cila nga mosdija nuk i shfrytëzon të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji, për veprimet kontestimore që mund t'i ndërmarë.

Neni 12

Kur vendimi i gjykatës varret nga zgjidhja paraprake e çështjes nëse ekziston ose jo ndonjë e drejtë

apo marrëdhënie juridike, kurse mbi këtë çështje ende nuk ka marrë vendim gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja paraprake), gjykata mund ta zgjidhë vetë këtë çështje, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe.

Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në kontestimin ku është zgjidhur kjo çështje.

Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e obliguar me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është deklaruar fajtor.

Neni 13

Në procedurën kontestimore gjykatat gjykojnë në përbërje kolektive.

Me ligj caktohet se në cilat raste gjykon gjyqtari i vetëm.

Neni 14

Në qoftë se për veprime të veçanta nuk është caktuar me ligj forma në të cilën mund t'i ndërmarrin, palët ndërmartin veprime kontestimore me shkrim jashtë seancës ose verbalisht në seancë.

Kreu i dytë

KOMPETENCA DHE PËRBËRJA E GJYKATËS

1. Dispozitat e përbashkëta

Neni 15

Gjykata vlerëson kryesisht, menjëherë pas marrjes së padisë, nëse është kompetente dhe në cilën përbërje është kompetente.

Ky vlerësim i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata.

Në qoftë se gjatë procedurës ndryshohen rrethanat në të cilat është bazuar kompetenca e gjykatës, apo në qoftë se paditësi e pakëson kërkesë-padinë, gjykata, e cila ka qenë kompetente në kohën e paraqitjes së padisë, mbetet gjithnjë kompetente megjithëse për shkak të këtyre ndryshimeve do të ishte kompetente gjykata tjetër ordinare e të njejtit lloj.

Neni 16

Gjykata, gjatë krejt procedurës, kujdeset kryesisht nëse zgjidhja e kontestit hyn ose jo në kompetencën gjyqësore.

Kur gjykata gjatë procedurës vërteton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente as gjykata ordinare dhe as gjykata e punës së bashkuar e gjykata tjetër vetëqeverisëse, e themeluar me ligj ose me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës, por ndonjë organ tjetër i vendit apo i huaj, do të deklarohej inkompetente, do t'i abrogojë veprimet e zbatuara në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Neni 17

Secila gjykatë gjatë krejt procedurës kujdeset kryesisht për kompetencën e vet lëndore.

Në qoftë se është mbajtur seanca pregaditore, apo në qoftë se ajo nuk është mbajtur sepse i padituri në seancën e parë për në seancën kryesore ka hyrë në shqyrtim rreth çështjes kryesore, gjykata më e lartë e shkallës së parë, si me rastin e kundërshtimit ashtu edhe kryesisht nuk mund të deklarohej me inkompetencë lëndore për objektet nga kompetenca e gjykatës më të ulët të shkallës së parë të të njejtit lloj.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të lartë të shkallës së parë, me të cilin është deklaruar me kompetencë lëndore, si dhe kundër aktvendimit me të cilin kjo gjykatë është deklaruar me inkompetencë lëndore dhe objekti i është ceduar gjykatës më të ulët të shkallës së parë të të njejtit lloj, nuk lejohet ankimi.

Neni 18

Kur kolegji gjyqësor, gjatë procedurës, apo kryetari i kolegjit në seancën pregaditore, kryesisht ose me rastin e kundërshtimit të palëve, vërteton se është fjala për kontestin që duhet të gjykohej nga gjyqtari i vetëm i së njetës gjykatës, procedura, kur ky aktivendimi të ketë marrë formën e prerë, do të vazhdojë para gjyqtarit të vetëm, mundësisht para kryetarit të këtij kolegji si gjyqtar të vetëm. Gjyqtari i vetëm është i obliguar nga vendimi i formës së prerë, me të cilin i cedohet objekti në kompetencë.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni kolegji mundet, sipas gjendjes së procedurës, të vendosë që objektin të mos ia cedojë gjyqtarit të vetëm, por që ai vetë ta zbatojë procedurën. Kundër këtij vendimi të kolegjit nuk lejohet ankimi.

Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni do të aplikohen edhe kur gjatë procedurës para kolegjit të ndryshohen rrethanat ose paditësi e pakëson kërkesë-padinë, kështu që kontestimi duhet të gjykohej nga gjyqtari i vetëm.

Në qoftë se kolegji e ka marrë vendimin mbi kontestin, i cili do të duhej të gjykohej nga gjyqtari i vetëm, ky vendim nuk mund të kundërshtohet për arsye se vendimin mbi kontestin nuk e ka marrë gjyqtari i vetëm.

Kur gjyqtari i vetëm gjatë procedurës, kryesisht ose me rastin e prapësimit të palëve, konstaton se për gjykim është kompetent kolegji i së njetës gjykatës, procedura do të vazhdojë para kolegjit. Kundër këtij aktivendimi të gjyqtarit të vetëm nuk lejohet ankimi.

Neni 19

Deri sa të merret vendimi mbi çështjen kryesore gjykata do ta pezullojë me aktivendim procedurën kontestimore në qoftë se vërteton se procedura do të duhej të zbatohet sipas rregullave të procedurës jashtëgjyqësore. Procedura do të vazhdojë pasi aktivendimi të ketë marrë formën e prerë sipas rregullave të procedurës jashtëgjyqësore para gjykatës kompetente.

Veprimet që i ka zbatuar gjykata kontestimore, (këqyrja në vend, ekspertimi, dëgjimi i dëshmitarëve etj.) si dhe vendimet që i ka marrë kjo gjykatë, nuk janë të parëndësishme vetëm sepse janë ndërmarrë në procedurën kontestimore.

Neni 20

Gjykata mundet kryesisht ose me rastin e kundërshtimit të të paditurit të deklarohet me inkompetencë territoriale jo më vonë se në seancën pregaditore ose, në qoftë se ajo nuk është mbajtur, deri në hyrjen e të paditurit në shqyrtim rreth çështjes kryesore në seancën kryesore.

Neni 21

Pasi të ketë marrë formën e prerë aktivendimi me të cilin është deklaruar inkompetente (nenet 18 dhe 20), gjykata do t'ia cedojë objektin gjykatës kompetente ordinare, respektivisht gjykatës vetëqeverisëse (neni 16 paragrafi 2). Para se t'ia cedojë objektin gjykatës kompetente, gjykata, sipas nevojë, do të kërkojë njoftime nga paditësi.

Gjykata të cilës i është ceduar objekti si kompetente do të vazhdojë procedurën sikurse kjo të ishte filluar pranë saj.

Në qoftë se vendimi mbi inkompetencën është marrë në seancën kryesore, gjykata të cilës i është ceduar objekti, do të thërras seancën kryesore dhe do të veprojë sikur seanca të mbahet para kolegjit të ndryshuar (neni 315 paragrafi 3). Në qoftë se vendimi mbi inkompetencën është marrë në seancën pregaditore, atëherë do të thirrret seanca e re pregaditore, në qoftë se kryetari i kolegjit konsideron se kjo atëherë nevojitet duke marrë parasysh veprimet e ndërmarrura në seancën pregaditore të mëparshme.

Veprimet kontestimore të gjykatës inkompetente (këqyrja në vend, ekspertimi, dëgjimi i dëshmitarëve

etj.) nuk janë të parëndësishme vetëm sepse i ka ndërmarrë gjykata inkompetente.

Neni 22

Në qoftë se gjykata të cilës i është ceduar objekti si kompetente konsideron se është kompetente gjykata që ia ka ceduar objektin ose ndonjë gjykatë tjetër, do t'ia dërgojë objektin gjykatës që duhet ta zgjidhë këtë konflikt kompetencash, përveç në qoftë se konstaton se objekti është ceduar për shkak të gabimit të hapur, kurse është dashur t'i cedohet ndonjë gjykatë tjetër, në të cilin rast objektin do t'ia cedojë gjykatës tjetër dhe për këtë gjë do të njoftojë gjykatën që ia ka ceduar objektin.

Kur me rastin e ankimit kundër vendimit të gjykatës të shkallës së parë, me të cilin ajo është deklaruar me inkompetencë territoriale, vendimin e ka marrë gjykata e shkallës së dytë, për këtë vendim obligohet në pikëpamje të inkompetencës edhe gjykata të cilës i është ceduar objekti, në qoftë se gjykata e shkallës së dytë, që e ka marrë vendimin, është kompetente për të vendosur mbi konfliktin e kompetencave midis këtyre gjykatave.

Vendimi i gjykatës të shkallës së dytë mbi inkompetencën lëndore të gjykatës të shkallës së parë obligon çdo gjykatë të cilës i cedohet më vonë objekti i njëjtë, në qoftë se gjykata e shkallës së dytë është kompetente për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave midis këtyre gjykatave.

Neni 23

Konflikti i kompetencave midis gjykatave ordinare të të njejtës lloji nga territori i së njetës republikë, respektivisht i së njetës krahinë autonome, përveç konfliktit të kompetencave midis gjykatave ushtarake, vendoset bashkarisht direkt nga gjykata më e lartë nga territori i kësaj republike, respektivisht i kësaj krahine autonome, në qoftë se me kushtetutën e republikës, respektivisht të krahinës autonome nuk është caktuar ndryshe.

Konflikti kompetencash midis gjykatave ordinare të llojeve të ndryshme nga territori i së njetës republike, respektivisht i së njetës krahinë autonome, përveç konfliktit të kompetencave midis gjykatave ushtarake dhe gjykatave të tjera ordinare, vendoset nga gjykata supreme e kësaj republike, respektivisht e kësaj krahine autonome.

Konflikti i kompetencave midis gjykatave ordinare dhe gjykatave vetëqeverisëse (neni 16 paragrafi 2) nga territori i së njetës republikë, respektivisht i së njetës krahinë autonome, përveç konfliktit të kompetencave midis gjykatave ushtarake dhe gjykatave vetëqeverisëse, (neni 16 paragrafi 2), vendoset nga gjykata supreme e kësaj republike, respektivisht e kësaj krahine autonome.

Konflikti i kompetencave midis gjykatave nga territori i dy krahinave autonome ose midis gjykatave nga territori i krahinës autonome dhe nga territoret e tjera të Republikës Socialiste të Serbisë, përveç konfliktit të kompetencave midis gjykatave ushtarake dhe gjykatave të tjera, vendoset nga gjykata e caktuar me kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë.

Konflikti i kompetencave midis gjykatave nga territori i dy apo i më tepër republikave dhe krahinave autonome, përveç në rastet nga paragrafi 4 i këtij neni, si dhe mbi konfliktin e kompetencave midis gjykatave ushtarake dhe gjykatave të tjera vendoset nga Gjykata Federative.

Neni 24

Mbi konfliktin e kompetencave mund të vendoset edhe kur palët nuk janë deklaruar më përpara mbi kompetencat.

Për derisa të mos zgjidhet konflikti i kompetencave, gjykata të cilës i është ceduar objekti, ka për detyrë të ndërmarrë ato veprime në procedurë për të cilat ekziston rreziku i shtytjes.

Kundër aktvendimit, me të cilin vendoset mbi konfliktin e kompetencave, nuk lejohet ankimi.

Neni 25

Secila gjykatë ushtron veprime në procedurë në zonën e vet, por në qoftë se ekziston rreziku i shtytjes, gjykata do të ndërmarrë kryerjen e disa veprimeve edhe në zonën e gjykatës fqinje. Për këtë gjë do ta njoftojë gjykatën në zonën e së cilës është ndërmarr veprimi.

Neni 26

Në pikëpamje të kompetencës së gjykatave jugosllave për gjykim të huajve që gëzojnë të drejtën e imunitetit në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe për gjykim shteteve të huaja në organizatat ndërkombëtare aplikohen rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

Në rast dyshimi mbi ekzistimin dhe mbi volumin e të drejtës së imunitetit, spjegimin e jep organi federativ i administratës me kompetencë për punët e judikaturës.

2. Kompetenca e gjykatave në kontestet me element ndërkombëtar

Neni 27

Gjykata jugosllave është kompetente të gjykojë kur kompetenca e saj në kontest me elementin ndërkombëtar është caktuar shprehimisht me ligjin federativ ose me traktatin ndërkombëtar, apo kur kjo kompetencë rezulton nga dispozitat e ligjit federativ mbi kompetencën territoriale të gjykatës jugosllave.

Neni 28

Për gjykim në kontestet e ushqimit ligjor, po qe se është paditës personi që kërkon ushqim të tillë, gjykata jugosllave është kompetente edhe kur paditësi ka vendbanim, respektivisht vendqendrim në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 29

Për gjykim në kontestet për vërtetimin e qënies apo të mosqënies së martesës, të anulimit të martesës apo të zgjidhjes së martesës (kontestet martesore) është kompetente gjykata jugosllave në qoftë se të dy bashkëshortë janë shtetas të RSFJ apo në qoftë se vetëm njëri prej tyre është shtetas i RSFJ.

Në qoftë se asnjë bashkëshort nuk është shtetas i RSFJ, për gjykim në kontestet martesore është kompetente gjykata jugosllave vetëm në qoftë se ligji kombëtar i të dy bashkëshortëve e lejon këtë kompetencë dhe në qoftë se bashkëshortët kanë pasur në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë vendbanimin e tyre të përbashkët të fundit apo në qoftë se i padituri ka vendbanimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Po qe se ligji kombëtar i bashkëshortëve nuk e lejon kompetencën e gjykatës jugosllave, kjo gjykatë mund të jetë kompetente vetëm në qoftë se të dy bashkëshortë kanë vendbanimin e tyre në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe në qoftë se e pranojnë që t'u gjykojë gjykata jugosllave.

Për gjykim në kontestet martesore, po qe se i padituri është shtetas i RSFJ dhe ka vendbanimin, respektivisht vendqendrimin në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, është kompetente vetëm gjykata jugosllave.

Neni 30

Për gjykim në kontestet për vërtetimin ose për kontestimin e atësisë apo të amësisë është kompetente gjykata jugosllave po qe se të paktën njëra palë është shtetase e RSFJ.

Në qoftëse asnjëra palë nuk është shtetase e RSFJ, gjykata jugosllave është kompetente po qe se

i padituri ka vendbanimin, respektivisht vendqendrimin në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, a po qe se padinë e paraqet fëmija, gjykata jugosllave është kompetente edhe në qoftë se fëmija ka vendbanimin, respektivisht vendqendrimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Në qoftë se padia është paraqitur kundër fëmijës që është shtetas i RSFJ dhe ka vendbanimin, respektivisht vendqendrimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, është kompetente vetëm gjykata jugosllave.

Neni 31

Për derisa procedura e trashëgimisë që zbatohet para gjykatës jugosllave të mos përfundojë në formë të prerë, për gjykim në kontestet nga marrëdhëniet trashëgimore juridike, si dhe në konteste mbi kërkesat e kreditorit ndaj trashëgimlënësit, është kompetente gjykata jugosllave edhe kur i padituri nuk ka vendbanimin, respektivisht vendqendrimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 32

Për gjykim në kontestet mbi të drejtën e shfrytëzimit e të disponimit dhe mbi të drejtën e pengut në mjetin ajror, anijen detare dhe anijen e lundrimit të brendshëm në pronësi shoqërore, mbi të drejtën e pronësisë dhe mbi të drejtat e tjera në anijet e në mjetet ajrore në pronësinë e qytetarëve e të personave civilë juridikë, si dhe mbi marrëdhëniet e qiramarjes në mjetin ajror dhe në anijen, gjykata jugosllave është kompetente edhe kur në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë mbahet regjistri ku është regjistruar mjeti ajror, respektivisht anija.

Për gjykim në kontestet për pengimin e posedimit në mjetin ajror dhe në anijen nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata jugosllave është kompetente edhe kur në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë mbahet regjistri ku mjeti ajror, respektivisht anija është regjistruar, apo kur në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ka ndodhur pengimi.

3. Kompetenca lëndore

Neni 33

Në procedurën kontestimore gjykatat në republikat dhe në krahinat autonome gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligjin republikan, respektivisht me ligjin krahinor.

Gjykata Federative

Neni 34

Gjykata Federative është kompetente:

1) të gjykojë mbi kontestet pasurore midis republikave, respektivisht krahinave autonome dhe midis Federatës dhe republikës, respektivisht krahinës autonome;

2) të vendos mbi kërkesën e palëve për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë të marrë në kontestet pasurore, duke përfshirë edhe kontestet mbi shpërbëimin e dëmit, që lindin nga veprimet juridike kundërkushtetuese dhe kundërligjore apo nga veprimet me të cilat organizatat e punës së bashkuar ose punonjësit në territorin e republikave dhe të krahinave autonome të tjera, e si rrjedhim edhe republikat e krahinat autonome të tjera, vihen në një pozitë të pabarabartë në tregun unik jugosllav (neni 416);

3) të vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet e caktuara me këtë ligj;

4) të vendos mbi konfliktin e kompetencave midis gjykatave nga territori i dy apo i më shumë republikave dhe krahinave autonome, përveç në rastet nga

neni 23 paragrafi 4 të këtij ligji, si dhe mbi konfliktin e kompetencave midis gjykatave ushtarake dhe gjykatave të tjera;

5) të ushtrojë edhe veprime të tjera që i janë vënë në kompetencë me ligjin federativ, në kuadrin e të drejtave dhe të detyrave të Federatës.

Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 35

Kur për përcaktimin e kompetencës lëndore, të përbërjes së gjykatës, të së drejtës për deklarimin e revizionit e në raste të tjera të parashikuara në këtë ligj është kompetente vlera e objektit të kontestit, si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.

Kamatat, shpenzimet e kontestimit, penalitetet dhe kërkesat e tjera aksesore nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore.

Neni 36

Në qoftë se kërkesa ka të bëjë me dhëniet e dhshme që përsëriten, vlera e objektit të kontestit llogaritet sipas shumës totale të tyre, por jo më tepër se deri në shumën që i përgjigjet shumës totale të dhënieve për një kohë prej pesë vjetësh.

Neni 37

Në qoftë se njëra padi kundër të njejtit të paditur përfshin disa kërkesa që bazohen në të njejtën bazë faktike dhe juridike, kompetenca caktohet sipas totalit të vlerës së të gjitha kërkesave.

Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë theksuar kundër disa të paditurëve, kompetenca caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë të veçantë.

Neni 38

Kur kontesti zhvillohet mbi ekzistimin e raportit mëditës apo të qirasë, ose nga raporti i shfrytëzimit të banesës apo i lokaleve të punës, vlera llogaritet sipas shumës njëvjeçare të mëditjes, respektivisht të qirasë, përveç në qoftë se është fjala për raportin mëditës apo të qirasë të përfundur për një kohë më të shkurtër.

Neni 39

Në qoftë se me padinë kërkohet vetëm dhënia e kurisë për ndonjë kërkesë apo për vendosjen e të drejtës së pengut, vlera e objektit të konfliktit caktohet sipas shumës së kërkesës që duhet siguruar. Në qoftë se objekti i pengut ka një vlerë më të vogël nga sa është kërkesa që duhet siguruar, si vlerë e objektit të kontestit do të merret vlera e objektit të pengut.

Neni 40

Në qoftë se kërkesë-padia nuk ka të bëjë me shumën e parave, por paditësi në padinë thekson se pranon që në vend të përmbushjes së kësaj kërkesë të marrë një shumë të caktuar të hollash, si vlerë e objektit të kontestit do të merret kjo shumë.

Në raste të tjera, kur kërkesë-padia nuk ka të bëjë me shumën e të hollave, është kompetente vlera e objektit të kontestit, të cilën e ka theksuar paditësi në padinë.

Në qoftë se në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni paditësi e ka theksuar pa dyshim tepër larg ose shumë pak vlerën e objektit të kontestit, kështu që shtrihet pyetja e kompetencës lëndore, të përbërjes së gjykatës apo të së drejtës së deklarimit të revizionit, gjykata, jo më vonë-se në seancën pregatitore, e në qoftë se seanca pregatitore nuk është mbajtur atëherë në seancën kryesore para fillimit të shqyrtimit rreth çështjes kryesore, do ta verifikojë shpejtë e në mënyrë të përshtatshme saktësinë e vlerës së theksuar.

4. Përbërja e gjykatës

Neni 41

Në procedurën kontestimore gjykata gjykojnë në kolegji, kurse gjykatat e caktuara edhe në seancën e përgjithshme.

Në cilat raste gjykon gjyqtari i vetëm kjo gjë caktohet me këtë ligj, kurse me ligjin e republikës, respektivisht të krahinës autonome — për veprimet në sferat në të cilat marrëdhëniet shoqërore i rregullojnë republikat, respektivisht krahinat autonome.

Kryetari i kolegjit mund të ndërmarrë vetëm ato veprime në procedurë dhe të marrë vetëm ato vendime, për ndërmarrjen, respektivisht për marrjen e të cilave është i autorizuar me këtë ligj.

Në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, gjyqtari i vetëm në vendosjen mbi çështjen nga kompetenca e vet ka të gjitha të drejtat dhe detyrat që i takojnë kryetarit të kolegjit dhe kolegjit.

Neni 42

Kontestet në shkallë të parë i gjykon kolegji ose gjyqtari i vetëm.

Kur gjykon në shkallë të parë, kolegji përbëhet prej një gjyqtari si kryetar i kolegjit dhe prej dy ndihmësgjyqëtarësh.

Neni 43

Gjyqtari i vetëm gjykon kontestet mbi kërkesat pasurore-juridike, në qoftë se vlera e objektit të kontestit nuk i kapërcen 20.000 dinarë, si dhe kontestet për pengimin e posedimit.

Kontestet nga e drejta e autorit, si dhe kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtjen ose me përdorimin e shpikjeve dhe të përparimeve teknike të mostrave, të modeleve ose të damkave, apo të së drejtës së përdorimit të firmës ose të emrit i gjykon në shkallë të parë kolegji, pavarësisht nga vlera e objektit të kontestit.

Gjyqtari i vetëm zbaton procedurën dhe merr vendim në objektet e ndihmës juridike.

Neni 44

Kur gjykon në shkallë të dytë në seancën e kolegjit, gjykata vendos në kolegji të përbërë nga tre gjyqtarë. Në të njejtën përbërje gjykata më e lartë vendos mbi konfliktin e kompetencave (neni 23) dhe vendos në të gjitha rastet e tjera, në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Kur gjykon në shkallë të dytë në shqyrtim, kolegji i gjykatës së shkallës së dytë përbëhet nga dy gjyqtarë dhe tre ndihmësgjyqëtarë.

Kur vendos mbi revizionin dhe mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatës të shkallës më të ultë, gjykata supreme në republikë, respektivisht në krahinë autonome gjykon në kolegji të përbërë nga pesë gjyqtarë.

Në qoftë se vendimin e formës së prerë e ka marrë gjykata supreme e republikës, respektivisht e krahinës autonome, mbi revizionin dhe mbi kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji vendos kjo gjykatë në kolegji të përbërë prej pesë gjyqarësh, në qoftë se me ligjin e republikës, respektivisht të krahinës autonome nuk është caktuar që të vendos kolegji në përbërje më të gjorë.

Neni 45

Kur gjykon në shkallë të parë mbi kontestet pasurore midis republikave, respektivisht krahinave autonome dhe midis Federatës dhe republikës, respektivisht krahinës autonome, Gjykata Federative vendos në kolegji të përbërë nga dy gjyqëtarë dhe tre ndihmësgjyqëtarë.

Kur vendos mbi kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të marrë në kontest nga paragrafi 1 i këtij neni, Gjykata Federative vendos në seancë të përgjithshme.

Kur vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së prokurorit federativ (neni 409) dhe mbi kërkesën e palëve për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë (neni 416) Gjykata Federative vendos në kolegji të përbërë nga pesë gjyqtarë.

Në të gjitha rastet e tjera Gjykata Federative vendos në kolegji të përbërë nga tre gjyqtarë.

5. Kompetenca territoriale

a) Kompetenca e përgjithshme territoriale

Neni 46

Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për gjykim është kompetente gjykata që ka kompetencë të përgjithshme territoriale për të paditurin.

Në rastet e parashikuara në këtë ligj për gjykim, çdo gjykatë të kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata tjetër e aktuar.

Neni 47

Për gjykim ka kompetencë të përgjithshme territoriale gjykata në zonën e së cilës i padituri ka vendbanimin e vet.

Në qoftë se i padituri nuk ka vendbanimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe as në ndonjë shtet tjetër, me kompetencë të përgjithshme territoriale është gjykata në zonën e së cilës i padituri ka vendqëndrimin e vet.

Në qoftë se i padituri, përpos vendbanimit ka dhe vendqëndrimin në ndonjë vend tjetër, kurse pas rrethanave mund të supozohet se këtu do të endrojë për një kohë të gjatë, me kompetencë të përgjithshme territoriale është edhe gjykata e vendqendrimit të të paditurit.

Neni 48

Për gjykim në kontestet kundër bashkësisë shoqërore-politike, me kompetencë të përgjithshme territoriale është gjykata në zonën e së cilës ndodhet selia e organit të saj përfaqësues.

Për gjykim në kontestet kundër organizatave të bashkuar dhe personave të tjerë shoqërorë, si dhe në kontestet kundër personave civilë juridikë, me kompetencë të përgjithshme territoriale është gjykata, në zonën e së cilës ndodhet selia e tyre. Në rast dyshimi, si seli do të konsiderohet vendi u ndodhen organet e tyre të qeverisjes.

Neni 49

Për gjykim në kontestet kundër shtetasit të RSFJ dhe banor vazhdimisht në botën e jashtme, ku është rregulluar për shërbim ose për punë nga ana e organit të tetror, organizatës të punës së bashkuar ose personit tjetër shoqëror juridik, me kompetencë të përgjithshme territoriale është gjykata e vendbanimit të tij të fundit në RSFJ.

Në qoftë se personi i tillë nuk ka pasur vendbanim në RSFJ, apo në qoftë se kjo nuk mund të përcaktohet, Gjykata Federative do të caktojë cila gjykata me kompetencë lëndore do të jetë me kompetencë territoriale.

b) Kompetenca e veçantë territoriale

Kompetenca për bashkëndërgjyqësat

Neni 50

Në qoftë se me një padi janë paditur disa persona nën 196 paragrafi 1 pika 1) kurse për ta nuk ekziston

kompetenca territoriale e së njëjtës gjykate, kompetente është gjykata e cila është me kompetencë territoriale për një nga të paditurit, e në qoftë se midis tyre ka obligues kryesor dhe aksesori — gjykata që është me kompetencë territoriale për ndonjërin nga obliguesit kryesor.

Kompetenca në kontestet për ushqimin ligjor

Neni 51

Për gjykim në kontestet për ushqimin ligjor, në qoftë se është paditës personi që kërkon ushqim, është kompetente përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale edhe gjykata, në territorin e së cilës paditësi ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet.

Kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit

Neni 52

Për gjykim në kontestet për shpërblimin e dëmit është kompetente përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata në zonën e së cilës është shkaktuar dëmi.

Në qoftë se dëmi është krijuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është përpos gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni edhe gjykata në zonën e së cilës paditësi ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet.

Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni do të aplikohen edhe në kontestet kundër bashkësisë së sigurimit për shpërblimin e dëmit personave të tretë në bazë të dispozitave mbi përgjegjësinë direkte të bashkësisë së sigurimit; kurse dispozita e paragrafit 1 të këtij neni edhe në kontestet mbi kërkesat e regresit në bazë të shpërblimit të dëmit kundër debitorëve të regresit.

Kompetenca në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë së prodhuesit

Neni 53

Për gjykim në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë shkresore kundër prodhuesit që e ka dhënë garancinë është kompetente përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata me kompetencë të përgjithshme territoriale për shitësin, i cili gjatë shitjes së sendit ia ka dhënë blerësit garancinë shkresore të prodhuesit.

Kompetenca në kontestet martesore

Neni 54

Për gjykim në kontestet për vertetimin e qenies apo të mosqenies së martesës, anulimit të martesës apo të zgjidhjes së martesës (kontestet martesore), kompetente është përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, edhe gjykata në zonën e së cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Në qoftë se bashkëshortët nuk kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe në qoftë se i padituri nuk ka vendbanim, respektivisht vendqëndrim në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kurse për gjykim është kompetente gjykata jugosllave (neni 29), me kompetencë territoriale është gjykata në zonën e së cilës paditësi ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin. Po qe se as paditësi nuk ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gjykata Federative do të caktojë se cila gjykatë jugosllave do të jetë me kompetencë territoriale.

Kompetenca në kontestet për vërtetimin ose kontestimin e atësisë apo të amësisë

Neni 55

Në kontestet për vërtetimin ose kontestimin e atësisë apo të amësisë fëmija i mitur mund të ngrejë padi si para gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale ashtu edhe para gjykatës në zonën e të cilës ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin. Para gjykatës së vendbanimit të vet, respektivisht vendqëndrimin të vet, fëmija mund të ngrejë padinë e tillë edhe pas moshës madhore, por vetëm në qoftë se i padituri nuk ka vendbanim, respektivisht vendqëndrim në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Në qoftë se padia paraqitet kundër fëmijes që është shtetas i RSFJ dhe që nuk ka vendbanim, respektivisht vendqëndrim në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, por e ka paditësin, me kompetencë territoriale është gjykata në zonën e së cilës paditësi ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet.

Në qoftë se asnjëra nga palët nuk ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, apo në qoftë se vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ka paditësin, por sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të caktohet se cila gjykatë është me kompetencë territoriale, kurse për gjykim është kompetente gjykata jugosllave (neni 30). Gjykata Federative do të caktojë se cila gjykatë jugosllave do të jetë me kompetencë territoriale.

Kompetenca në kontestet mbi sendet e paluejtshme dhe për shkak të pengimit të posedimit

Neni 56

Për gjykim në kontestet mbi të drejtën e shfrytëzimit e të disponimit të sendeve të paluejtshme në pronësi shoqërore, në kontestet mbi pronësinë dhe mbi të drejtat e tjera lëndore mbi sendet e paluejtshme në pronësinë e qytetarëve e të personave civilë juridikë, në kontestet për shkak të pengimit të posedimit mbi sendet e paluejtshme, si dhe në kontestet nga raportet e qirasë apo të mëditjes mbi sendet e paluejtshme ose nga kontratat e shfrytëzimit të banesës ose të lokaleve të punës, është kompetente vetëm gjykata në zonën e së cilës ndodhet sendi i paluejtshëm.

Në qoftë se sendi i paluejtshëm ndodhet në zonën e disa gjykatave, është kompetente secila prej këtyre gjykatave.

Për kontestet për shkak të pengimit të posedimit mbi sendet e luejtshme është kompetente përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale edhe gjykata në zonën e së cilës ka ndodhur pengimi.

Kompetenca në kontestet mbi mjetin ajror dhe anijen

Neni 57

Kur për gjykim në kontestet mbi të drejtën e shfrytëzimit e të disponimit ose mbi të drejtën e pengut mbi mjetin ajror, anijen detare dhe mbi anijen e lundrimit të brendshëm në pronësi shoqërore, mbi të drejtën e pronësisë dhe mbi të drejtat e tjera faktike mbi këto anije, respektivisht mbi këto mjete ajrore në pronësinë e qytetarëve dhe të personave civilë juridikë, si dhe në kontestet nga raportet e qirasë në mjetin ajror dhe në anijen, është kompetente gjykata jugosllave (neni 32 paragrafi 1), me kompetencë territoriale është vetëm gjykata në zonën e së cilës mbahet regjistri ku është regjistruar mjete ajror, respektivisht anija.

Kur për gjykim në kontestet për shkak të pengimit të posedimit në anijet respektivisht në mjete ajrore të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni është kompetente gjykata jugosllave (neni 32 paragrafi 2), me kompetencë territoriale, përpos gjykatës në zo-

nën e së cilës mbahet regjistri ku është regjistruar anija, respektivisht mjete ajror, është edhe gjykata në zonën e së cilës ka ndodhur pengimi.

Kompetenca për personat që nuk kanë kompetencën e përgjithshme territoriale në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë

Neni 58

Padia mbi kërkesat pasurore-juridike kundër personit që nuk ka kompetencë të përgjithshme territoriale në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë mund t'i paraqitet çdo gjykatë jugosllave, në territorin e së cilës ndodhet ndonjë pasuri e këtij personi ose objekt që kërkohej me padi.

Në kontestet kundër personit, i cili në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk ka kompetencë të përgjithshme territoriale, padia mund t'i paraqitet gjykatës, në territorin e së cilës ky person ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e tij të fundit, në qoftë se kërkesë-padia ka të bëjë me detyrimet e krijuara gjatë kohës së qëndrimit të tij në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ose me detyrimet që duhet t'i zbatojë në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Kompetenca sipas vendit ku ndodhet njësia punonjëse e personit juridik

Neni 59

Për gjykim në kontestet kundër personit juridik që ka njësinë punonjëse jashtë selisë së vet, në qoftë se kontesti rezulton nga raporti juridik i kësaj njësie, përpos gjykatës të kompetencës së përgjithshme territoriale është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet kjo njësi punonjëse.

Kompetenca sipas vendit ku ndodhet perfaqësia e personit të huaj në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë

Neni 60

Në kontestet kundër personi fizik apo juridik që ka selinë në botën e jashtme në pikëpamje të detyrimeve që janë themeluar në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ose që duhet të përmbushen këtu, padia i paraqitet gjykatës jugosllave, në territorin e së cilës ndodhet perfaqësia e tij e përhershme për Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ose selia e organit, të cilit i është besuar të ushtrojë punët e tij.

Kompetenca për kontestet nga marrëdhëniet me njësitë ushtarake

Neni 61

Në kontestet kundër Federatës nga marrëdhëniet me njësitë ushtarake është kompetente vetëm gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e komandës së njësisë ushtarake.

Kompetenca në kontestet nga marrëdhëniet trashëgimore-juridike

Neni 62

Cjersa procedura trashëgimore të mos përfundojë në formë të prerë, për gjykim në kontestet nga marrëdhëniet trashëgimore juridike, si dhe në kontestet mbi kërkesat e kreditorëve ndaj trashëgimtarëve, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, me kompetencë territoriale është edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën trashëgimore.

Kompetenca për kontestete në procedurën e ekzekutimit e të falimentimit**Neni 63**

Për gjykim në kontestet që lindin gjatë dhe me rastin e procedurës ekzekutive gjyqësore apo administrative, respektivisht gjatë dhe me rastin e procedurës së falimentimit, me kompetencë territoriale është vetëm gjykata kompetente në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën ekzekutive, respektivisht të falimentimit, respektivisht gjykata në territorin e së cilës zbatohet ekzekutimi administrativ.

Kompetenca sipas vendit të pagesës**Neni 64**

Për gjykim në kontestet e poseduesit të kambialit apo të çekut kundër nënshkruesit është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, edhe gjykata e vendit të pagesës.

Kompetenca në kontestet nga marrëdhënia e punës**Neni 65**

Në qoftë se në kontestin nga marrëdhënia e punës paditësi është punëtor, për gjykim është kompetente, përpos gjykatës që ka kompetencë të përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhej, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Kompetenca reciproke për paditë kundër shtetasve të huaj**Neni 66**

Në qoftë se në shtetin e huaj, shtetasi i RSFJ mund të paditet para gjykatës, e cila sipas dispozitave të këtij ligji nuk do të ishte me kompetencë territoriale për gjykim në këtë çështje civilo-juridike, e cila do të caktojë që në këtë objekt të veprojë gjykata shtetasit të këtij shteti të huaj para gjykatës jugosllave.

Caktimi i kompetencës territoriale nga ana e gjykatës më të lartë**Neni 67**

Në qoftë se gjykata kompetente për shkak të përjashtimit të gjyqtarit nuk mund të veprojë, do të njoftojë për këtë gjë direkt gjykatën më të lartë, e cila do të caktojë që në këtë objekt të veprojë gjykata tjetër me kompetencë lëndore nga territori i saj.

Neni 68

Gjykata me e lartë e llojit të caktuar në republikë respektivisht në krahinën autonome mundet, me propozimin e palës ose të gjykatës kompetente, të caktojë që në objektin e veçantë të veprojë gjykata tjetër me kompetencë lëndore nga territori i saj në qoftë se është e qartë se në këtë mënyrë do të zbatohet më lehtë procedura apo në qoftë se për këtë gjë ekzistojnë shkaqet e tjera të rëndësishme.

Neni 69

Në qoftë se për gjykim është kompetente gjykata jugosllave, por sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të përcaktohet se cila gjykatë është me kompetencë territoriale, Gjykata Federative, me propozimin e palës, do të caktojë se cila gjykatë me kompetencë lëndore do të jetë me kompetencë territoriale.

c) Marrëveshja mbi kompetencën territoriale**Neni 70**

Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate, palët mund të mirren vesh që në shkallë të parë të gjykojë gjykata që nuk është me kompetencë territoriale, me konditë që kjo gjykatë të jetë me kompetencë lëndore.

Në qoftë se me ligj është caktuar se për gjykim në kontest të caktuar me kompetencë territoriale janë dy ose më tepër gjykata jugosllave, palët mund të mirren vesh që në shkallë të parë të gjykojë një prej këtyre gjykatave ose ndonjë gjykatë tjetër me kompetencë lëndore.

Kjo marrëveshje aplikohet vetëm në qoftë se është hartuar me shkrim dhe në qoftë se ka të bëjë me kontestin e caktuar ose me disa konteste që rezultojnë nga raporti i caktuar juridik.

Dokumentin mbi marrëveshjen paditësi duhet t'ia bashkangjes padisë.

Palët mund të mirren vesh që t'u gjykojë gjykata e huaj në qoftë se njëra palë është personi i huaj fizik apo juridik dhe nuk është fjala për kontestin për të cilin është kompetente gjykata jugosllave në bazë të dispozitave të këtij ligji mbi kompetencën ekskluzive në kontestet me element ndërkombëtar ose mbi kompetencën territoriale ekskluzive.

Kreu i tretë**PËRJASHTIMI****Neni 71**

Gjyqtari ose ndihmësgjyqtari nuk mund të ushtrtojë detyrën e gjyqtarit:

1) në qoftë se është vetë palë, përfaqësuesi ligjor ose i autorizuari i palës, apo në qoftë se me palën është në marrëdhënie të bashkëautorizimit, të bashkëobliguesit ose të obliguesit të regresit, apo në qoftë se në të njëjtin objekt është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

2) në qoftë se vazhdimisht ose përkohësisht punon në organizatën punonjëse, në organizatën e punës së bashkuar ose pranë personit tjetër shoqëror apo civil juridik, që është palë në procedurë;

3) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo i autorizuari i palës është kushëri gjaku në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë anësore deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;

4) në qoftë se është kujdestar, adaptues ose i adaptuari i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose i autorizuesit;

5) në qoftë se në të njëjtin objekt ka marrë pjesë në marrjen e vendimit të gjykatës më të ultë, të gjykatës vetëqeverisëse ose të organi tjetër;

6) në qoftë se ekzistojnë rrethanë të tjera që vëjnë në dyshim paanësinë e tij.

Neni 72

Gjyqtari ose ndihmësgjyqtari, posa të ketë mësuar se ekziston një nga shkaqet për përjashtim që parashikon neni 71 pikat 1 deri 5 të këtij ligji, ka për detyrë të ndërprejë çdo punë në këtë objekt dhe për këtë gjë a njoftojë kryetarin e gjykatës, i cili do t'ia caktojë zëvendësin. Në qoftë se është fjala për përjashtimin e kryetarit të gjykatës, ai do t'ia caktojë vetës zëvendësin nga radha e gjyqtarëve të kësaj gjykate, e po që se kjo nuk është e mundur, do të veprojë sipas nenit 67 të këtij ligji.

Në qoftë se gjyqtari apo ndihmësgjyqtari konsideron se ekzistojnë rrethanë të tjera që vëjnë në dyshim paanësinë e tij (neni 71 pika 6), do ta njoftojë për këtë gjë kryetarin e gjykatës, i cili do të vendos mbi përjashtimin. Derisa të nxirret aktvendimi i kryetarit të gjykatës, gjyqtari mund të ndërmarrë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rreziku i shtytjes.

Neni 73

Përjashtim mund të kërkojnë edhe palët.

Pala ka për detyrë të parashtrojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, respektivisht të ndihmësgjyqtarit posa të ketë mësuar shkakun e përjashtimit, por jo më vonë se deri në mbarim të shqyrtimit para gjykatës të shkallës së parë, e po qe se nuk ka pasur shqyrtim, deri në marrjen e vendimit.

Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës më të lartë mund të parashtrohet nga pala në mjetin juridik apo një përgjigje të mjetit juridik, e në qoftë se para gjykatës më të lartë zhvillohet shqyrtimi, atëherë deri në mbarim të shqyrtimit.

Pala ka për detyrë që në kërkesë të theksojë rrethanat në të cilat e bazon kërkesën e vet për përjashtim.

Neni 74

Mbi kërkesën e palës për përjashtim vendos kryetari i gjykatës.

Në qoftë se pala kërkon përjashtimin e kryetarit të gjykatës, vendimin mbi përjashtimin e merr kryetari i gjykatës drekt më të lartë.

Mbi kërkesën e palëve për përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës supreme në republikë, respektivisht në krahinën autonome, të Gjykatës Supreme Ushtarake, apo të Gjykatës Federative vendos secila e përgjithshme e asaj gjykate.

Para nxjerrjes së aktvendimit mbi përjashtimin do të merret deklarata e gjyqtarit apo e ndihmësgjyqtarit, përjashtimi i të cilit kërkohej, e sipas nevojë, do të bëhet edhe ekzaminimi tjetër.

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankimi, kurse kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 75

Kur gjyqtari apo ndihmësgjyqtari të ketë mësuar se është shtruar kërkesa për përjashtimin e tij, ka për detyrë që menjëherë të pezullojë çdo punë në objektin respektiv, e në qoftë se është fjala për përjashtimin e parashikuar në nenin 71 pika 6 të këtij ligji mundet që deri në nxjerrjen e aktvendimit mbi kërkesën, të ndërmarrë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rreziku i shtytjes.

Neni 76

Dispozitat mbi përjashtimin e gjyqtarit dhe të ndihmësgjyqtarit do të aplikohen përshtatshmërisht edhe ndaj procesmbajtësve.

Mbi përjashtimin e procesmbajtësit vendos kryetari i kolegjit, respektivisht kolegji.

Kreu i katërt

PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE LIGJORË

Neni 77

Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik.

Më dispozitat e veçanta caktohet se kush, përpos personave fizikë dhe juridikë, mund të jetë palë në procedurë.

Gjykata kontestimore mundet, përjashtimisht, me efekt juridik në kontestim të caktuar, ta njohë cilësinë e palës edhe atyre formave të bashkimit që nuk kanë zotësinë e palës në vështirësi të dispozitave të paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni po qe se vërtetohet, se, duke marrë parasysh objektin e kontestit, në esencë i përmbushin kushtet kryesore për fitimin e palës së palës, e sidomos në qoftë se disponojnë njohë shoqërore, respektivisht pasurinë mbi të cilën mund të zbatohet shkaktimi.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni nuk lejohet ankimi i palës së palës në kontestim. Nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 78

Kur avokati shoqëror i vetëqeverisjes dhe prokurori publik janë të autorizuar me ligj që të fillojnë procedurën kontestimore, ata mund të ndërmarrin veprimet në procedurë që nevojiten për realizimin e autorizimeve të tyre.

Neni 79

Pala që është krejtësisht e aftë për të vepruar mund të ushtrojë vetë veprime në procedurë (zotësia për të qenë palë).

Personi madhor të cilin i është kufizuar pjesërisht zotësia për të vepruar, ka zotësinë për të qenë palë brenda kufijve të zotësisë së vet për të vepruar.

I mituri që nuk e ka fituar plotësisht zotësinë për të vepruar, ka zotësinë për të qenë palë brenda kufijve në të cilët i njihet zotësia për të vepruar.

Neni 80

Palën, e cila nuk ka zotësinë për të qenë palë, e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor.

Përfaqësuesi ligjor caktohet me ligj ose me aktin e organit kompetent shtetëror, të nxjerrë në bazë të ligjit.

Neni 81

Përfaqësuesi ligjor mundet, në emër të palës, të ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurë, por në qoftë se për paraqitjen ose për tërheqjen e padisë për njohjen, respektivisht për heqjen dorë nga kërkesë-padia, për përfundimin e pajtimit apo për ndërmarrjen e veprimeve të tjera në procedurë, në dispozita të veçanta është caktuar që përfaqësuesi duhet të ketë autorizim të veçantë, ai mund të ndërmarrë këto veprime vetëm në qoftë se ka autorizim të tillë.

Personi që paraqitet si përfaqësues ligjor ka për detyrë që, me kërkesën e gjykatës, të provojë se është përfaqësuesi ligjor. Kur për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në procedurë nevojitet autorizimi i veçantë, përfaqësuesi ligjor ka për detyrë të provojë se ka autorizim të tillë.

Kur gjykata të vërtetojë se përfaqësuesi ligjor i personit nën kujdestari nuk tregon kujdes të duhur në përfaqësim, do ta njoftojë nër këtë gjë organin e kujdestarisë. Po qe se për shkak të ometimeve të përfaqësuesit do të mund të shkaktohej dëmi për personin nën kujdestari, gjykata do ta lëshojë procedurën dhe do të propozojë që të caktohet përfaqësuesi tjetër ligjor.

Neni 82

Gjatë tërës procedurës gjykata do të kujdeset kryesisht nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi të palës, nëse palën me zotësinë e palës e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizim të veçantë, kur ky nevojitet.

Neni 83

Kur gjykata konstatojë se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, kurse kjo e meta mund të evitohet, do të fitojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndërmarrë masa të tiera nër të bërë që procedura të mund të vazhdojë me personin që mund të jetë palë në procedurë.

Po kështu, kur gjykata vërtetohet se pala nuk ka përfaqësuesin ligjor apo se përfaqësuesi ligjor nuk ka autorizimin të veçantë, kur ky nevojitet, do të kërkojë që organi kompetent i kujdestarisë të caktojë kujdestarin personit të padisë nër të qenë palë, respektivisht do të fitojë përfaqësuesin ligjor që të nalet me autorizim të veçantë ose do të ndërmarrë masa të tiera të nevojiten që pala e cila nuk ka zotësinë e palës të përfaqësohet në procedurë të tillë.

Kundër aktin i caktimit të përfaqësuesit ligjor dhe ndreqjeve nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni

Gjersa të mos evitohen këto meta, në procedurë mund të merren vetëm ato veprime, për shkak të shtytjes të të cilave do të mund të lindin pasoja të dëmshme për palën.

Në qoftë se të metat e theksuara nuk mund të menjahohen apo në qoftë se afati i caktuar kalon pa sukses, gjykata do t'i abrogojë me aktvendim veprimet e zbatuara në procedurë në qoftë se përmbajnë këto të meta dhe do ta hedhë poshtë padinë po që se të metat janë të një karakteri të atillë sa që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të kontestimit.

Kundër aktvendimit, me të cilin urdhërohen masat për menjanimin e të metave, nuk lejohet ankimi.

Neni 84

Në qoftë se gjatë procedurës para gjykatës të shka-llës se parë tregohet se procedura e zakonshme rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjasë shumë, kështu që për këtë arsye do të mund të lindin pasoja të dëmshme për njerën apo për të dy palët, gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm.

Nën kushtin nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm sidomos në këto raste:

- 1) në qoftë se i padituri nuk ka zotësinë e palës, ndërsa nuk ka përfaqësuesin ligjor;
- 2) në qoftë se ekzistojnë interesat e kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij;
- 3) në qoftë se të dy palët kanë të njëjlin përfaqësues ligjor;
- 4) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka autorizues;
- 5) në qoftë se i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, që nuk kanë autorizues në RSFJ, ndodhen në botën e jashtme, kurse dërgimi nuk ka mundur të kryhet.

Mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm gjykata do ta njoftojë pa shtytje organin e kujdestarisë, si dhe palët kur kjo është e mundur.

Neni 85

Përfaqësuesi i përkohshëm ka në procedurë, për të cilën është caktuar, të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor.

Këto të drejta dhe detyra përfaqësuesi i përkohshëm i ushtron gjithnjë gjersa i padituri ose autorizuesi i tij të mos paraqitet para gjykatës, respektivisht gjersa organi i kujdestarisë të mos ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Neni 86

Në qoftë se përfaqësuesi i përkohshëm i është caktuar të paditurit për shkak të treguara në nenin 84 paragrafi 2 pikat 4 dhe 5 të këtij ligji, gjykata do të japë shpallje, e cila do të botohet në gazetën zyrtare republikane, respektivisht krahinore dhe me anë të tabelës së shpalljeve të gjykatës, e sipas nevojë në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

Shpallja duhet të përmbajë: emërtimin e gjykatës, që ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, bazën ligjore, emrin e të paditurit të cilit i caktohet përfaqësuesi, objektin e kontestit, emrin e përfaqësuesit dhe profesionin dhe vendqëndrimin e tij, si dhe paralajmërimin se përfaqësuesi do ta përfaqësojë të paditurin në procedurë gjithnjë gjersa i padituri ose autorizuesi i tij të mos paraqitet para gjykatës, respektivisht gjersa organi i kujdestarisë të mos ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Neni 87

Zotësia për të qenë palë e shtetasit të RSFJ çmohet sipas ligjit të republikës, respektivisht të krahinës autonome, që është kompetent për vërtetimin e zotësisë së tij për të vepruar.

Shtetasi i RSFJ që nuk ka zotësi për të qenë palë sipas ligjit të republikës, respektivisht të krahinës au-

tonome që është kompetent për të çmuar zotësinë e tij për të vepruar, ndërsa ka zotësi për të qenë palë sipas ligjit të republikës, respektivisht të krahinës autonome, para gjykatës të se cilës zhvillohet procedura, mundet vetë të ndërmarrë veprime në procedurë. Përfaqësuesi i tij ligjor mund të ndërmarrë veprime në procedurë vetëm gjersa ky shtetas të mos deklarojë se e ndërmerr vetë zhvillimin e kontestimit.

Neni 88

Zotësia për të qenë palë e shtetasit të huaj para gjykatës jugosllave çmohet sipas ligjit të shtetit, shtetas i të cilit është ai.

Shtetasi i huaj që nuk ka zotësi për të qenë palë sipas ligjit të shtetit shtetas i të cilit është, kurse ka zotësi për të qenë palë sipas ligjit të republikës, respektivisht të krahinës autonome, para gjykatës të se cilës zhvillohet procedura, mundet vetë të ndërmarrë veprime në procedurë. Përfaqësuesi ligjor mund të ndërmarrë veprime në procedurë vetëm gjersa shtetasi i huaj të mos deklarojë se e ndërmerr vetë zhvillimin e kontestimit.

Kreu i pestë

AUTORIZUESIT

Neni 89

Palët mund të ndërmarrin veprime në procedurë personalisht ose me anë të autorizuesit, por gjykata mund ta thërras palën, e cila ka autorizues, që të deklarohet para gjykatës personalisht mbi faktet që duhen vërtetuar në kontestim.

Pala të cilën e përfaqëson autorizuesi mund të vijë kurdoherë para gjykatës dhe të japë deklarata përpos autorizuesit të vet.

Neni 90

Autorizues mund të jetë çdo person që është krejtësisht i zoti për të vepruar, përveç personave që marrin me kuazishkresori.

Në qoftë se si autorizues paraqitet personi që merret me kuazishkresori, gjykata do t'i ndalojë këtij personi përfaqësimin e mëtejshëm dhe për këtë gjë menjëherë do ta njoftojë palën.

Ankimi kundër aktvendimit mbi ndalimin e përfaqësimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Në qoftë se vërtetohet se autorizuesi që nuk është avokat nuk është i zoti ta kryer këtë detyrë, gjykata do t'i theksojë palës pasojat e dëmshme që mund të lindin për shkak të përfaqësimit jo të drejtë.

Neni 91

Në qoftë se në kontestimet mbi kërkesat pasurore juridike vlera e objektit të kontestimit kalon 50.000 dinarë, autorizues të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave apo të bashkësive të tjera vetëqeverisëse mund të jenë vetëm personat që e kanë dhënë provimin e judikaturës.

Neni 92

Veprimet në procedurë, të cilat i ndërmerr autorizuesi në kuadrin e prokurës, kanë po atë efekt juridik sikur t'i ketë ndërmarrë pala vetë.

Neni 93

Pala mund ta ndryshojë ose ta revokojë deklarata të autorizuesit të vet në seancë ku është dhënë kjo deklarata.

Në qoftë se autorizuesi e ka pohuar ndonjë fakt në seancë, ku nuk qenë e pranishme pala, apo ndonjë fakt e ka pohuar në parashitje, kurse pala këtë pohim e ndryshon më vonë ose e revokon, gjykata do t'i çmojë të dy deklarata në vështirësi të neni 221 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 94

Vëllimi i prokures caktohet nga pala.

Pala mund të autorizojë autorizuesin të ndërmarrë vetëm veprimet të caktuara ose të ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurë.

Neni 95

Në qoftë se pala ia ka dhënë avokatit prokurën për zhvillimin e kontestimit, kurse nuk ia ka caktuar më hollësisht autorizimet në prokurë, avokati është i autorizuar në bazë të prokurës së tillë:

1) të ushtrojë të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos të paraqes padinë, ta tërheqë, ta pohojë kërkesë-padinë, ose të heqë dorë nga kërkesë-padia, të përfundojë pajtimin, të parashtrojë mjetin juridik dhe të heqë dorë ose të tërhiqet prej tij, si dhe të kërkojë caktimin e masave të përkohshme të sigurimit;

2) të bëjë kërkesë për ekzekutimin ose sigurimin dhe të ndërmarrë veprime të nevojshme në procedurë me rastin e kërkesës së tillë;

3) të pranojë prej palës kundërshtare shpenzimet e caktuara nga gjyqi;

4) ta kalojë prokurën avokatit tjetër ose ta autorizojë avokatin tjetër për ndërmarrjen vetëm të disa veprimeve në procedurë.

Për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës avokatit i nevojitet prokurë e veçantë, në qoftë se nga koha kur vendimi të ketë marrë formën e prerë kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj.

Avokatin mund ta zëvendësojë avokati-praktikant, që është i inkuadruar tek ai, por vetëm para gjykatës të shkallës së parë, nën kondita nga neni 91 i këtij ligji.

Neni 96

Në qoftë se pala në prokurë nuk ka caktuar më hollësisht autorizimet e autorizuesit, autorizuesi që nuk është avokat mundet, në bazë të prokurës së tillë, të ushtrojë të gjitha veprimet në procedurë, por i nevojitet gjithnjë autorizimi kategorik për tërheqjen e padisë, për pohimin ose për mohimin e kërkesë-padisë, për përfundimin e pajtimit, për heqjen dorë ose për tërheqjen nga mjeti juridik dhe për kalimin e prokurës një personi tjetër, si dhe për paraqitjen e mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Neni 97

Pala e jep prokurën me shkrim ose me gojë në procesverbal pranë gjykatës.

Pala që është analfabete ose që nuk është në gjendje të nënshkruhet do të vejë në prokurën shkresore, në vend të nënshkrimit, shënjen e gishtit tregues. Në qoftë se në këtë rast prokura i jepet personit që nuk është avokat, nevojitet prania e dy dëshitarëve, të cilët do ta nënshkruajnë prokurën.

Në qoftë se dyshohet në vërtetësinë e prokurës shkresore, gjykata mund të caktojë me aktvendim që të paraqitet prokura e legalizuar. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.

Neni 98

Autorizuesi ka për detyrë që në veprimin e parë gjatë procedurës të paraqes prokurën.

Gjykata mund të lejojë që veprimet në procedurë për palën përkohësisht t'i kryejë personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do t'i urdhërojë këtij personi që më vonë, në një afat të caktuar, ta paraqes prokurën ose autorizimin e palës për kryerjen e veprimit kontestimor.

Për derisa të mos kalojë afati për paraqitjen e prokurës, gjykata do ta shpallë marrjen e vendimit. Në qoftë se ky afat kalon pa sukses, gjykata do ta vazhdojë procedurën duke mos marrë parasysh veprimet që i ka kryer personi pa prokurë.

Gjykata ka për detyrë që gjatë krejt procedurës të kujdeset nëse personi që paraqitet si autorizues është i autorizuar për të përfaqësuar. Në qoftë se gjykata vërteton se personi që paraqitet si autorizues, nuk është i autorizuar për të përfaqësuar, do t'i abrogojë veprimet kontestimore që i ka ndërmarr ky person, po që se këto veprime pala nuk i ka miratuar më vonë.

Neni 99

Pala mund ta revokojë në çdo kohë prokurën, kurse autorizuesin mund ta denoncojë në çdo kohë.

Revokimi, respektivisht denoncimi i prokurës duhet t'i komunikohet gjykatës para së cilës zhvillohet procedura, me shkrim ose me gojë në procesverbal.

Revokimi, respektivisht denoncimi i prokurës vlen për palën kundërshtare që nga momenti kur t'i jetë komunikuar.

Pas denoncimit të prokurës autorizuesi ka për detyrë që edhe një muaj të kryejë veprime për personin që ia ka dhënë prokurën në qoftë se nevojitet që prej tij të mënjanojë ndonjë dëm që do të mund të shkaktohej në atë kohë.

Neni 100

Në qoftë se autorizuesi i është dhënë autorizimi që të mund të ushtrojë të gjitha veprimet në procedurë, kurse pala, respektivisht përfaqësuesi i saj ligjor vdes apo bëhet i paafat për të vepruar, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor shkarkohet nga detyra, autorizuesi është i autorizuar që edhe më tutje të ndërmarrë veprime në procedurë, por trashëgimtari, respektivisht përfaqësuesi i ri ligjor, mund ta revokojë prokurën.

Në rastet e theksuara në paragrafin 1 të këtij neni, autorizuesit që nuk është avokat i pushojnë kurdoherë autorizimet, të cilat në prokurë duhet të theksohen kategorikisht (neni 96).

Neni 101

Me pushimin e personit juridik pushon edhe prokura të cilën e ka lëshuar ai.

Në rast falimentimi, prokura që e ka lëshuar debitori falimentues pushon kur, sipas dispozitave në fuqi, lindin pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit.

Përfashtimisht nga dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni, autorizuesi ka për detyrë që edhe një muaj të kryejë veprime në procedurë po që se nevojitet që prej palës të mënjanojë dëmin.

Kreu i gjashtë

GJUHA NË PROCEDURË

Neni 102

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që gjatë pjesëmarrjes në seancat dhe gjatë ndërmarrjes verbale të veprimeve të tjera procesuale para gjykatës të përdorin gjuhën e vet. Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, respektivisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do t'u sigurohet përkthimi verbal në gjuhën e tyre të asaj që parashtrohet në seancë, si dhe përkthimi verbal i dokumenteve që përdoren në seancë si prova.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të udhëzohen mbi të drejtën që procedurën verbale para gjykatës ta përcjellin në gjuhën e vet me anë të interpretit. Ato mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit në qoftë se deklarojnë se e zotërojnë gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se u është dhënë udhëzimi, si dhe deklaratat e palëve, respektivisht të pjesëmarrësve.

Përkthimin e bëjnë interpretët.

Neni 103

Thirrjet, vendimet dhe letrat e tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën e kombit që është në përdorimin zyrtar në gjykatë.

Në qoftë se në gjykatë është në përdorimin zyrtar edhe ndonjë nga gjuhët e kombësive të Jugosllavisë, gjykata do t'u dërgojë në këtë gjuhë letrat gjyqësore atyre palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë që i përkasin kësaj kombësie dhe që në procedurë e përdorin këtë gjuhë. Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë mund të kërkojnë që letrat gjyqësore t'u dërgohen në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Neni 104

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë i dërgojnë gjykatës paditë, ankimet dhe parashtrësit e tjera të tyre në gjuhën e kombit apo të kombësisë që është në përdorim zyrtar në gjykatë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë mund të dërgojnë parashtrësit e veta gjykatës edhe në një nga gjuhët e kombeve të Jugosllavisë që nuk është në përdorim zyrtar në atë gjykatë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë mund t'i dërgojnë gjykatës parashtrësit e veta edhe në gjuhën e kombësisë së Jugosllavisë që nuk është në përdorim zyrtar në gjykatë, në qoftë se kjo është në pajtim me kushtetutën, ligjin ose me dispozitën tjetër të vlefshme në zonën e kësaj gjykate.

Neni 105

Shpenzimet e përkthimit në gjuhën e kombit dhe të kombësisë së Jugosllavisë që lindin me aplikimin e dispozitave të kushtetutës dhe të këtij ligji mbi të drejtën e pjesëmarrësve të kombeve e të kombësive të Jugosllavisë për përdorimin e gjuhës së vet, ngarkojnë mjetet e gjykatës.

Kreu i shtatë

PARASHTRËSAT

Neni 106

Padia, përgjigja në padinë, mjetet juridike dhe deklaratat e tjera, propozimet dhe komunikimet, që jepen jashtë seancës, paraqiten me shkrim (parashtrësat).

Parashtrësat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet për të vepruar sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emërtimin e gjykatës, emrin, profesionin dhe vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe të autorizuesve të tyre, në qoftë se kanë të tillë, objektin e kontestit, deklaratën e përmbajtur dhe nënshkrimin e paraqitësit.

Në qoftë se deklarata përmban ndonjë kërkesë pala duhet që në parashtrësë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme.

Deklarata që jepet me parashtrësë, në vend që të jepet me parashtrësë, mund të jepet verbalisht në procesverbal pranë gjykatës kontestimore.

Neni 107

Parashtrësat që duhet t'i dërgohen palës kundërshtare i jepen gjykatës në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe për palën kundërshtare. Kështu duhet vepruar edhe kur bashkë me kërkesën paraqiten anekset.

Në qoftë se në anën kundërshtare janë disa persona që kanë një përfaqësues të përbashkët ligjor ose autorizues, për të gjithë këta persona parashtrësat dhe ankesat mund t'u dërgohen në një kopje.

Neni 108

Dokumentet që i bashkëngjiten parashtrësës paraqiten në origjinal ose në kopje.

Në qoftë se pala bashkëngjet dokumentin në origjinal, gjykata do ta mbajë këtë dokument, kurse palës kundërshtare do t'i lejojë kqyrjen e tij. Kur pushon nevoja që dokumenti i tillë të mbahet në gjykatë, do t'i kthehet paraqitësit, me kërkesën e këtij, por gjykata mund të kërkojë nga paraqitësi që t'u bashkëngjies shkresave kopjen e dokumentit.

Në qoftë se dokumenti është paraqitur në kopje, gjykata, me kërkesën e palës kundërshtare, do ta ftojë paraqitësin që t'i paraqes gjykatës dokumentin në origjinal, kurse palës kundërshtare do t'i lejojë kqyrjen. Kur kjo nevojitet, gjykata do të caktojë afatin, në të cilin duhet të dorëzohet dokumenti, respektivisht të kqyret.

Kundër këtyre aktvendimeve nuk lejohet ankimi.

Neni 109

Në qoftë se parashtrësja është e pakuptueshme, apo nuk përmban të gjitha që nevojiten për të vepruar sipas saj, gjykata do ta udhëzojë paraqitësin dhe do t'i ndihmojë që ta ndreqë parashtrësen, respektivisht ta plotësojë atë, e për këtë qëllim mund ta ftojë në gjykatë ose t'ia kthejë parashtrësen për ndreqje.

Në qoftë se gjykata ia kthen parashtrësen paraqitësit për ndreqje ose plotësim, do të caktojë afatin për riparaqitjen e parashtrësës.

Në qoftë se parashtrësja e lidhur me afat ndreqet, respektivisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për plotësim apo ndreqje, do të konsiderohet se i është paraqitur gjykatës atë ditë kur është paraqitur për të parën herë.

Do të konsiderohet se parashtrësja është tërhequr në qoftë se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa ndreqje, respektivisht pa plotësim, do të hidhet poshtë.

Në qoftë se parashtrësat apo anekset nuk janë paraqitur në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë paraqitësin që, brenda afatit të caktuar, t'i paraqes ato. Në qoftë se paraqitësi nuk vepron sipas këtij urdhërit, gjykata do ta hedhë poshtë parashtrësen. Përfundimisht, gjykata mund të caktojë që parashtrësat dhe anekset të kopjohen me shpenzimet e palës.

Neni 110

Me gjobë deri në 1.000 dinarë gjykata kontestimore do ta dërojë personin, i cili në parashtrësë fyer gjykatën, palën ose pjesëmarrësin tjetër në procedurë.

Dënimi i dhënë sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk ndikon në dhënien e dënimit për veprë penale.

Në qoftë se personi që është dënuar me gjobë nuk mund ta paguajë këtë gjobë, ajo do të zëvendësohet me burg, kohëzgjatjen e të cilit e cakton gjykata, vartësisht nga masa e dënimit të dhënë, por që nuk mund të jetë më tepër se dhjetë ditë.

Dispozita e paragrafit 3 të këtij neni do të aplikohet në të gjitha rastet kur gjykata e jep dënimin me gjobë (nenet 248, 255, 216 dhe 318).

Kreu i tetë

AFATET DHE SEANCAT

Afatet

Neni 111

Në qoftë se afatet nuk janë caktuar me ligj, ato i cakton gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e rastit.

Afati të cilin e cakton gjykata mund të zgjatet me propozimin e personit të interesuar, po që se për këtë gjë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme.

Propozimi mund të paraqitet para skadimit të afatit zgjatja e të cilit kërkohet.

Kundër aktvendimit mbi zgjatjen e afatit nuk lejohet ankimi.

Neni 112

Afatet llogariten sipas ditëve, muajve dhe viteve. Në qoftë se afati është caktuar për ditët, në afat nuk llogaritet dita kur është bërë dërgimi apo komunikimi, respektivisht dita në të cilën bie ngjarja nga e cila duhet llogaritur kohëzgjatja e afatit, por si fillim nerret dita e parë që vjen.

Afatet e caktuara në muaj, respektivisht në vite përfundohen me skadimin e asaj dite të muajit të fundit, respektivisht të vitit që sipas numrit të vet i përgjigjet ditës kur ka filluar afati. Në qoftë se nuk ka ditë të tillë në muajin e fundit, afati përfundon ditën e fundit të atij muaji.

Në qoftë se dita e fundit të afatit bie në festë shtetërore apo ditën e diele, ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati skadon me kalimin e ditës së parë që vjen.

Neni 113

Kur parashtrësja është e lidhur me afat, konsiderohet se është dhënë në afat, po qe se para se të ketë shkruar afati, i dorëzohet gjykatës kompetente.

Në qoftë se parashtrësja është dërguar me anë të postës me letër të porositur ose në rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë, të cilës i është drejtuar.

Në qoftë se parashtrësja është dërguar në rrugë telegrafike, kurse nuk përmban çdo gjë që nevojitet për të vepruar sipas saj, do të konsiderohet se është dhënë në afat në qoftë se parashtrësja e rregullt i dërgohet me vonë gjykatës apo në qoftë se i dërgohet gjykatës me letër të porositur brenda tri ditësh nga data e dorëzimit të telegramit në postë.

Për personat që ndodhen në Armatën Popullore të Jugosllavisë, në shërbim të detyruar ushtarak, dita e dorëzimit të parashtrësjes njësish ushtarake, respektivisht institucionit ushtarak apo shtabit, do të konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë.

Dispozita e paragrafit 4 të këtij neni ka të bëjë edhe me personat e tjerë në Armatën Popullore të Jugosllavisë, që ndodhen me shërbim në njësitë ushtarake, respektivisht në institucionet ushtarake ose në shtab, në vendet ku nuk ekziston posta e rregullt.

Për personat e privuar nga liria, dita e dorëzimit të parashtrësjes në drejtorinë e burgut, të institucionit ndëshkimor-korektonjës apo të shtëpisë edukative-korektonjës konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.

Në qoftë se parashtrësja, që lidhet me afat, i është dorëzuar apo dërguar gjykatës kompetente para skadimit të afatit, ndërsa vjen në gjykatë kompetente pas skadimit të afatit, do të konsiderohet se është paraqitur në kohë, në qoftë se paraqitja e saj gjykatës kompetente është bërë nga mosdija ose nga gabimi i hapur i paraqitësit.

Dispozitat e paragrafeve 1 deri 7 të këtij neni aplikohen edhe ndaj afatit, në të cilin, sipas dispozitave të veçanta, duhet të ngritet padia, si dhe ndaj afatit të parashkrimit të kërkesave ose të ndonjë të drejte tjetër.

Seanca

Neni 114

Seancën e caktën gjykata, kur kjo gjë është parashikuar me ligj ose kur e lypin interesat e procedurës. Kundër aktvendimit mbi caktimin e seancës nuk lejohet ankimi.

Gjykata do t'i thirrë në kohën e duhur në seancë palët dhe personat e tjerë, praninë e të cilëve e quan të nevojshme. Bashkë me thirrjen palës do t'i dërgojë parashtrësja që ka dhënë shkas për caktimin e seancës, kurse në thirrje do të theksojë vendin, lokalitetin dhe kohën e mbajtjes së seancës. Në qoftë se bashkë me thirrjen nuk dërgon parashtrësja, në thirrjen do të theksojë palët objektin e kontestit, si dhe veprimin që do të kryhet në seancë.

Gjykata do të paralajmërojë në thirrjen për paraqitje ligjore të mungesës në seancë.

Neni 115

Seanca, si rregull, mbahet në ndërtesën e gjykatës. Gjykata mund të vendos që seanca të mbahet jashtë ndërtesës së gjykatës në qoftë se konstaton se kjo është e domosdoshme, apo se në këtë mënyrë do të kursehej koha, apo shpenzimet e procedurës. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.

Neni 116

Gjykata mund ta shtyjë seancën, kur kjo gjë nevojitet për paraqitjen e provave, apo kur për këtë gjë ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme.

Kur e shtyn seancën, gjykata do t'ua komunikojë mundësisht menjëherë të pranishmëve vendin dhe kohën e seancës tjetër.

Kundër aktvendimit mbi shtytjen e seancës nuk lejohet ankimi.

Kërkimi në gjendje të mëparshme

Neni 117

Në qoftë se pala e ometon seancën ose afatin për ndërmarrjen e ndonjë veprimi në procedurë dhe për këtë shkak e humbë të drejtën e ndërmarrjes së këtij veprimi, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim (kthimi në gjendje të mëparshme) po qe se e çmon se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për ometim.

Në qoftë se lejon kthimin në gjendje të mëparshme, kontestimi kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para ometimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka marrë gjykata për shkak të ometimit.

Neni 118

Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës, pranë së cilës është dashur të kryejë veprimi i ometuar.

Propozimi duhet të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë ditësh, duke llogaritur që nga dita kur ka përfunduar arsyja që ka shkaktuar ometimin, e në qoftë se pala ka mësuar më vonë për ometim, që nga dita kur ka mësuar për këtë gjë.

Pasi të kenë kaluar tre muaj nga dita e ometimit, nuk mund të kërkojë kthimi në gjendje të mëparshme.

Në qoftë se kthimi në gjendje të mëparshme propozohet për shkak të ometimit të afatit, propozuesi ka për detyrë që, njëkohësisht me paraqitjen e propozimit, ta kryejë edhe veprimin e ometuar.

Neni 119

Nuk do të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme në qoftë se është ometuar afati për paraqitjen e propozimit që të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme, apo në qoftë se është ometuar seanca e caktuar me rastin e propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme.

Neni 120

Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme, si rregull, nuk ndikon në procesin e kontestimit, por gjykata mund të vendos që procedura të ndërpritet derisa aktvendimi mbi propozimin të mos ketë marrë formën e prerë.

Në qoftë se gjykata ka marrë vendim që të ndërpritet procedura, kurse para gjykatës më të lartë është në vazhdim procedura me rastin e ankimit, për këtë vendim do të njoftohet gjykata më e lartë.

Neni 121

Propozimet e paraqitura jo në kohën e duhur dhe të palapushme për kthimin në gjendje të mëparshme kryetari i kolegjit do t'i hedhë poshtë me aktvendim.

Në bazë të propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme, gjykata do të caktojë seancën, përveç në qoftë se faktet në të cilat bazohet propozimi, janë të njohura për të gjithë.

Neni 122

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankimi, përveç në qoftë se propozimi është aprovuar në kundërshtim me nenin 119 të këtij ligji, apo në qoftë se propozimi nuk është paraqitur në kohën e duhur.

Kreu i nëntë

PROCESVERBALET

Neni 123

Procesverbali përpilohet mbi veprimet e ndërmarra në seancë.

Procesverbali përpilohet edhe mbi deklaratat apo komunikimet më të rëndësishme, që bëjnë palët ose pjesëmarrësit e tjerë jashtë seancës. Mbi deklaratat apo komunikimet më pak të rëndësishme nuk do të përpilohet procesverbali, por vetëm do të vihet shënimi zyrtar në shkresë.

Procesverbalin e shkruan procesmbajtësi.

Neni 124

Në procesverbal shkruhen: emërtimi dhe përbërja e gjykatës, vendi ku ushtrohet veprimi, dita dhe ora kur ushtrohet veprimi, emërtimi i objektit të kontestit dhe emrat e palëve të pranishme ose të personave të tretë dhe të përfaqësuesve e të autorizuesve të tyre ligjorë.

Procesverbali duhet të përmbajë të dhëna esenciale mbi përmbajtjen e veprimit të ndërmarrë. Në procesverbal mbi seancën kryesore duhet përfshirë sidomos: nëse seanca ka qenë publike ose është përjashtuar publiku, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që kanë ofruar, provat e paraqitura, duke treguar përmbajtjen e thënieve të dëshmitarëve e të ekspertëve, si dhe vendimet e gjykatës që janë marrë në seancë.

Neni 125

Procesverbali duhet të mbahet rregullisht, në të nuk guxohet të fshihet asgjë, të shtohet ose të ndryshohet. Vendet ku është vënë viza duhet të jenë të lexueshme.

Neni 126

Procesverbali përpilohet duke i treguar kryetari i kolegjit procesmbajtësit me zë se shka do të shkruajë në procesverbal.

Palët kanë të drejtë ta lexojnë procesverbalin ose të kërkojnë që t'u lexohet, si dhe të paraqesin kundërshtimet e veta në përmbajtjen e procesverbalit.

Këtë të drejtë kanë edhe personat e tjerë, deklaratat e të cilëve është përfshirë në procesverbal, por vetëm në pikëpamje të asaj pjese të procesverbalit që përmban deklaratën e tyre.

Ndreqjet ose shtesat në pikëpamje të përmbajtjes së procesverbalit që duhen bërë me rastin e kundërshtimit të palëve apo të personave të tjerë ose kryesisht, do të shkruhen në fund të procesverbalit. Me kërkesën e këtyre personave do të shkruhen edhe kundërshtimet që nuk janë aprovuar.

Neni 127

Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari i kolegjit, procesmbajtësi, palët, respektivisht përfaqësuesit ose autorizuesit e tyre ligjorë, si dhe interpreti.

Dëshmitari dhe eksperti e nënshkruajnë thënien e vet në procesverbal, kur dëgjimi i tyre bëhet para gjyqtarit të lutur ose kryetarit të kolegjit.

Personi analfabet ose personi që nuk mund të nënshkruhet do të vejë në procesverbal shënjen e

gishtit tregues, kurse procesmbajtësi do të vejë nën shënjen emrin dhe mbiemrin e tij.

Në qoftë se ndonjë nga palët, përfaqësuesi ose autorizuesi i saj ligjor, dëshmitari apo eksperti, largohet para nënshkrimit të procesverbalit ose nuk dëshiron ta nënshkruajë procesverbalin, kjo do të shënohet në procesverbal dhe do të tregohet arsyeja që është paraqitur.

Neni 128

Rreth këshillimit dhe votimit përpilohet procesverbal i veçantë. Në qoftë se pranë gjykatës më të lartë në procedurë në bazë të mjetit juridik është marrë vendimi njëzëri, nuk do të përpilohet procesverbali, por në origjinalin e vendimit do të vihet shënimi mbi këshillimin dhe votimin.

Procesverbali mbi këshillimin dhe votimin përmban procesin e votimit dhe vendimin që është marrë.

Mendimet e veçara shoqërojnë procesverbalin mbi këshillimin dhe votimin, në qoftë se nuk janë përfshirë në procesverbal.

Procesverbalin, respektivisht shënimin mbi votimin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e kolegjit dhe procesmbajtësi.

Procesverbali mbi këshillimin dhe votimin do të mbyllet në një kopertinë të veçantë. Ky procesverbal mund të shikohet vetëm nga gjykata më e lartë kur vendos mbi mjetin juridik, e në këtë rast procesverbali do të mbyllet përkësbri në një kopertinë të veçantë dhe mbi kopertinën do të shënohet se procesverbali është shikuar.

Kreu i dhjetë

MARRJA E VENDIMIT

Neni 129

Gjykata merr vendime në formë aktgjykimi ose aktvendimi.

Mbi kërkesë-padinë gjykata vendos me aktgjykim, kurse në procedurën për shkak të pengimit të posedimit, me aktvendim.

Në rastet kur nuk vendos me aktgjykim gjykata vendos me aktvendim.

Në procedurën e lëshimit të urdhërpagesës, aktvendimi me të cilin aprovohet kërkesë-padia nxirret në formë të urdhërpagesës.

Vendimi mbi shpenzimet në aktgjykim konsiderohet si aktvendim.

Neni 130

Vendimet e kolegjit aprovohen pas këshillimit, me votim.

Në lokalin ku bëhet këshillimi dhe votimi mund të jenë të pranishëm vetëm anëtarët e kolegjit dhe procesmbajtësi.

Kur duhet të merret vendimi mbi çështjet e thjeshta, kolegji mund të marrë vendim edhe në vetë seancën.

Neni 131

Kryetari i kolegjit drejton këshillimin dhe votimin dhe voton i fundit. Ai kujdeset që të gjitha çështjet të shqyrtohen në mënyrë të gjithanshme e të plotë. Për çdo vendim të kolegjit nevojitet shumica e votave.

Anëtarët e kolegjit nuk mund të refuzojnë që të votojnë rreth çështjeve që i shtrën kryetari i kolegjit. Anëtar i kolegjit, i cili gjatë votimit mbi ndonjë çështje të mëparshme ka mbetur në pakicë, nuk mund të abstenojë nga votimi mbi çështjen për të cilën do të vendoset më vonë.

Në qoftë se në pikëpamje të çështjeve të veçanta për të cilat vendoset ndahen votat në disa mendime të ndryshme, kështu që asnjë prej tyre nuk fiton shumicën, çështjet do të shkëputen dhe votimi do të përsëritet gjithnjë gjersa të mos realizohet shumica. Në qoftë se në pikëpamje të shumës apo të sasisë së para-

ve votat ndahen në më tepër se dy mendime, do të rishqyrtohen arsyet për çdo mendim, e në qoftë se edhe pas kësaj nuk mund të realizohet shumica, votat që janë dhënë për shumën ose sasinë më të madhe të parave do t'u shtohen votave që janë dhënë për ate që i afrohet shumës apo sasisë më të vogël, gjersa të mos realizohet shumica.

Neni 132

Para vendosjes mbi çështjen kryesore gjykata vendos nëse nevojitet që procedura të plotësohet, si dhe mbi çështjet e tjera paraprahe.

Në qoftë se gjatë vendosjes mbi çështjen kryesore duhet të vendoset për disa kërkesa, për secilën prej tyre do të votohet veç e veç.

Kreu i njëmbëdhjetë

DËRGIMI I LETRAVE DHE SHQYRTIMI I SHKRESAVE

Mënyra e dërgimit

Neni 133

Letrat dërgohen, si rregull, me anë të postës, kurse mund të dërgohen me anë të punëtorit të caktuar në gjykatë, me anë të organit kompetent të komunës, ose direkt në gjykatë.

Neni 134

Dërgimi organeve shtetërore, organizatave të punës së bashkuar dhe personave të tjerë shoqërorë apo civilë juridikë bëhet duke ia dhënë letrën personit të autorizuar për marrjen e letrave ose punëtorit që gjendet në zyrë, respektivisht në lokalitë e punës.

Kur letra duhet t'i dërgohet avokatit shoqëror të vetëqeverisjes, prokurorisë publike ose avokatisë publike, dërgimi bëhet duke ia dorëzuar letrën sekretarisë së tij. Si ditë e dërgimit konsiderohet dita kur letra t'i jetë dorëzuar sekretarisë.

Dërgimi sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni bëhet edhe kur palët e theksuara në atë paragraf kanë caktuar si autorizues të vet personin që është punëtor i tyre.

Neni 135

Personave ushtarakë, punëtorëve të milicisë dhe nëtorëve të komunikacionit tokësor, lumor, detar dhe ajror dorëzimi i thirrjes mund të bëhet edhe me anë të komandës, respektivisht të eprorit të tyre direkt, e sipas nevojë në këtë mënyrë mund t'u dërgohen edhe letrat e tjera.

Neni 136

Kur dërgimi duhet t'u bëhet personave ose institucioneve në botën e jashtme apo të huajve që gëzojnë të drejtën e imunitetit, dërgimi do të bëhet në rrugë diplomatike, në qoftë se në traktatin ndërkombëtar, apo në këtë ligj (neni 146) nuk është caktuar dishka tjetër.

Në qoftë se dërgimi i letrave duhet t'u bëhet shtetasve të RSFJ në botën e jashtme, dërgimi mund të bëhet me anë të përfaqësuesit kompetent konsullor apo diplomatik të RSFJ që ushtron punët konsullore në shtetin e huaj respektiv. Dërgimi i tillë është i plotëfuqishëm vetëm në qoftë se personi që i dërgohet letra pranon ta marrë.

Neni 137

Personave të privuar nga liria dërgimi bëhet me anë të drejtorisë së burgut, të institucionit ndëshkimor-korektonjës apo të shtëpisë edukative-korektonjëse.

Neni 138

Kur pala ka përfaqësuesin, respektivisht autorizuesin e vet ligjor dërgimi i bëhet përfaqësuesit, res-

pektivisht autorizuesit ligjor, në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar dishka tjetër.

Në qoftë se pala ka disa përfaqësues, respektivisht autorizues ligjor, mjafton që dërgimi t'i bëhet njërit prej tyre.

Neni 139

Dërgimi avokatit si autorizues mund t'i bëhet edhe duke ia dhënë letrat nëpunësit të inkuadruar në zyrën e tij të avokatisë.

Neni 140

Dërgimi bëhet në ditëpunë, gjatë ditës, në banesë ose në vendin e punës të personit të cilit duhet t'i bëhet dërgimi, ose në gjykatë, kur ky person gjendet atje.

Dërgimi mund të bëhet edhe në ndonjë kohë tjetër dhe në ndonjë vend tjetër, me pëlqimin e personit të cilit i bëhet dërgimi ose në bazë të vendimit të veçantë të gjykatës, të cilin letërdorëzuesi, me kërkesën e marrësit, duhet ta tregojë.

Dispozita që dërgimi të bëhet vetëm gjatë ditëpunës nuk vlen për dërgimin me anë të postës.

Neni 141

Në qoftë se personit të cilit duhet t'i bëhet dërgimi i letrës nuk gjendet në banesën e vet, dërgimi i bëhet duke ia dhënë letrën ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë letrën në dorëzim. Në qoftë se këta nuk gjenden në banesë, letra do t'i jepet kujdestarit të shtëpisë, ose fqinjit, në qoftë se këta e pranojnë këtë.

Po që se dërgimi bëhet në vendin e punës së personit të cilit duhet t'i jepet letra, kurse ky person nuk gjendet aty, letra mund t'i jepet personit që punon në të njëjtin vend, në qoftë se ai e pranon ta marrë letrën.

Dërgimi i letrave personit tjetër nuk lejohet po qe se ai merr pjesë në kontestim si kundërshtar i personit të cilit duhet t'i bëhet dërgimi.

Neni 142

Padia, urdhërpagesa, mjeti i jashtëzakonshëm juridik, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilëve lejohet aktimi i veçantë, do t'i jepen personalisht palës, respektivisht përfaqësuesit, apo autorizuesit të tij ligjor. Letrat e tjera do të jepen personalisht, kur kjo gjë në këtë ligj është caktuar shprehimisht, apo kur gjykata e quan se për shkak të dokumenteve të bashkuangjitura në origjinal ose për ndonjë shkak tjetër nevojitet një vigjilencë më e madhe.

Në qoftë se personi të cilit duhet t'i dërgohet letra personalisht nuk gjendet atje ku duhet të bëhet dorëzimi, letërdorëzuesi do të njoftohet se kur dhe në cilin vend do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lëjë pranë ndonjë personi të theksuar në nenin 141 paragrafet 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkronjë që për marrjen e letrës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, respektivisht në vendin e vet të punës. Po qe se edhe pas kësaj letërdorëzuesi nuk e gjen personin të cilit duhet t'i dorëzohet letra, do të veprojë sipas dispozitave të nenit 141 të këtij ligji, e në këtë mënyrë konsiderohet se dorëzimi është bërë.

Po qe se dorëzimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'u bëhet organeve shtetërore, organizatave të punës së bashkuar dhe organizatave apo bashkësive të tjera vetëqeverisëse, si dhe personave civilë juridikë, dorëzimi bëhet sipas dispozitave të nenit 134 të këtij ligji.

Neni 143

Në qoftë se vërtetohet se personit të cilit duhet t'i bëhet dorëzimi mungon dhe se personat e theksuar në nenin 141 paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund t'ia dorëzojnë letrën me kohë, letra do t'i kthehet gjykatës, duke theksuar se ku gjendet personi që mungon.

Refuzimi i marrjes

Neni 144

Kur personi të cilit i është drejtuar letra, respektivisht anëtar i rritur i familjes së tij, respektivisht personi i autorizuar ose punëtori i organit shtetëror, i organizatës së punës së bashkuar apo i organizatës ose i bashkësisë tjetër vetëqeverisëse, si dhe i personit civil juridik, pa ndonjë, shkak ligjor refuzon ta marrë në dorëzim letrën, letërdorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet ku personi respektiv punon apo do t'ia ngjies letrën në derën e banesës apo të lokalit. Në fletëdërgesën do të shënohen dita, ora dhe shkak i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë letra, e në këtë mënyrë konsiderohet se dorëzimi është bërë.

Ndërrimi i banesës

Neni 145

Kur pala ose përfaqësuesi i saj ligjor deri në dërgimin e vendimit të shkallës së dytë, me të cilin përfundohet procedura, e ndërrojnë vendbanimin ose adresën e tyre, kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

Në qoftë se ata nuk e bëjnë këtë, kurse letërdorëzuesi nuk mund të mësojë se në cilin vend respektivisht në cilën banesë janë shpërngulur, gjykata do të caktojë që të gjitha letrat e tjera në kontestim për këtë pale të bëhen duke i ngjitur letrat në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Dorëzimi quhet i kryer pasi të kenë kaluar tetë ditë nga data kur letra të jetë ngjitur në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Kur përfaqësuesi, respektivisht autorizuesi për marrjen e letrave deri në dorëzimin e vendimit të shkallës së dytë me të cilin përfundohet procedura, e ndërrojnë vendbanimin ose banesën e vet ndërsa për këtë gjë nuk e njofton gjykatën, dorëzimi do të bëhet sikur përfaqësuesi të mos jetë caktuar.

Autorizuesi për marrjen e letrave

Neni 146

Palën ose përfaqësuesin e saj ligjor që ndodhet në botën e jashtme, ndërsa nuk kanë autorizues në RSFJ, gjykata do ta ftojë që brenda afatit të caktuar të caktojë autorizuesin për marrjen e letrave në RSFJ. Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj ligjor nuk e caktojë autorizuesin e tillë, gjykata do t'ia caktojë palës, me shpenzimet e saj, përfaqësuesin e përkohshëm të autorizuar për marrjen e letrave dhe për këtë gjë do ta njoftojë palën, respektivisht përfaqësuesin e saj ligjor.

Neni 147

Në qoftë se disa persona padisin bashkarisht, kurse nuk kanë përfaqësuesin, respektivisht autorizuesin e përbashkët të tyre ligjor, gjykata mund t'i ftojë që brenda afatit të caktuar të emërojnë autorizuesin e përbashkët për marrjen e letrave. Njëkohësisht, gjykata do t'i njoftojë paditësit se cilin ata do ta konsiderojnë autorizues të përbashkët për marrjen e letrave, po që se këta vetë nuk e emërojnë autorizuesin e tillë.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni do të aplikohet edhe kur janë paditur disa persona si bashkëndërgjyqësia unik.

Vërtetimi i adresës

Neni 148

Në qoftë se pala vetë është në pamundësi ta mësojë adresën e personit të cilit duhet t'i dërgohet letra, gjykata do t'i përpigjet që prej organit kompetent të administratës ose në ndonjë nënryre tjetër, të marrë të dhëna të nevojshme.

Fletëdorëzimi

Neni 149

Vërtetimin mbi dorëzimin e bërë (fletëdorëzimin) e nënshkruajnë marrësi dhe dorëzuesi. Marrësi do ta shkruarjë vetë me shkronja në fletëdorëzim datën e marrjes.

Në qoftë se marrësi është analfabet apo nuk është në gjendje të nënshkruhet, letërdorëzuesi do të shkruajë emrin dhe mbiemrin e tij e me shkronja ditën e marrjes dhe do të vëjë shënim pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.

Në qoftë se marrësi refuzon ta nënshkruajë fletëdorëzimin, letërdorëzuesi do ta shënojë këtë në fletëdorëzimin dhe do ta shkruajë me shkronja ditën e dorëzimit dhe konsiderohet se me këtë gjë dorëzimi është kryer.

Në qoftë se dorëzimi është kryer sipas dispozitës se nenit 142 paragrafi 2 të këtij ligji në fletëdorëzim, përpos vërtetimit mbi marrjen e letrës, do të shënohet se më parë është dhënë njoftimi me shkrim.

Kur sipas dispozitave të këtij ligji letra i është dorëzuar personit tjetër dhe jo atij të cilit është dashur që t'i dorëzohet letra, në fletëdorëzim letërdorëzuesi do të shënojë raportin e këtyre dy personave.

Në qoftë se në fletëdorëzim është shënuar në mënyrë të pasaktë data e dorëzimit, do të konsiderohet se dorëzimi është bërë atë ditë kur është dorëzuar letra.

Në qoftë se fletëdorëzimi ka humbur, dorëzimi mund të provohet edhe në ndonjë mënyrë tjetër.

Shqyrtimi dhe kopjimi i shkresave

Neni 150

Palët kanë të drejtë t'i shqyrtojnë dhe t'i kopjojnë shkresat e kontestimit ku marrin pjesë.

Personave të tjerë që kanë interes të arsyeshëm mund t'u lejohet shqyrtimi dhe kopjimi i shkresave të veçanta. Kur procedura është në vazhdim, lejen e jep kryetari i kolegjit, kurse kur procedura ka marrë fund, kryetari i gjykatës, respektivisht punëtori në gjykatë të cilin e cakton ai.

Kreu i dymbëdhjetë

SHPENZIMET E PROCEDURËS

Shpenzimet e kontestimit

Neni 151

Shpenzimet e kontestimit i përbëjnë harxhimet e bëra gjatë ose me rastin e procedurës.

Shpenzimet e kontestimit përfshijnë edhe shpërblimin për punën e avokatit dhe të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit.

Neni 152

Secila palë i përballon më parë vetë shpenzimet që i ka shkaktuar nga veprimet e veta.

Neni 153

Kur pala propozon paraqitjen e provave, ka për detyrë që sipas urdhërit të gjykatës të paradeponojë shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve që do të krijohen me rastin e paraqitjes së provave.

Kur paraqitjen e provave e propozojnë të dy palët, apo kur caktohet prej gjykatës kryesisht, gjykata do të caktojë që shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve t'i deponojnë të dy palët në pjesë të barabarta. Në qoftë se gjykata ka caktuar paraqitjen e provave kryesisht, mund të caktojë që shumën ta deponojë vetëm njëra palë.

Gjykata do të heqë dorë nga paraqitja e provave në qoftë se shumën e nevojshme për mbulimin e shpen-

zimeve nuk deponohet në atëtin të cilin e cakton gjykata.

Përfashtimisht nga dispozita e paragrafit 3 të këtij neni, në qoftë se gjykata cakton kryesisht paraqitjen e provave për vertetimin e fakteve lidhur me aplikimin e nenit 3 paragrafi 3 të këtij ligji, kurse palët nuk e deponojnë shumën e caktuar, shpenzimet për paraqitjen e provave do të paguhet nga mjetet e gjykatës.

Neni 154

Pala e cila e humb kontestimin tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare dhe ndërhyrësit të saj t'i kompensojë shpenzimet.

Në qoftë se pala pjesërisht ka sukses në kontestim, gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i përballojë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia kompensojë tjetrës dhe ndërhyrësit pjesën proporcionale të shpenzimeve.

Gjykata mund të vendos që njëra palë t'i kompensojë të gjitha shpenzimet që kanë pasur pala kundërshtare dhe ndërhyrësi i saj, në qoftë se pala kundërshtare nuk ka pasur sukses vetëm në pjesën proporcionale të parëndësishme të kërkesës së vet, kurse për shkak të kësaj pjese nuk kanë lindur shpenzime të veçanta.

Sipas rezulttit të provave gjykata do të vendos nëse shpenzimet nga neni 153 paragrafi 4 të këtij ligji do t'i përballojë njëra apo të dy palët, ose këto shpenzime do të ngarkojnë mjetet e gjykatës.

Neni 155

Kur vendos se cilat shpenzime do t'ia kompensojë palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për zhvillimin e kontestimit. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke emuar me kujdes të gjitha rrethanat.

Në qoftë se është parashikuar tarifa për shpërblymin e avokatëve, ose për shpenzimet e tjera, këto shpenzime do të maten sipas kësaj tarife.

Neni 156

Pala ka për detyrë që, pavarësisht nga rezultati i kontestimit, t'i kompensojë palës kundërshtare shpenzimet që ia ka shkaktuar me faj të vet ose nga rasti që i ka ndodhur asaj.

Gjykata mund të vendos që përfaqësuesi ose autoriteti ligjor i palës t'i kompensojë palës kundërshtare shpenzimet që i ka shkaktuar me faj të vet.

Neni 157

Në qoftë se paditësi nuk ka dhënë shkas për padi dhe në qoftë se në përgjigje të padisë, respektivisht në seancën pregatitore, e në qoftë se nuk mbahet seanca pregatitore atëherë në seancën kryesore, para se ka hyrë në shqyrtimin e çështjes kryesore, e ka pohuar kërkesë-padinë, paditësi do t'ia kompensojë të paditurit shpenzimet e kontestimit.

Neni 158

Paditësi që e tërheq padinë ka për detyrë që palës kundërshtare t'ia kompensojë shpenzimet e kontestimit, përveç në qoftë se tërëheqja e padisë është bërë menjëherë pas përmbushjes së kërkesës nga ana e të paditurit.

Pala që heq dorë nga mjeti juridik ka për detyrë që palës kundërshtare t'ia kompensojë shpenzimet e krijuara me rastin e mjetit juridik.

Neni 159

Secila palë i përballon shpenzimet e veta në qoftë se kontestimi ka përfunduar me pajtim gjyqësor, kurse në pajtim nuk është kontraktuar ndryshe.

Shpenzimet e pajtimit që është tentuar (neni 321), por që nuk ka pasur sukses hyjnë në shpenzimet e kontestimit.

Neni 160

Në qoftë se në kontestimin veçues aprovohet kërkesë-padi për veçimin e sendeve, kurse gjykata vërteton se i padituri si kreditor në procesin ekzekutiv ka pasur shkaqe të arsyeshme për të konsideruar se nuk ekzistojnë të drejtat e personave të tretë mbi këto sende, do të caktojë që secila palë t'i përballojë shpenzimet e veta.

Neni 161

Bashkëndërgjyqësat i përballojnë shpenzimet në pjesë të barabarta.

Në qoftë se ekziston dallimi i rëndësishëm në pikëpamje të kontributit të tyre në objektin e kontestit, gjykata do të caktojë, sipas përpjestimit të këtij kontributi, sa do të jetë pjesa e shpenzimeve të cilën do ta kompensojë secili prej bashkëndërgjyqësave.

Bashkëndërgjyqësat që janë përgjegjës solidarisht në çështjen kryesore, përgjigjen solidarisht edhe për shpenzimet që ia ka caktuar gjyqi palës kundërshtare.

Për shpenzimet e shkaktuara nga veprimet e veçanta kontestimore të bashkëndërgjyqësve të veçantë, bashkëndërgjyqësat e tjerë nuk përgjigjen.

Neni 162

Kur avokati shoqëror i vetëqeverisjes, respektivisht prokurori publik merr pjesë në procedurë si palë, ai ka të drejtë kompensimi të shpenzimeve sipas dispozitave të këtij ligji, por jo edhe të drejtë shpërblymimi.

Shpenzimet të cilat sipas dispozitave të këtij ligji është dashur t'i përballojë avokati shoqëror i vetëqeverisjes, respektivisht prokurori publik do të paguhet prej mjeteve të gjykatës.

Secila palë i përballon shpenzimet e veta që janë krijuar nga pjesëmarrja e avokatit shoqëror të vetëqeverisjes, respektivisht të prokurorit publik në procedurë (nenet 204 dhe 205).

Shpenzimet të cilat avokati shoqëror i vetëqeverisjes, respektivisht prokurori publik ka pasur me rastin e pjesëmarrjes së vet në procedurë (nenet 204 dhe 205) ngarkojnë mjetet e avokatit shoqëror të vetëqeverisjes, respektivisht të prokurorisë publike.

Neni 163

Dispozitat mbi shpenzimet aplikohen edhe ndaj palëve që i përfaqëson avokatia publike. Në këtë rast shpenzimet e procedurës përfshijnë edhe shumën që do t'i njiheshin palës për efekt shpërblymimi avokatit.

Neni 164

Mbi kompensimin e shpenzimeve vendos gjykata me kërkesë të caktuar të palës, pa shqyrtim.

Pala ka për detyrë që në kërkesë të theksojë shpenzimet për të cilat kërkon kompensim.

Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve duhet të paraqitet nga pala jo më vonë se deri në mbarim të shqyrtimit që vjen para vendosjes mbi shpenzimet, e në qoftë se është fjala për marrjen e vendimit pa shqyrtim paraprak, pala ka për detyrë që kërkesën për kompensimin e shpenzimeve ta bëjë në propozimin rreth të cilit gjykata duhet të vendos.

Mbi kërkesën për kompensimin e shpenzimeve gjykata do të vendos në aktgjykim ose në aktvendim, me të cilin përfundohet procedura para kësaj gjykate.

Në rast të shpalljes verbale të aktgjykimit apo të aktvendimit, me të cilin urdhërohet kompensimi i shpenzimeve, gjykata mund të vendos që shumën e shpenzimeve të caktohet në aktgjykimin e hartuar me shkrim, respektivisht në aktvendim, në qoftë se aktvendimi u duhet dërguar palëve.

Cilat procedurë gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë mbi kompensimin e shpenzimeve vetëm kur e drejta e kompensimit të shpenzimeve nuk varret nga vendimi mbi çështjen kryesore.

Në rastin nga neni 158 i këtij ligji, në qoftë se kërkesja e padisë ose heqja dorë nga mjeti juridik

nuk është bërë në shqyrtim, kërkesa për kompensimin e shpenzimeve mund të paraqitet brenda 15 ditësh pas marrjes së njoftimit mbi heqjen dorë.

Neni 165

Në aktgjykimin e pjesshëm apo në ndërtgjykimin gjykata mund të caktojë që vendimi mbi shpenzimet të lihet për aktgjykim të mëvonshëm.

Neni 166

Kur gjykata e hedh poshtë ose e refuzon mjetin juridik, do të vendos edhe mbi shpenzimet e krijuara në procedurë me rastin e këtij mjeti juridik.

Kur gjykata e ndryshon vendimin kundër të cilit është paraqitur mjeti juridik ose e prish këtë vendim dhe e hedhë poshtë padinë, do të vendos mbi shpenzimet e krejt procedurës.

Kur prishet vendimi kundër të cilit është paraqitur mjeti juridik dhe objekti kthehet për rigjykim, do të lihet që rreth shpenzimeve të procedurës me rastin e mjetit juridik të vendoset në vendimin definitiv.

Gjykata mund të veprojë sipas dispozitës së paragrafit 3 të këtij neni edhe kur vendimin kundër të cilit është paraqitur mjeti juridik e prish vetëm pjesërisht.

Neni 167

Vendimi mbi shpenzimet, përmbajtur në aktgjykim, mund të kundërshtohet vetëm me ankim kundër aktvendimit, po që se njëkohësisht nuk kundërshtohet edhe vendimi mbi çështjen kryesore.

Në qoftë se njëra palë e kundërshton aktgjykimin vetëm në pikëpamje të shpenzimeve, kurse tjetra në pikëpamje të çështjes kryesore, gjykata më e lartë do të vendos me një vendim mbi të dy mjete juridike.

Shpenzimet në procedurë për sigurimin e provave

Neni 168

Shpenzimet e procedurës për sigurimin e provave i përballon pala që ka paraqitur propozimin për sigurimin e provave. Ajo ka për detyrë që t'i kompensojë edhe shpenzimet palës kundërshtare, respektivisht përfaqësuesit të caktuar të përkohshëm.

Këto shpenzime pala mund t'i realizojë më vonë si pjesë e shpenzimeve të kontestimit, sipas suksesit në kontestim.

Sigurimi i shpenzimeve të kontestimit

Neni 169

Kur shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi bën padi në RSFJ, ka për detyrë që paditësit, me kërkesën e tij, t'i sigurojë shpenzimet e kontestimit.

I padituri ka për detyrë që këtë kërkesë ta paraqesë më së voni në seancën pregatitore, e në qoftë se ajo nuk është mbajtur, atëherë në seancën e parë për seancën kryesore, para se të hyjë në shqyrtim rreth çështjes kryesore, respektivisht posa të ketë mësuar se ekzistojnë prezumime për kërkesën e sigurimit.

Sigurimi jepet në para të gatshme, por gjykata mund të akordojë dhënien e sigurimit edhe në formë tjetër.

Neni 170

I padituri nuk ka të drejtë në sigurimin e shpenzimeve të kontestimit:

1) në qoftë se në shtetin, të cilit i përket paditësi shtetasi i RSFJ nuk ekziston obligimi që të jepet sigurimi;

2) në qoftë se paditësi gëzon në RSFJ të drejtën e azilit;

3) në qoftë se kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesën e paditësit nga marrëdhënia e tij e punës në RSFJ;

4) në qoftë se zhvillohet kontestimi mbi qenien ose mbi mosqenien e martesës, mbi anulimin e martesës ose mbi zgjidhjen e martesës apo kontesti mbi vërtetimin ose mbi kontestimin e atësisë, respektivisht të amësisë;

5) në qoftë se është fjala për padinë kambiale apo të çekut, për kundërpadinë ose për dhënien e urdhër-pagesës.

Në rast dyshimi nëse shtetasit e RSFJ janë të obliguar ose jo që të japin sigurim në shtetin të cilit i përket paditësi, spjegimin e jep organi federativ i administratës me kompetencë për punët e judikaturës.

Neni 171

Në aktvendim me të cilin aprovohet kërkesa për sigurimin e shpenzimeve të kontestimit, gjykata do të caktojë shumën e sigurimit dhe afatin në të cilin duhet të jepet sigurimi, kurse do ta paralajmërojë paditësin për pasojat që parashikon ligji, në qoftë se nuk provohet se është dhënë sigurimi në afatin e caktuar.

Në qoftë se paditësi në afatin e caktuar nuk provon se e ka dhënë sigurimin për shpenzimet e procedurës, do të konsiderohet se padia është tërhequr, respektivisht se paditësi ka hequr dorë nga mjeti juridik në qoftë se kërkesa për sigurimin është paraqitur vetëm me procedurën me rastin e mjetit juridik.

I padituri, i cili e ka paraqitur në kohën e duhur kërkesën që paditësi t'i sigurojë shpenzimet, nuk e ka për detyrë ta vazhdojë procedurën në çështjen kryesore gjithnjë gjersa të mos vendoset në formë të prerë mbi kërkesën e tij, e në qoftë se kërkesa aprovohet, gjersa paditësi të mos e deponojë sigurimin. Mirëpo, në qoftë se gjykata e refuzon kërkesën për sigurimin, mund të vendos që procedura të vazhdojë edhe para se aktvendimi mbi rezufimin të ketë marrë formën e prerë.

Lirimi nga pagimi i shpenzimeve të procedurës

Neni 172

Gjykata do ta lirojë nga pagimi i shpenzimeve të procedurës palën e cila, sipas gjendjes së vet të përgjithshme pasurore, është në pamundësi t'i përballojë ato shpenzime pa dëmtuar ushqimin e vet të domoshëm dhe ushqimin e familjes së vet.

Lirimi nga pagimi i shpenzimeve të procedurës përfshin lirimin nga pagimi i taksave dhe lirimin nga deponimi i paradhënies për shpenzimet e dëshmitarëve, të ekspertëve të këqyrjes në vend e të shpalljeve të gjykatës.

Gjykata mund ta lirojë palën vetëm nga pagimi i taksave në qoftë se me pagimin e taksave do të pakësoheshin në mënyrë të rëndësishme mjetet prej të cilave ushqehen pala dhe anëtarët e familjes së saj.

Kur e merr vendimin mbi lirimin nga pagimi i shpenzimeve të procedurës gjykata do t'i çmojë me kujdes të gjitha rrethanat e sidomos do të marrë parasysh vlerën e objektit të kontestit, numrin e personave që i ka në ngarkim pala dhe të ardhurat që kanë pala dhe anëtarët e familjes së saj.

Neni 173

Vendimi mbi lirimin nga pagimi i shpenzimeve të procedurës merret nga gjykata e shkallës së parë me propozimin e palës.

Pala ka për detyrë që, bashkë me propozimin, të paraqesë certifikatën e organit kompetent të administratës mbi gjendjen pasurore.

Në certifikatën mbi gjendjen pasurore duhet të theksohet shuma e tatimit që paguhet nga ekonomia shtëpiake dhe nga anëtarët e veçantë të ekonomisë shtëpiake, si dhe burimet e të ardhurave të tyre e në përgjithësi gjendja pasurore e palës të cilës i jepet certifikata.

Dispozitat më të hollësishme mbi gjendjen pasurore i miraton organi i caktuar me dispozitë republikanë, respektivisht krahinore.

Kur kjo është e nevojshme edhe vetë gjykata mund të marrë kryesisht të dhëna të nevojshme dhe njoftime mbi gjendjen pasurore të palës, e cila kërkon lirin, e për këtë gjë mund të dëgjojë edhe palën kundërshtare.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin aprovohet propozimi i palës nuk lejohet ankimi.

Neni 174

Kur pala është liruar krejtësisht nga pagimi i shpenzimeve të procedurës (neni 172 paragrafi 2), gjykata e shkallës së parë, me kërkesën e saj, do të caktojë që ta përfaqësojë autorizuesi, po qe se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të palës.

Pala të cilës i është caktuar autorizuesi shkakohet nga pagimi i shpenzimeve faktike e të shpërblimit autorizuesit të caktuar.

Si autorizues caktohet avokati, por në qoftë se në selinë e gjykatës nuk ka avokatë të mjaftueshëm, autorizues mund të caktohet edhe personi tjetër i përgatitje juridike, i aftë për të dhënë ndihmë të nevojshme juridike.

Autorizuesin nga rradha e avokatëve e cakton kryetari i gjykatës, e në qoftë se gjykata më e ultë e shkallës së parë ndodhet në selinë e gjykatës më të lartë të shkallës së parë, autorizuesin e cakton kryetari i gjykatës më të lartë të shkallës së parë.

Autorizuesi i caktuar mund të kërkojë për shkaqe të arsyeshme që të shkarkohet. Për këtë gjë vendos jashtë seancës kryesore kryetari i kolegjit, kurse në seancë vendos kolegji. Kundër vendimit të gjykatës, me të cilin shkarkohet autorizuesi, nuk lejohet ankimi.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin aprovohet kërkesa e palës mbi caktimin e autorizuesit, nuk lejohet ankimi.

Neni 175

Kur pala është liruar krejtësisht nga pagimi i shpenzimeve të procedurës (neni 172 paragrafi 1), nga mjetet e gjykatës do të paguhet paradhënia për shpenzimet e dëshmitarëve, të ekspertëve, të kqyrjes në vend e të botimit të shpalljes së gjykatës, si dhe shpenzimet faktike të autorizuesit të caktuar.

Neni 176

Aktvendimi mbi lirin nga pagimi i shpenzimeve dhe mbi caktimin e autorizuesit gjykata e shkallës së parë mund ta prish gjatë procedurës, në qoftë se vërtetohet se pala është në gjendje t'i përballojë shpenzimet e procedurës. Me këtë rast gjykata do të vendos nëse pala do t'i kompensojë krejtësisht apo pjesërisht edhe ato shpenzimet dhe taksa nga të cilat është liruar më parë, si dhe shpenzimet faktike dhe shpërblimin për autorizuesin e caktuar.

Në radhë të parë duhen kompensuar shpenzimet e paguara nga mjetet e gjykatës.

Neni 177

Taksat dhe shpenzimet e paguara nga mjetet e gjykatës, si dhe shpenzimet faktike dhe shpërblimi për autorizuesin e caktuar, përbëjnë një pjesë të shpenzimeve të kontestimit.

Mbi kompensimin e këtyre shpenzimeve nga ana e palës kundërshtare, që është liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos sipas dispozitave mbi kompensimin e shpenzimeve.

Taksat dhe shpenzimet e paguara nga mjetet e gjykatës arkëtohen kryesisht nga gjykata e shkallës së parë prej palës që e ka për detyrë t'i kompensojë.

Në qoftë se kundërshtari i palës që është liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës është dënuar që t'i kompensojë shpenzimet e kontestimit, kurse vërtetohet se ai nuk është në gjendje t'i paguajë këto shpenzime, gjykata mund të caktojë më vonë që shpen-

zimet nga paragrafi 1 i këtij neni t'i paguajë tërësisht apo pjesërisht pala që është liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës prej asaj që i është caktuar nga gjykata. Në këtë mënyrë nuk preket në të drejtën e kësaj pale që për atë të cilën e ka paguar të kërkojë kompensim nga kundërshtari.

Neni 178

Shtetasi i huaj do të lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës vetëm me konditë reciprociteti.

Në rast dyshimi për ekzistimin e reciprocitetit, spjegimin e jep organi federativ i administratës me kompetencë për punët e judikaturës.

Kreu i trembëdhjetë

NDIHMA JURIDIKE

Neni 179

Gjykatat kanë për detyrë t'i japin njëra tjetrës ndihmë juridike në procedurën kontestimore.

Në qoftë se gjykata e lutur nuk është kompetente ta kryejë veprimin për të cilin është lutur, do t'ia cetojë lutjen gjykatës kompetente, respektivisht organit tjetër shtetëror, e për këtë gjë do ta njoftojë gjykatën nga e cila ka marrë lutjen, e po qe se nuk ka dijeni për gjykatën kompetente, respektivisht për organin shtetëror, do ta kthojë lutjen.

Në qoftë se në një vend ekzistojnë disa gjykata me kompetencë lëndore për dhënien e ndihmës juridike, lutja për dhënien e ndihmës juridike mund t'i paraqitet cilësdos prej këtyre gjykatave, në qoftë se me dispozitat republikane, respektivisht krahinore nuk është caktuar ndryshe.

Neni 180

Gjykatat nga territoret e republikave të ndryshme, respektivisht të krahinave autonome komunikojë me njëra-tjetrën në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatën e tyre.

Në qoftë se letra është përpiluar në gjuhën e kombësisë së Jugosllavisë, kurse i drejtohet gjykatës ku gjuha e kësaj kombësie nuk është në përdorim zyrtar, bashkë me letrën në gjuhën e kombësisë, do të bashkangjitet edhe përkthimi i kësaj letrë në gjuhën e kombit të Jugosllavisë, që është në përdorim zyrtar në gjykatën të cilës i drejtohet letra.

Neni 181

Gjykatat do t'u japin ndihmë juridike gjykatave të huaja në raste të parashikuara me traktat ndërkombëtar, si dhe kur ekziston reciprociteti në dhënien e ndihmës juridike. Në rast dyshimi për ekzistimin e reciprocitetit, spjegimin e jep organi federativ i administratës me kompetencë për punët e judikaturës.

Gjykata nuk do t'i japë ndihmë juridike gjykatës së huaj në qoftë se kërkon kryerjen e veprimit që është në kundërshtim me rendin publik të RSFJ. Në një rast të tillë gjykata me kompetencë për dhënien e ndihmës juridike do t'ia dërgojë kryesisht objektin gjykatës supreme të republikës, respektivisht të krahinës autonome, për marrjen e vendimit definitiv.

Dispozitat e nenit 179 paragrafet 2 dhe 3 të këtij ligji aplikohen edhe për veprime me lutjen e gjykatës së huaj.

Neni 182

Gjykatat u japin ndihmë juridike gjykatave të huaja sipas mënyrës së parashikuar në ligjin e vendit. Veprimi që është objekt i lutjes të gjykatës së huaj mund të kryhet edhe në mënyrën që kërkon gjykata e huaj, në qoftë se veprimi i tillë nuk është në kundërshtim me rendin publik të RSFJ.

Neni 183

Në qoftë se me traktat ndërkombëtar nuk është caktuar dishka tjetër, gjykatat do t'i marrin në pro-

cedim lutje për dhënien e ndihmës juridike të gjykatave të huaja vetëm po që se janë dërguar në rrugë diplomatike dhe në qoftë se lutja dhe anekset janë përpiluar në një nga gjuhët e kombeve të Jugosllavisë, apo në qoftë se është bashkangjitur përkthimi i legalizuar në atë gjuhë.

Neni 184

Në qoftë se me traktat ndërkombëtar nuk është caktuar dishka tjetër, lutjet e gjykatave të vendit për dhënien e ndihmës juridike u dërgohen gjykatave të huaja në rrugë diplomatike. Lutjet me anekset duhet të përpilohen në gjuhën e shtetit të lutur, ose duhet t'u bashkangjitet përkthimi i tyre i legalizuar në atë gjuhë.

Pjesa e dytë

RRJEDHEJA E PROCEDURËS

a. Procedura para gjykatës të shkallës së parë

Kreu i katërmëdhjetë

PADIA

Neni 185

Procedura kontestimore fillohet me padinë.

Përmbajtja e padisë

Neni 186

Padia duhet të përmbajë kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore e të kërkesave aksesore, fakte në të cilat paditësi e bazon kërkesën, provat që i vërtetojnë këto fakte, si dhe të dhënat e tjera, të cilat duhet t'u ketë çdo parashtrës (neni 106).

Kur kompetenca, përbërja e gjykatës ose e drejta e revizionit varen nga vlera e objektit të kontestit, kurse objekti i kërkesës—padiisë nuk është shuma e të hollave, paditësi ka për detyrë që në padinë të theksojë vlerën e objektit të kontestit.

Gjykata do të veprojë në bazë të padiisë edhe kur paditësi nuk e ka theksuar bazën juridike të kërkesës—padiisë, e në qoftë se paditësi e ka theksuar bazën juridike, gjykatën kjo gjë nuk e obligon.

Padi vërtetimi

Neni 187

Paditësi mund të kërkojë në padinë që gjykata vetëm të vërtetojë qënien apo mosqënien e ndonjë të drejte ose të raportit juridik, ose vërtetësinë, respektivisht mosvërtetësinë e ndonjë dokumenti.

Padia e tillë mund të ngritjet kur kjo është parashkuar me dispozitë të veçantë, kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë qënien apo mosqënien e ndonjë të drejte apo të raportit juridik, ose vërtetësinë, respektivisht mosvërtetësinë e ndonjë dokumenti para skadimit të kërkesës për veprim nga i njëjti raport, ose kur paditësi ka ndonjë interes tjetër juridik për ngritjen e padiisë së tillë.

Në qoftë se vendimi mbi kontestin varet nga fakti nëse ekziston ose nuk ekziston ndonjë raport juridik, i cili gjatë kontestimit është bërë i kontestueshëm, paditësi, përpos kërkesës ekzistuese, mund të theksojë edhe kërkesë—padinë që gjykata të vërtetojë se raporti i tillë ekziston, respektivisht se nuk ekziston, po që se gjykata para së cilës zhvillohet kontestimi është kompetente për kërkesë të tillë.

Theksimi i kërkesës në vështrim të dispozitës së paragrafit 3 të këtij neni nuk do të konsiderohet si ndryshim i padiisë.

Theksimi i disa kërkesave—padiëve në një padi

Neni 188

Në një padi paditësi mund të theksojë disa kërkesa kundër të njëjtit të paditur, kur të gjitha këto kërkesa janë të lidhura me bazën e njëjtë faktike e juridike. Në qoftë se kërkesat nuk janë të lidhura me të njëjtën bazë faktike dhe juridike, ato mund të theksohen në një padi kundër të njëjtit të paditur vetëm kur e njëjta gjykatë është me kompetencë lëndore për secilën nga këto kërkesa dhe kur për të gjitha kërkesat është caktuar i njëjti lloj procedimi.

Paditësi mund të theksojë dy ose më tepër kërkesë—padi në ndërlidhje reciproke brenda një padie, kështu që gjykata të aprovojë kërkesën pasuese në qoftë se konstaton se ajo që vjen përpara saj e që është theksuar nuk është e bazuar.

Kërkesat mund të theksohen sipas paragrafit 2 të këtij neni në një padi vetëm në qoftë se gjykata është me kompetencë lëndore për secilën kërkesë të theksuar dhe në qoftë se për të gjitha kërkesat është caktuar i njëjti lloj procedimi.

Në qoftë se mbi disa prej kërkesave të theksuara në të njëjtën padi duhet të gjykojë kolegji i gjykatës, kurse mbi të tjera gjyqtari i vetëm i së njëjtës gjykatë, mbi të gjitha kërkesa do të gjykojë kolegji.

Kundërpadia

Neni 189

Paditësi, deri në përfundimin e seancës kryesore, mund të paraqes para gjykatës pranë së njëjtës gjykatë kundërpadinë, në qoftë se kërkesa e kundërpadiisë është në lidhje me kërkesë—padinë, apo në qoftë se këto kërkesa mund të kompensohen, ose në qoftë se me kundërpadinë kërkohet vërtetimi i ndonjë të drejte apo i raportit juridik prej qënies apo të mosqënies të të cilit varet tërësisht apo pjesërisht vendimi mbi kërkesë—padinë.

Kundërpadia nuk mund të paraqitet në qoftë se për kërkesën nga kundërpadia me kompetencë lëndore është gjykata më e lartë ose gjykata e llojit tjetër.

Kundërpadia nuk mund të paraqitet edhe kur mbi kërkesën nga kundërpadia duhet të gjykojë e njëjta gjykatë në përbërje tjetër.

Ndryshimi i padiisë

Neni 190

Paditësi mund ta ndryshojë padinë deri në përfundimin e seancës kryesore.

Pasi padia t'i jetë dërguar të paditurit, për ndryshimin e padiisë nevojitet pëlqimi i të paditurit, por edhe kur i padituri e kundërshton, gjykata mund të lejojë ndryshimin në qoftë se e quan këtë të përshtatshme për zgjidhjen definitive të marrëdhënieve midis palëve.

Do të konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padiisë në qoftë se ai hyn në shqyrtimin e çështjes kryesore rreth padiisë së ndryshuar, kurse para kësaj nuk e ka kundërshtuar ndryshimin.

Në qoftë se gjykata kontestimore për ndryshimin e padiisë është me kompetencë lëndore, do t'ia dërgojë objektin gjykatës kompetente e cila, në qoftë se i padituri e kundërshton ndryshimin, do të vendos nëse ndryshimi është i lejueshëm.

Sipas mënyrës së parashkuar në paragrafin 4 të këtij neni do të veprojë edhe në rastin kur në bazë të padiisë së ndryshuar duhet të gjykojë e njëjta gjykatë në përbërje tjetër (neni 18).

Kur gjykata e lejon ndryshimin e padiisë, ka për detyrë t'ia lejë të paditurit një kohë të nevojshme për t'u përgatitur për shqyrtim rreth padiisë së ndryshuar, në qoftë se për këtë gjë nuk ka pasur kohë të mjaftueshme. Në të njëjtën mënyrë gjykata do të veprojë po që se i padituri, i cili nuk e kundërshton

ndryshimin, kërkon që t'i bëjë një kohë e nevojshme për prapëtim.

Në qoftë se padia është ndryshuar në seancë ku i padituri nuk është pranishëm, gjykata do ta shtyjë seancën dhe do t'ia dërgojë të paditurit kopjen e procesverbalit nga kjo seancë.

Kudër aktivendimit, me të cilin aprovohet ndryshimi i padisë, nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 191

Ndryshimi i padisë është ndryshimi i autenticitetit të kërkesës, shtimi i kërkesës ekzistuese ose theksimi i kërkesës tjetër përpos asaj ekzistuese.

Në qoftë se i padituri e ndryshon padinë kështu që, për shkak të rrethanave që kanë lindur pas paraqitjes së padisë, kërkon nga e njëjta bazë faktike objekt tjetër ose shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtojë ndryshimin e tillë.

Padia nuk quhet e ndryshuar në qoftë se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesë-padisë, po që se e ka pakësuar kërkesë-padinë ose në qoftë se e ka ndryshuar, plotësuar ose i ka ndrequr thëniet e veçanta, kështu që për këtë arsye, kërkesë-padia nuk është ndryshuar.

Neni 192

Paditësi mundet, deri në përfundimin e seancës kryesore, ta ndryshojë padinë e vet edhe duke e paditur personin tjetër në vend të atij të mëparshëm.

Për ndryshimin e padisë në veshtrim të paragrafit 1 të këtij neni, nevojitet pëlqimi i personave që duhet të hyjnë në kontestim në vend të të paditurit, e në qoftë se i padituri ka hyrë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i të paditurit.

Personi që hyn në kontestim në vend të paditurit duhet ta pranojë seancën në atë gjendje në të cilën është ndodhur ajo në momentin kur ka hyrë në të.

Tërheqja e padisë

Neni 193

Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit para se i padituri hyn në shqyrtim rreth çështjes kryesore.

Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e seancës kryesore, në qoftë se i padituri e pranon këtë. Po që se i padituri brenda 15 ditësh nga data e njoftimit mbi tërheqjen e padisë nuk deklarohet për katë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqje.

Padia e tërhequr konsiderohet sikur të mos jetë paraqitur fare dhe mund të paraqitet përsëri.

Paditësi mund të heqë dorë nga kërkesë-padia deri në përfundimin e seancës kryesore dhe në këtë rast padia konsiderohet e tërhequr.

Për heqjen dorë nga kërkesë-padia nuk nevojitet pëlqimi i të paditurit.

Paditësi që ka hequr dorë nga kërkesë-padia nuk mund të paraqesë padinë në të njëjtën çështje.

Ndaj heqjes dorë prej kërkesë-padisë gjykata kujdeset kryesisht gjatë krejt procedurës.

Qënia e kontestimit

Neni 194

Kontestimi fillon të rrjedhë duke ia dorëzuar padinë të paditurit.

Në pikëpamje të kërkesës që ka paraqitur pala gjatë procedurës, kontestimi fillon të rrjedhë që nga momenti kur për këtë kërkesë të jetë njoftuar pala kundërshtarë.

Gjersa kontestimi vazhdon, lidhur me të njëjtën kërkesë nuk mund të fillojë kontestimi i ri midis palëve të njëjta, e në qoftë se kontestimi i tillë ka filluar, gjykata do ia hedhë poshtë padinë.

Gjykata do të kujdeset kryesisht gjatë gjithë procedurës nëse vazhdon kontestimi tjetër mbi të njëjtën kërkesë midis palëve të njëjta.

Neni 195

Në qoftë se ndonjë nga palët e jetëson sendin apo të drejtën mbi të cilin rrjedhë kontestimi, kjo nuk pengon që kontestimi midis palëve të njëjta të përfundohej.

Personi që e ka marrë sendin ose të drejtën rreth të cilit rrjedhë kontestimi mund të hyjë në kontestim në vend të paditësit, respektivisht të paditurit, vetëm në qoftë se për këtë gjë e japin pëlqimin të dy palët.

Kreu i pesëmbëdhjetë

BASHKËNDËRGJYQËSAT

Neni 196

Disa persona me një padi mund të padisin, respektivisht mund të jenë të paditur (bashkëndërgjyqës):

1) në qoftë se në pikëpamje të objektit të kontestit në bashkësinë juridike apo në qoftë se të drejtat, respektivisht detyrimet e tyre rezultojnë nga e njëjta bazë faktike dhe juridike;

2) në qoftë se objekti i kontestit janë kërkesat, respektivisht detyrimet e njëjllotja që mbështeten në bazën esenciale të njëjllot faktike dhe juridike, e në qoftë se ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e së njëjtës gjykate për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur;

3) në qoftë se kjo është caktuar me ndonjë ligj tjetër.

Deri në përfundimin e seancës kryesore, nën kondita nga paragrafi 1 i këtij neni, paditësit mund t'i bashkohet paditësi i ri, ose padia mund të zgjerohet në një të paditur të ri me pëlqimin e tij.

Personi që aderon në padi, respektivisht në të cilin zgjerohet padia, duhet ta pranojë kontestimin në atë gjendje në të cilën ndodhej kur ai ka hyrë në të.

Neni 197

Paditësi me padinë mund të përfshijë dy ose më tepër të paditur dhe në këtë mënyrë të kërkojë që kërkesë-padia të aprovohet sipas të paditurit pasues për rastin po që se refuzohet në formë të prerë sipas atij që është theksuar në padinë para tij.

Në mënyrën që parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni paditësi mund të përfshijë në padinë dy ose më tepër të paditur vetëm në qoftë se ndaj secilit prej tyre thekson të njëjtën kërkesë ose në qoftë se ndaj disave prej tyre thekson kërkesa të ndryshme që lidhen midis tyre, si dhe po që se e njëjta gjykate është me kompetencë lëndore dhe territoriale për secilën kërkesë.

Neni 198

Personi që terësisht ose pjesërisht kërkon sendin apo të drejtën rreth të cilit midis personave të tjerë është në vazhdim kontestimi, para gjykatës para së cilës vazhdon ky kontestim mund t'i padisë të dy palët me një padi, gjersa procedura të mos përfundojë në formë të prerë.

Neni 199

Debitori kryesor dhe dorëzanësi mund të paditen bashkërisht, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës mbi dorëzaninë.

Neni 200

Secili bashkëndërgjyqës në kontestim është palë më vete dhe veprimet ose ometimet e tij nuk u shërbejnë dhe as që shkojnë në dëm të bashkëndërgjyqësve të tjerë.

Neni 201

Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të karakterit të marrëdhënies juridike kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësat unikë), konsiderohen si një palë kontestimore, kështu që në rastin kur bashkëndërgjyqësat e veçantë ometojnë ndonjë veprim kontestimor efekti i veprimeve kontestimore që kanë kryer bashkëndërgjyqësat e tjerë shtrihet edhe në ata që i kanë kryer bashkëndërgjyqësat e tjerë dhe në ata të cilët këto veprime nuk i kanë ndërmarrë.

Neni 202

Në qoftë se afatet për ekzekutimin e veprimit të caktuar kontestimor për bashkëndërgjyqësat unikë të veçantë skadojnë në kohë të ndryshme, këtë veprim kontestimor secili ndërgjyqës mund ta ndërmarrë gjithnjë derisa edhe për njërin prej tyre rrjedhë afati për ndërmarrjen e këtij veprimi.

Neni 203

Secili ndërgjyqës ka të drejtë të parashtrojë propozime që i përkasin procesit të kontestimit.

Kren i gjastëmbëdhjetë

PJESËMARRJA E PERSONAVE TË TRETË NË KONTESTIM

Pjesëmarrja e avokatit shoqëror të vetëqeverisjes

Neni 204

Kur avokati shoqëror i vetëqeverisjes në bazë të autorizimit ligjor merr pjesë në kontestim që rrjedhë midis personave të tjerë, është i autorizuar që, brenda kufive të kërkesë-padinë, të propozojë që të vërtetohen edhe faktet të cilat palët nuk i kanë theksuar dhe të paraqiten provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, si dhe të deklarojnë mjete juridike.

Pjesëmarrjen e vet në procedurë avokati shoqëror i vetëqeverisjes ia deklaron gjykatës me parashtresë, para së cilës zhvillohet kontestimi midis personave të tjerë.

Në qoftë se konsideron se ekzistojnë kushtet ligjore për pjesëmarrjen e avokatit shoqëror të vetëqeverisjes në kontestim dhe se pjesëmarrja e tij është e nevojshme, gjykata do ta njoftojë për këtë gjë avokatin shoqëror kompetent të vetëqeverisjes dhe do t'ia caktojë afatin në të cilin mund të deklarojë pjesëmarrjen e vet. Gjersa ky afat të mos kalojë, gjykata do ta pezullojë procedurën, por avokati shoqëror i vetëqeverisjes edhe pas kalimit të këtij afati mund ta shfrytëzojë të drejtën e vet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjykata do ta thërras avokatin shoqëror të vetëqeverisjes, që merr pjesë në kontestim, në të gjitha seancat dhe do t'i dërgojë të gjitha vendimet, kundër të cilave lejohet mjeti juridik.

Pjesëmarrja e prokurorit publik

Neni 205

Në qoftë se ekziston dyshimi se një apo dy palë shfrytëzojnë të drejtat e veta në procedurë për të bërë të pamundur aplikimin e dispozitave imperative mbi drejtimin dhe disponimin e mjeteve shoqërore, apo për të evituar detyrime financiare ndaj bashkësisë, ose për të bërë të pamundur aplikimin e dispozitave imperative të traktatit ndërkombëtar, prokurori publik kompetent ka të drejtë të marrë pjesë në kontestim të tillë që vazhdon midis personave të tjerë.

Në pikëpamje të pjesëmarrjes së prokurorit publik në kontestim, që vazhdon midis personave të tjerë, në vështrim të dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni, përshatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e neni 204 të këtij ligji.

Pjesëmarrja e ndërhyrësit

Neni 206

Personi që ka interes juridik që në kontestim, i cili vazhdon midis personave të tjerë, njera nga palët të ketë sukses mund t'i bashkohet kësaj palë.

Ndërhyrësi mund të hyjë në kontestim gjatë gjithë procedurës gjithnjë gjersa vendimi mbi kërkesë-padinë të ketë marrë formën e prerë, si dhe gjatë procedurës së vazhduar me paraqitjen e mjetit juridik të jashtëzakonshëm.

Deklaratën mbi aderimin në kontestim ndërhyrësi mund ta japë në seancë ose me parashtresë në formë të shkruar.

Parashtresa e ndërhyrësit u dërgohet të dy palëve ndërgjyqës, e në qoftë se deklarata e ndërhyrësit është dhënë në seancë, kopja e pjesës respektive të procesverbalit do t'i dërgohet vetëm asaj palë që ka mundur në seancë.

Neni 207

Secila palë mund t'ia kontestojë ndërhyrësit të drejtën për të marrë pjesë në procedurë dhe të propozojë që ndërhyrësi të refuzohet, kurse gjykata mundet, edhe pa deklarimin e palëve, ta refuzojë pjesëmarrjen e ndërhyrësit, po qe se vërtetohet se nuk ekziston interesi juridik i ndërhyrësit.

Derisa aktvendimi, me të cilin është refuzuar pjesëmarrja e ndërhyrësit të ketë marrë formën e prerë, ndërhyrësi mund të marrë pjesë në procedurë dhe veprimet e tij kontestimore nuk mund të përjashtohen.

Kundër vendimit të gjykatës me të cilin aprovohet pjesëmarrja e ndërhyrësit nuk lejohet ankim i veçantë.

Neni 208

Ndërhyrësi duhet ta pranojë kontestimin në atë gjendje në të cilën ndodhë në momentin kur ka ndërhyrë në kontestim. Në procesin e mëtejshëm të kontestimit ai është i autorizuar të parashtrojë propozime dhe të ndërmarrë të gjitha veprime të tjera kontestimore brenda afateve në të cilat këto veprime do të mund t'i ndërmirte pala të cilës i është bashkuar.

Në qoftë se ndërhyrësi ka hyrë në kontestim pasi vendimi mbi kërkesë-padinë të ketë marrë formën e prerë, është i autorizuar të paraqes edhe mjetin e jashtëzakonshëm juridik.

Në qoftë se ndërhyrësi paraqet mjetin juridik, kopja e parashtresës së tij do t'i dërgohet edhe palës të cilës i është bashkuar.

Veprimet kontestimore të ndërhyrësit kanë për palën, të cilës i është bashkuar efekti juridik, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me veprimet e saj.

Me aprovimin e të dy palëve kontestimore ndërhyrësi mund të hyjë në kontestim, si palë në vend të palës të cilës i është bashkuar.

Neni 209

Në qoftë se efekti juridik i aktgjykimit duhet të ketë bërë edhe me ndërhyrësin, ai ka pozitën e bashkëndërgjyqësit unik (neni 201).

Ndërhyrësi me pozitën e bashkëndërgjyqësit unik mund të paraqesë mjet juridik të jashtëzakonshëm edhe në kontestim në të cilin deri kur vendimi mbi kërkesë-padinë të ketë marrë formën e prerë, nuk ka marrë pjesë si ndërhyrës.

Emërimi i parapraktit

Neni 210

Personi që është paditur si posedues i ndonjë sendi ose si shfrytëzues i ndonjë të drejte, e që pohon se sendin e mban ose të drejtën e ushtron në emër të personit të tretë, mundet jo më vonë se deri në seancën pregatitore e në qoftë se kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën kryesore, para se të hyjë në shqyrtim rreth çështjes kryesore, ta ftojë me anë të gjykatës

këtë person të tretë (paraprakun) që në vend të tij të hyjë si palë në kontestim.

Përligimi i paditësit që në vend të paditurit në kontestim të hyjë parapraku nevojitet vetëm në qoftë se paditësi kundër të paditurit thekson edhe kërkesa të atilla që nuk varen nëse i padituri mban ose jo në emër të paraprakut sendin ose ushtron të drejtën.

Po qe se parapraku, i ftuar rregullisht, nuk vjen në seancë, apo refuzon të hyjë në kontestim, i padituri nuk mund të kundërshtojë që të hyjë në kontestim.

Njoftimi i personit të tretë mbi kontestimin

Neni 211

Në qoftë se paditësi ose i padituri duhet ta njoftojnë ndonjë person të tretë mbi kontestimin e filluar, kështu që në këtë mënyrë të themelohet ndonjë veprim civilo-juridik, ata munden, për derisa kontestimi të mos përfundojë në mënyrë të plotëfuqishme, të bëjnë këtë me parashitësë me anë të gjykatës kontestimore, ku do të theksojnë arsyen e njoftimit dhe në cilën gjendje ndodhet kontestimi.

Pala që e ka njoftuar personin e tretë mbi kontestimin nuk mund të kërkojë për këtë arsye ndërprerjen e kontestimit të filluar, zgjatjen e afateve ose shtytjen e seancës.

Kreu i shtatëmbëdhjetë

NDËRPRERJA DHE PUSHIMI I PROCEDURËS

Neni 212

Procedura ndërpritet:

- 1) kur pala vdes ose e humb zotësinë kontestimore, kurse nuk ka autorizues në këtë kontestim;
- 2) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdes ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, kurse pala nuk ka autorizues në këtë kontestim;
- 3) kur pala, që është person juridik, pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent vendos në formë të prerë mbi ndalimin e punës;
- 4) kur linden pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit;
- 5) kur për shkak të luftës ose për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë;
- 6) kur kjo është caktuar me ndonjë ligj tjetër.

Neni 213

Përveç rasteve të parashikuara posaçërisht me këtë ligj, ndërprerjen e procedurës gjykata do të caktojë:

- 1) në qoftë se ka vendosur që vetë të mos vendos mbi çështjen paraprake (neni 12);
- 2) në qoftë se pala ndodhet në zonën e cila, për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (vërshimet etj.), është shpërndarë nga gjykata.

Gjykata mund të caktojë ndërprerjen e procedurës në qoftë se vendimi mbi kërkesë-padinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo nëse është kryer vepra penale që ndiqet kryesisht, kush është kryerësi dhe nëse ai është përgjegjës, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose eksperti ka dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si provë është i rremë.

Neni 214

Ndërprerja e procedurës ka si pasojë që të pushojnë të rrjedhin të gjitha proceset e caktuara për ushtrimin e veprimeve gjyqësore.

Gjatë kohës të ndërprerjes së procedurës gjykata nuk mund të udhërrë asnjë veprim në procedurë, por në qoftë se ndërprerja ka lindur pas përfundimit të seancës kryesore, gjykata mund të marrë vendim, në bazë të këtij shqyrtimi.

Vendimet gjyqësore të ndërmara nga njëra palë gjatë zgjat ndërprerjes e procedurës nuk kanë efekt.

palës tjetër asnjë efekt juridik. Efekti i tyre fillon vetëm pasi procedura të vazhdojë.

Neni 215

Procedura që është ndërprerë për shkaqe të theksuara në nenin 212 pikat 1 deri 4 të këtij ligji do të vazhdojë kur trashëgimtari ose kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, drejtuesi i falimentos ose pasuesit juridikë të personit juridik ndërmarrin procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Në qoftë se gjykata e ka ndërprerë procedurën për shkaqe të theksuara në nenin 213 paragrafi 1 pika 1 dhe paragrafi 2 të këtij ligji, procedura do të vazhdojë pasi të ketë përfunduar në formë të prerë procedura para gjykatës ose organit tjetër kompetent, apo kur gjykata konstaton se nuk ekzistojnë më shkaqet për ta pritur përfundimin e saj.

Në të gjitha rastet e tjera procedura e ndërprerë do të vazhdojë me propozimin e palës posa të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes.

Afatet të cilat, për shkak të ndërprerjes së procedurës, kanë pushuar të rrjedhin, fillojnë për palën e interesuar të rrjedhin teresisht përsëri prej ditës kur gjykata t'ia dërgojë aktvendimin mbi vazhdimin e procedurës.

Palës që nuk e ka paraqitur propozimin për vazhdimin e procedurës aktvendimi mbi vazhdimin e procedurës i dërgohet sipas dispozitave të nenit 142 të këtij ligji.

Neni 216

Pushimi i procedurës lind kur të dy palët, para përfundimit të seancës kryesore, të merren vesh për këtë apo kur të dy palët mungojnë në seancën pregaditore ose në seancën për në seancën kryesore, respektivisht kur palët e pranishme në seancë nuk dojnë të shqyrtojnë, si dhe kur njëra palë, që është thirrur rregullisht, mungon ndërsa tjetra propozon pushimin, apo kur në seancë vjen vetëm paditësi e nuk propozon nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Kur palët të jenë marrë vesh që procedura të pushojë, ky pushim fillon që nga dita kur palët ta njoftojnë gjykatën për këtë gjë.

Pushimi i procedurës nuk do të fillojë në qoftë se të dy palët mungojnë nga seanca për paraqitjen e provave para kryetarit të kolegjit ose gjyqtarit të lutur. Në këtë rast, në qoftë se palët janë thirrur rregullisht, seanca do të mbahet.

Neni 217

Në rast pushimi të procedurës, linden të njehta pasoja juridike sikurse të ndërprerjes e procedurës, por afatet e caktuara me ligj nuk pushojnë të rrjedhin.

Procedura pushon gjersa njera palë të mos propozojë që procedura të vazhdojë. Propozimi i tillë nuk mund të paraqitet para se të kenë kaluar tre muaj nga dita kur të ketë lindur pushimi i procedurës.

Në qoftë se asnjëra palë në afatin prej gjashtë muajsh nga dita kur të ketë lindur pushimi i procedurës nuk e paraqet propozimin për vazhdimin e procedurës, konsiderohet se padia është tërhequr.

Në aktvendimin, në të cilin përcaktohet pushimi i procedurës, do të theksohet se prej cilës ditë pushon procedura dhe palët do të paralajmërohen për pasojat juridike të parashikuara në paragrafet 1 deri 3 të këtij neni.

Neni 218

Ankimi kundër aktvendimit, me të cilin përcaktohet (neni 212) ose caktohet (neni 213) ndërprerja e procedurës si dhe kundër aktvendimit, me të cilin përcaktohet pushimi i procedurës (neni 216) nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Në qoftë se gjykata e ka refuzuar në seancë propozimin për ndërprerjen e procedurës dhe ka vendosur që procedura të vazhdojë menjëherë, kundër kësaj aktvendimi nuk lejohet ankimi i veçantë.

Kreu i tetëmbdhjetë

PROVAT DHE PARAQITJA E PROVAVE

Dispozita të përgjithshme

Neni 219

Secila palë ka për detyrë të paraqes fakte dhe të propozojë prova, në të cilat e bazon kërkesën e vet, apo me të cilat i kundërshton thëniet dhe provat e kundërshtarit.

Neni 220

Të provuarit përfshin të gjitha faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit.

Cilat prova do të paraqiten për të vërtetuar faktet vendimtare kjo vendoset nga gjykata.

Neni 221

Nuk duhen provuar faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë kontestimit, por gjykata mund të urdhërojë që të provohen edhe fakte të këtualla në qoftë se konsideron se pala me pohimin e tyre dëshiron të disponojë kërkesën që nuk mund të disponohet (neni 3 paragrafi 3).

Gjykata, duke marrë në konsiderim të gjitha rrethanat, do të çmojë me bindje të vet, nëse do ta marrë si të pohuar apo si të kontestuar faktin të cilin pala më parë e ka pohuar, e pastaj krejtësisht apo pjesërisht e ka mohuar apo e ka kufizuar pohimin, duke shtuar fakte të tjera.

Faktet, qenien e të cilave ligji i prezumon, nuk duhen provuar, por mund të provohet se këto fakte nuk ekzistojnë, në qoftë se me ligj nuk është caktuar dishka tjetër.

Nuk duhen provuar faktet e njohura për të gjithë.

Neni 222

Në qoftë se gjykata nuk është në dijeni për të drejtën që është në fuqi në shtetin e huaj, do të kërkojë njoftim nga organi federativ i administratës me kompetencë për punët e judikaturës.

Gjykata mund të kërkojë edhe nga pala të paraqes dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent i huaj, me të cilin vërtetohet ndonjë e drejtë që është në fuqi në shtetin e huaj.

Neni 223

Në qoftë se vërtetohet se palës i takon e drejta e shpërbërimit të dëmit, e shumës së parave apo e sendit të zëvendësueshëm, por shuma, respektivisht sasia e sendeve nuk mund të përcaktohen, ose do të mund të përcaktohen vetëm me vështirësi të papërpjestueshme, gjykata për këtë gjë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.

Neni 224

Provat në seancën kryesore paraqiten para kolegjit, por kolegji mundet, për shkaqe të rëndësishme, të vendos që provat e veçanta të paraqiten para kryetarit të kolegjit ose gjyqtarit të gjykatës së lutur (gjyqtari i lutur). Në këtë rast procesverbalet mbi provat e paraqitura do të lexohen në seancën kryesore.

Kur kolegji vendos që ndonjë provë të paraqitet para gjyqtarit të lutur, në letërporosinë për paraqitjen e provave do të përshkruhet gjendja e sendeve sipas procesit të seancës kryesore dhe veçanërisht do të theksohet për cilat rrethana duhet të kihet sidomos parasysh në rastin e paraqitjes së provave.

Mbi seancën për paraqitjen e provave para kryetarit të kolegjit ose para gjyqtarit të lutur do të njoftohen edhe palët, në qoftë se nuk kanë deklaruar se nuk do të asistojnë në seancë.

Kryetari i kolegjit ose gjyqtari i lutur ka gjatë paraqitjes së provave të gjitha autorizimet të cilat i ka kolegji, respektivisht kryetari i kolegjit kur provat paraqiten në seancën kryesore.

Kundër aktivendimit të gjykatës me të cilin paraqitja e provave i është besuar kryetarit të kolegjit ose gjyqtarit të lutur nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 225

Kryetari i kolegjit ose gjyqtari i lutur, të cilit i është besuar paraqitja e ndonjë prove, është i autorizuar të paraqes edhe prova të tjera, po që se e quan se kjo është e përshtatshme.

Neni 226

Në qoftë se sipas rrethanave mund të supozohet se ndonjë provë nuk do të mund të paraqitet, apo se nuk do të mund të paraqitet në afatin plotësues, ose në qoftë se prova duhet të paraqitet në botën e jashtme, gjykata në aktivendimin mbi paraqitjen e provave do të caktojë afatin deri në të cilin do të pritët për paraqitjen e provave.

Kur të ketë kaluar alati i caktuar, shqyrtimi do të zbatohet pavarësisht se prova e caktuar nuk është zbatuar.

Këqyrja në vend

Neni 227

Këqyrja në vend ndërmirret kur për përcaktimin e ndonjë fakti ose për sqarimin e ndonjë rrethane nevojitet vrojtimi direkt i gjykatës.

Këqyrja në vend mund të bëhet edhe me pjesë-marrjen e ekspertit.

Neni 228

Kolegji do ta autorizojë kryetarin e kolegjit për të bërë këqyrjen në vend, në qoftë se sendi i cili duhet të shikohet nuk mund të sjelljet në gjykatë, apo në qoftë se sjellja e tij do të shkaktojte shpenzime të rëndësishme, kurse kolegji konsideron se nuk është e domosdoshme që sendi të shikohet direkt nga të gjithë anëtarët e kolegjit.

Neni 229

Në qoftë se duhet të shikohet sendi që ndodhet pranë ndonjerës nga palët, pranë personit të tretë, pranë organit shtetëror, ose pranë organizatës apo bashkësisë vetëqeverisëse, të cilës i është basuar ushtrimi i autorizimit publik, do të vihen përshtatshëmrisht në zbatim dispozitat e këtij ligji mbi pajisjen me dokumenta nga këto organe apo organizata (nenet 232 deri 234).

Dokumentet

Neni 230

Dokumenti të cilin e ka lëshuar në formën e parashikuar organi shtetëror brenda kufive të kompetencës së vet, si dhe dokumenti të cilin në formë të tillë e ka lëshuar organizata apo bashkësia vetëqeverisëse në ushtrimin e autorizimit publik, që i është basuar me ligj ose me vendim të kuvendit të komunës, të bazuar në ligj (dokumenti zyrtar), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.

Të njejtën fuqi provuese kanë edhe dokumentet e tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese, janë barazuar me dokumentet zyrtare.

Lejohet që të provohet se në dokumentin zyrtar faktet janë vërtetuar në mënyrë jo të saktë apo se dokumenti është hartuar në mënyrë jo të drejtë.

Në qoftë se gjykata dyshon në autenticitetin e dokumentit, mund të kërkojë që për këtë të deklarohet organi nga i cili ai duhet të vijë.

Neni 231

Në qoftë se me traktat ndërkombëtar nuk është caktuar dishka tjetër, dokumentet e huaja zyrtare të vërtetuara në formë të rregullt, kanë, me konditë reciprociteti, të njejtën fuqi provuese sikurse dokumentet zyrtare të vendit.

Neni 232

Pala ka për detyrë që vetë ta paraqes dokumentin, në cilin i referohet për të provuar theniet e veta.

Së bashku me dokumentin e përpiluar në gjuhë të huaj paraqitet edhe përkthimi i legalizuar.

Në qoftë se dokumenti ndodhet pranë organit shtetëror ose personit shoqëror juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimit publik, kurse pala vetë nuk mund të bëjë që dokumenti të dorëzohet apo të regohet, gjykata do ta marrë kryesisht këtë dokument.

Neni 233

Kur njera palë i referohet dokumentit dhe pohon se ai ndodhet pranë palës tjetër, gjykata do ta ftojë këtë palë që ta paraqes dokumentin, duke ia lënë për këtë afat të caktuar.

Pala nuk mund të refuzojë paraqitjen e dokumentit, në qoftë se ajo vetë i është referuar dokumentit si provë e thëniesve të veta, apo në qoftë se është fjala për dokumentin, të cilin sipas ligjit ka për detyrë ta dorëzojë ose ta tregojë apo, në qoftë se dokumenti, duke marrë parasysh përmbajtjen e tij, konsiderohet si i përbashkët për të dy palët.

Pikëpamje të të drejtave të palës për të refuzuar paraqitjen e dokumenteve të tjerë, do të vihen përshatshmërisht në zbatim dispozitat e neneve 237 dhe 238 të këtij ligji.

Kur pala që është thirrur për të paraqitur provën mohon se dokumenti ndodhet pranë saj, gjykata mundet, për vertetimin e këtij fakti, të paraqes prova.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, do të çmojë, sipas bindjes së vet, rëndësinë e faktit se pala që e mban dokumentin nuk dëshiron të veprojë sipas aktvendimit të gjykatës, me të cilin urdhërohet që ta paraqes dokumentin, apo në kundërshtim me bindjen e gjykatës mohon se dokumenti ndodhet pranë saj.

Kundër vendimit të gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 234

Personit të tretë gjykata mund t'i urdhërojë ta paraqes dokumentin vetëm kur ai sipas ligjit e ka për detyrë ta tregojë ose ta paraqes, ose kur është fjala për dokumentin që, sipas përmbajtjes së vet, është e përbashkët për këtë person dhe për palën që i referohet këtij dokumenti.

Para se të ketë marrë vendim, me të cilin personit të tretë i urdhëron paraqitjen e dokumentit, gjykata do ta ftojë personin e tretë që të deklarohet për këtë gjë.

Kur personi i tretë e mohon detyrën e vet për të paraqitur dokumentin që ndodhet pranë tij, gjykata kontestimore do të vendos nëse personi i tretë e ka për detyrë ta paraqes dokumentin.

Kur personi i tretë mohon se dokumenti ndodhet pranë tij, gjykata mundet, për të vërtetuar këtë fakt, të paraqes prova.

Aktvendimi i formës së prerë mbi detyrën e personit të tretë për ta paraqitur dokumentin mund të ekzekutohet sipas rregullave të procedurës së ekzekutimit.

Personi i tretë ka të drejtë kompensimi të shpenzimeve që ka pasur lidhur me paraqitjen e dokumenteve. Dispozitat e neni 249 të këtij ligji përshatshmërisht do të vihen në zbatim edhe në këtë rast.

Dëshmitarët

Neni 235

Secili person që thirret si dëshmitar ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes, e në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, ka për detyrë edhe të çmojë.

Si dëshmitar mund të dëgjohen vetëm personat që janë të aftë për të dhënë njoftime me besim et që arrihen.

Neni 236

Nuk mund të dëgjohet si dëshmitar personi i cili me thënien e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së sekretit zyrtar apo ushtarak, gjersa organi kompetent të mos e lirojë nga kjo detyrë.

Neni 237

Dëshmitari mund të refuzojë të dëshmojë:

1) mbi ate që ia ka basuar pala si autorizuesit të vet;

2) mbi ate që pala ose personi tjetër ia ka treguar dëshmitarit si rrëfyesit fetar;

3) mbi faktet që i ka mësuar dëshmitari si avokat, mjek ose në ushtrimin e ndonjë profesioni tjetër, apo të ndonjë veprimtarie tjetër, në qoftë se ekziston obligimi që të ruhet si sekret ajo që mëson gjatë ushtrimit të profesionit apo të veprimtarisë së vet.

Kryetari i kolegjit do t'i paralajmërojë këta persona se mund të refuzojnë dhënien e deklaratave.

Neni 238

Dëshmitari mund të refuzojë përgjigjen në disa pyetje, në qoftë se për këtë ekzistojnë shkaqe të rëndësishme, e sidomos në qoftë se me përgjigjen e vet në këto pyetje do të marroset rëndë, do të pësonte dëm të madh pasuror, ose do të ndiqeshin penalisht ai apo të afërmit e tij në vijë të drejtë, deri në cilëndo shkallë, e në vijë anësore deri në shkallë të tretë përfundimisht, për bashkëshortin e vet ose të afërmit të krushqisë deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe atëherë kur ka pushuar martesën, si dhe kujdestari apo i kujdestuari, adaptuesi apo i adaptuari.

Kryetari i kolegjit do ta paralajmërojë dëshmitarin se mund të refuzojë dhënien e përgjigjes në pyetjen e bërë.

Neni 239

Dëshmitari nuk mundet, për shkak të rrezikut nga ndonjë dëm pasuror, ta refuzojë dëshminë mbi veprimet juridike, në të cilat ka qenë i pranishëm si dëshmitar i ftuar, mbi veprimet në pikëpamje të raportit kontestues që ka ndërmarr si parapraku juridik ose si përfaqësues i një pale, mbi faktet që kanë të bëjnë me marrëdhënien pasurore të kushtëzuara nga lidhjet familjare apo martesore, mbi faktet që kanë të bëjnë me lindjen, lidhjen e martesës ose me vdekjen, si dhe kur, në bazë të dispozitave të veçanta, ka për detyrë të bëjë kallëzimin ose të japë deklaratën.

Neni 240

Bazueshmërinë e shkaqeve për refuzimin e dëshmisë apo të përgjigjes në pyetje të veçanta i çmon gjykata, para së cilës dëshmitari duhet të dëshmojë. Po qe se ka nevojë, për këtë gjë më parë do të dëgjohet pala.

Kundër aktvendimit të gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni palët nuk kanë të drejtë ankimi të veçantë, kurse dëshmitari këtë aktvendim mund ta kundërshtojë në ankim kundër aktvendimit mbi dënimin me gjobë ose me burg për shkak se ka refuzuar të dëshmojë ose të japë përgjigje në pyetje të veçanta (neni 248 paragrafi 2).

Neni 241

Pala që propozon që personi i caktuar të dëgjohet si dëshmitar duhet më parë të theksojë se për cilën gjë ai duhet të dëshmojë dhe të tregojë emrin e mbiemrin, profesionin dhe vendqëndrimin e tij.

Neni 242

Thirrja e dëshmitarit bëhet duke i dërguar fletë-thirrjen, ku theksohet emri dhe mbiemri, si dhe profesioni i të ftuarit, koha dhe vendi i ardhjes, objekti rreth të cilit thirret dhe shënimi se thirret si dëshmitar. Në fletëthirrje dëshmitari do të paralajmërohet

për pasojat e mungesës së pajustificuar (neni 243) dhe për të drejtën e kompensimit të shpenzimeve (neni 249).

Dëshmitarët, të cilët për shkak të moshës, sëmundjes, ose të të metave të mëdha trupore nuk mund t'iu përgjigjen thirrjes, do të dëgjohen në banesën e tyre.

Neni 243

Dëshmitarët dëgjohen veç e veç dhe pa praninë e dëshmitarëve do të dëgjohen më vonë. Dëshmitari ka për detyrë që përgjigjet t'i japë verbalisht.

Dëshmitari më parë do të paralajmërohet se e ka për detyrë të flas të vërtetën dhe se asgjë nuk guxon ta lejë në heshtje, e pastaj do të paralajmërohet për pasojat e dhënies së deklaratës së rreme.

Pastaj dëshmitari do të pyetet si e ka emrin dhe mbiemrin, emrin e atit, për profesionin, vendqëndrimin, vendlindjen, moshën dhe mbi marrëdhënien e tij me palën.

Neni 244

Pas pyetjeve të përgjithshme dëshmitari thirret që të parashtojë çdo gjë e ka të njohur mbi faktet rreth të cilave duhet të dëshmojë, e pastaj mund t'i bëhet pyetje për verifikim, plotësim ose sqarim. Nuk lejohet të bëhen pyetjet, në të cilat është përmbajtur mënyra e dhënies së përgjigjes.

Dëshmitari gjithmonë do të pyetet si e ka të njohur ate mbi të cilën gjë dëshmon.

Dëshmitarët mund të ballafaqohen, në qoftë se theniet e tyre nuk pajtohen në pikëpamje të fakteve të rëndësishme. Të ballafaquarit do të dëgjohen për çdo rrethanë veç e veç në të cilën nuk pajtohen dhe përgjigja e tyre do të përfshihet në procesverbal.

Neni 245

Dëshmitari që nuk e zotëron gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, do të dëgjohet nëpërmjet interpretit. Në qoftë se dëshmitari është shurdh, pyetjet do t'i bëhen me shkrim, e në qoftë se është memec, do të ftohet që përgjigjet t'i japë me shkrim. Po qe se dëgjimi nuk mund të bëhet në këtë mënyrë, do të ftohet si interpret personi që mund të mirret vesh me dëshmitarin.

Gjykata do ta paralajmërojë interpretin për detyrën e transmetimit të saktë të pyetjeve që i bëhen dëshmitarit dhe të deklaratave që do t'i japë dëshmitari.

Neni 246

Gjykata mund të vendos që dëshmitari të bëjë betimin për thënien e bërë.

Betimi bëhet me gojë, duke shqiptuar këto fjalë: »Betohe me nderim tim se për çdo gjë që më ka pyetur gjykata kam folur të vërtetën dhe se asgjë që kam ditur për këtë çështje nuk e kam lënë në heshtje.«

Gjykata mund të vendos që dëshmitari të bëjë betimin edhe para se të dëgjohet.

Dëshmitarët memec, që dinë shkrim e këndim betimin e japin duke nënshkruar tekstin e betimit, kurse dëshmitarët e shurdhë do të bëjnë leximin e tekstit të betimit. Në qoftë se dëshmitarët e shurdhë apo memec nuk dinë as shkrim e as këndim, do të betohen me anë të interpretit.

Në qoftë se ndonjë dëshmitar dëgjohet përsëri, nuk do të japë për së dyti betimin, por vetëm do të paralajmërohet për betimin që e ka dhënë.

Neni 247

Nuk do të bëjnë betimin dëshmitarët të cilët në momentin e betimit nuk janë madhorë apo nuk mund të kuptojnë rëndësinë e betimit.

Kundër vendimit të gjykatës, me të cilin dëshmitarit i urdhërohet të bëjë betimin ose i caktohet të mos e bëjë betimin palët dhe dëshmitari nuk kanë të drejtë ankimi.

Neni 248

Në qoftë se dëshmitari, që është ftuar rregullisht nuk vjen, kurse mungesën nuk e justifikon, apo pa leje ose pa shkak të arsyeshëm largohet nga vendi ku duhet të dëgjohet, gjykata mund të urdhërojë që të sjellet me detyrim dhe t'i përballojë shpenzimet e sjelljes, e mund ta dënojë edhe me gjobë deri në 1.000 dinarë.

Në qoftë se dëshmitari vjen edhe pasi të jetë paralajmëruar për pasojat e dëshmisë apo të përgjigjes në pyetje të veçantë, kurse gjykata çmon së shkaqet e refuzimit janë të pajustificuara, mund ta dënojë me gjobë deri në 1.000 dinarë, e në qoftë se edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, mund ta burgos. Burgu zgjatë gjersa dëshmitari të mos pranojë të dëshmojë, apo gjersa dëshmia e tij të mos bëhet e panevojshme, por jo më tepër se një muaj.

Ankimi kundër aktvendimit mbi dënimin me gjobë, ose mbi burgimin, nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit, përveç në qoftë se në këtë ankim kundërshtohet edhe vendimi i gjykatës, me të cilin nuk janë aprovuar arsyet e dëshmitarit për refuzimin e dëshmisë apo të përgjigjeve në pyetje të veçanta.

Me kërkesën e palës, gjykata do të vendos që dëshmitari e ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet të cilat i ka shkaktuar me mungesën e vet të paarsyeshme, respektivisht me refuzimin e pajustificuar për të dëshmuar.

Në qoftë se dëshmitari e justifikon më vonë mungesën e vet, gjykata do ta revokojë aktvendimin e vet mbi dënimin, e mund ta lirojë dëshmitarin krejtësisht apo pjesërisht nga kompensimi i shpenzimeve. Gjykata mund ta revokojë aktvendimin e vet mbi dënimin edhe kur dëshmitari të ketë pranuar më vonë të dëshmojë.

Personat ushtarakë dhe punëtorët e milicisë nuk mund të burgosen, por për refuzimin e tyre që të dëshmojnë do të lajmërohet për ndëshkim komanda e tyre. Po qe se nevojitet që këta persona të sjellen me detyrim për të dëshmuar, gjykata do t'i drejtohet eprorit të tyre, i cili do të urdhërojë sjelljen e tyre në gjykatë.

Neni 249

Dëshmitari ka të drejtë kompensimi të shpenzimeve të udhëtimit dhe të shpenzimeve të ushqimit e të fjetjes, si dhe për kompensimin e fitimit të humbur.

Dëshmitari duhet ta kërkojë kompensimin menjëherë pasi të dëgjohet, përndryshe e humb të drejtën e kompensimit. Gjykata ka për detyrë ta paralajmërojë dëshmitarin për këtë gjë.

Në aktvendimin, me të cilin caktohen shpenzimet e dëshmitarit, gjykata do të caktojë që shuma e caktuar të paguhet prej paradhënies së deponuar, e në qoftë se paradhënia nuk është deponuar, do t'i urdhërojë palës që shumën e caktuar t'ia paguajë dëshmitarit brenda tetë ditësh. Ankimi kundër këtij aktvendimi nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Ekspertët

Neni 250

Gjykata do të paraqes provën me ekspertim kur për vërtetimin ose për sqarimin e ndonjë fakti nevojitet dituria profesionale që nuk e disponon gjykata.

Neni 251

Ekspertimi bëhet nga ekspertët që i cakton gjykata kontestimore.

Para se të caktojë se cilët persona do t'i marrë si ekspertë, gjykata për këtë gjë do të dëgjojë palët. Në rastet urgjente, gjykata mund të caktojë ekspertë megjithëse palët nuk janë dëgjuar më parë.

Gjykata kontestimore mund ta autorizojë kryetarin e kolegjit, ose gjyqtarin e lutur që këta të caktojnë ekspertët, në qoftë se këtyre u është besuar paraqitja e provave me ekspertim.

Në vend të ekspertit të caktuar gjykata gjithëmonë mund të caktojë ekspertin tjetër.

Neni 252

Ekspertimi, si rregull, bëhet prej një eksperti, e në qoftë se e çmon gjykata se ekspertimi është i ndërlikuar mund të caktojë dy apo më tepër ekspertë.

Ekspertët caktohen në radhë të parë prej ekspertëve të përhershëm të gjykatës për llojin e caktuar të ekspertimit.

Ekspertimi mund t'i besohet edhe institucionit profesional, (spitalit, laboratorit kimik, fakultetit etj.).

Në qoftë se ekzistojnë institucione të veçanta për lloje të caktuara të ekspertimit (ekspertimi i parave fallos, i dorëshkrimeve, ekspertimi daktiloskopik etj.), ekspertime të tilla, e sidomos të ndërlikura, do t'u besohen më radhë të parë këtyre institucioneve.

Neni 253

Ekspertët e caktuar kanë për detyrë t'i përgjigjen thirrjes së gjykatës dhe të paraqesin rezultatin dhe mendimin e vet.

Gjykata do ta lirojë ekspertin me kërkesën e tij, nga detyra e ekspertimit për shkakë për të cilat dëshmitari mund të refuzojë të dëshmojë ose të japë përgjigje në pyetje të veçantë.

Gjykata mund ta lirojë ekspertin, me kërkesën e tij, nga detyra e ekspertimit edhe për shkakë të tjera të justifikuar. Lirimi nga detyra e ekspertimit mund të kërkohej edhe nga punëtori i autorizuar i organit apo i organizatës ku punon eksperti.

Neni 254

Eksperti mund të përjashtohet për të njëjtat shkaqe për të cilat mund të përjashtohet gjyqtari apo ndihmësgjyqtari kurse si ekspert mund të merret edhe personi që është dëgjuar më parë si dëshmitar.

Pala ka për detyrë të paraqes kërkesën për përjashtimin e ekspertit, posa të ketë mësuar për shkakun e përjashtimit, e jo më vonë se para fillimit të paraqitjes së provave me ekspertin. Në qoftë se gjykata para caktimit të ekspertit e ka dëgjuar palët mbi personalitetin e ekspertit, pala ka për detyrë që me këtë rast të deklarohet mbi përjashtimin.

Në kërkesën për përjashtimin e ekspertit pala ka për detyrë të theksojë rrethanat në të cilat bazon kërkesën e vet për përjashtim.

Mbi kërkesën për përjashtim vendos gjykata kontestimore. Gjyqtari i gjykatës së lutur dhe kryetari i kolegjit vendos mbi përjashtimin, në qoftë se u është besuar paraqitja e provave me ekspertin.

Kundër aktvendimit, me të cilin aprovohet kërkesa për përjashtim, nuk lejohet ankimi, kurse kundër aktvendimit, me të cilin refuzohet kërkesa nuk lejohet ankimi i veçantë.

Në qoftë se pala ka mësuar për shkakun e përjashtimit pas ekspertimit të bërë dhe për kundërshtimin e ekspertimit nga ky shkak, gjykata do të veprojë sikur kërkesa për përjashtim të jetë bërë para ekspertimit të kryer.

Neni 255

Gjykata mund ta dënojë me gjobë deri në 1.000 dinarë ekspertin që nuk vjen në seancë, megjithëse është thirrur rregullisht, kurse mungesën e vet nuk e justifikon, si dhe ekspertin që ra ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të bëjë ekspertimin.

Aktivendimin mbi dënimin gjykata mund ta revoکوjë nën kushte të parashikuara në nenin 248 paragrafi 5 të këtij ligji.

Me kërkesën e palës, gjykata mund t'i urdhërojë me aktivendim ekspertit t'i kompensojë shpenzimet, që i ka shkaktuar nga mosardhja e pajustificuar, apo nga refuzimi i pajustificuar i tij për të bërë ekspertimin.

Neni 256

Eksperti ka të drejtë për kompensimin e shpenzimeve të ndërrimit dhe të shpenzimeve të udhëtarisë.

ë të tjetres, për kompensimin e fitimit të humbur, e të shpenzimeve të ekspertimit, si dhe të drejtë shpërblimi për ekspertimin e bërë.

Në pikëpamje të kompensimit të shpenzimeve dhe të shpërblimit të ekspertit përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e nenit 249 paragrafet 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 257

Ekspertët thirren duke u dërguar fletëthirrjen shkresore, ku theksohet emri e mbiemri, profesioni i të ftuarit, koha dhe vendi i ardhjes, objekti rreth të cilit thirret dhe shënimi se thirret si ekspert. Në fletëthirrje eksperti do të paralajmërohet për pasojat e mungesës së pajustificuar (neni 255) dhe për të drejtën e kompensimit të shpenzimeve (neni 256).

Neni 258

Para fillimit të ekspertimit do të thirret eksperti që ta studiojë me kujdes objektin e ekspertimit, të tregojë saktësisht çdo gjë që vën re dhe gjen, si dhe të paraqes mendimin e vet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në pajtim me rregullat e shkancës dhe të mjeshtrisë, e do të paralajmërohet edhe për pasojat e dhënies së deklaratës së rreme.

Eksperti do të pyetet pastaj si e ka emrin e mbiemrin, emrin e atit, për profesionin, vendqëndrimin, vendndienjen, moshën dhe për marrëdhënien e tij me palën.

Neni 259

Gjykata drejton ekspertimin, i tregon ekspertit objektin që do të shikohet, i bën pyetje dhe sipas nevojë, kërkon spjegime në pikëpamje të rezultatit e të mendimit të dhënë.

Ekspertit mund t'i jepen spjegime, kurse mund t'i lejohet edhe studimi i shkresave. Me kërkesën e ekspertit, mund të paraqiten edhe prova të reja për t'i vërtetuar rrethanat që kanë rëndësi për formimin e mendimit të ekspertit.

Neni 260

Gjykata do të caktojë nëse eksperti do ta paraqes rezultatin dhe mendimin e vet vetëm verbalisht në seancë ose do ta paraqes edhe me shkrim përpara seancës. Gjykata do ta caktojë afatin për paraqitjen me shkrim të rezultatit e të mendimit.

Eksperti duhet gjithmonë ta arsyetojë mendimin e vet.

Gjykata, mundësisht, do t'u dërgojë palëve rezultatin dhe mendimin me shkrim para seancës në të cilën do të shqyrtohen ato.

Neni 261

Në qoftë se janë caktuar disa ekspertë, këta mund të paraqesin rezultatin dhe mendimin e përbashkët kur pajtohen në rezultatin dhe mendimin. Në qoftë se në rezultatin dhe në mendimin nuk pajtohen, secili ekspert paraqet veças rezultatin dhe mendimin e vet.

Në qoftë se të dhënat e ekspertëve mbi rezultatin e tyre dallohen esencialisht, apo në qoftë se rezultati i një apo i disa ekspertëve është i paqartë, jo i plotë, apo kontraktitor me vetëvetë, ose me rrethanat e këqyrjes në vend, kurse këto të meta nuk mund të evitohen nga dëgjimi i përsëritur i ekspertëve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë.

Në qoftë se në mendimin e një apo të disa ekspertëve ka kontradikta apo të meta, ose shfaqet dyshimi i bazuar në rregullsinë e mendimit të dhënë, ndërsa këto të meta ose dyshimi nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve, do të kërkohej mendimi i ekspertëve të tjerë.

Neni 262

Kundër aktvendimit të gjykatës nga nenet 251, 252 dhe 253 të këtij ligji nuk lejohet ankimi.

Neni 263

Dispozitat e neneve 251, 252 paragrafi 2, të nenit 253 deri te neni 257, të nenit 258 paragrafi 2 dhe të nenit 262 të këtij ligji vihen përshtatshmërisht në zbatim edhe ndaj interpretëve.

Dëgjimi i palëve

Neni 264

Faktet kontestuese të rëndësishme për vendim, gjykata mund t'i vërtetojë edhe me dëgjimin e palëve.

Gjykata mund të vendos që të paraqitet prova me dëgjimin e palëve kur nuk ka prova të tjera, apo kur megjithë provat e tjera të paraqitura konstaton se kjo është e nevojshme për vërtetimin e fakteve të rëndësishme.

Neni 265

Në qoftë se është bëndur se palës, respektivisht personit që duhet të dëgjohet për palën nuk janë të njohura faktet kontestuese, apo në qoftë se dëgjimi i kësaj pale nuk është i mundur, gjykata mund të caktojë që të dëgjohet vetëm pala tjetër.

Po kështu, gjykata mund të vendos që të dëgjohet vetëm njëra palë, në qoftë se pala tjetër refuzon të japë deklaratë apo nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës.

Neni 266

Paraqitja e provave me dëgjimin e palëve me anë të kryetarit të kolegjit apo të gjyqtarit të lutur lejohet vetëm në qoftë se pala për shkak të pengesave të paevitueshme nuk mund të vijë personalisht, apo në qoftë se ardhja e saj do të shkaktonte shpenzime të papërpjestueshme.

Neni 267

Për palën që nuk e ka zotësinë kontestimore do të dëgjohet përfaqësuesi ligjor i saj. Gjykata mund të vendos që në vend të përfaqësuesit ligjor, apo përpos tij, të dëgjohet vetë pala, në qoftë se dëgjimi i saj është i mundur.

Për personin juridik do të dëgjohet personi që është caktuar me ligj ose me rregulla që ta përfaqësojë.

Në qoftë se si palë në kontest marrin pjesë në njerën anë disa persona, gjykata do të vendos nëse do të dëgjohen të gjithë këta persona, apo vetëm disa prej tyre.

Neni 268

Fletëthirrja për në seancë, ku do të paraqitet prova me dëgjimin e palëve, do t'u dërgohet palëve personalisht, respektivisht personit, i cili do të dëgjohet për palën.

Në fletëthirrje do të theksohet se në seancë do të paraqitet prova me dëgjimin e palëve dhe se pala që vjen në seancë mund të dëgjohet në mungesë të palës tjetër (neni 265 paragrafi 2).

Neni 269

Nuk mund të aplikohet asnjë masë shtërngimi ndaj palës që nuk i është përgjigjur thirrjes së gjykatës për t'u dëgjuar dhe që pala mund të shtërngohet për të dhënë deklaratë.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, do të çmojë rëndësinë e mosardhjes së palës për t'u dëgjuar, apo të refuzimit të dhënies së deklaratës.

Neni 270

Prova me dëgjimin e palëve paraqitet pa dhënien e betimit.

Neni 271

Dispozitat mbi paraqitjen e provave me dëshmitarë do të aplikohen edhe gjatë paraqitjes së provave me dëgjimin e palëve, në qoftë se për dëgjimin e palëve nuk është parashikuar dishka tjetër.

Kreu i nëntëmbëdhjetë

SIGURIMI I PROVAVE

Neni 272

Në qoftë se ekziston frika e bazuar se ndonjë provë nuk do të mund të paraqitet, apo se paraqitja e mëvonshme e saj do të ishte e vështirë, mund të propozohet gjatë kontestimit dhe para fillimit të kontestimit që kjo provë të paraqitet.

Në procedurën për sigurimin e provave nuk mund të paraqitet prova me dëgjimin e palëve.

Sigurimi i provave mund të kërket edhe pasi vendimi me të cilin përfundohet procedura, të ketë marrë formën e prerë, po qe se kjo është e nevojshme përpara apo gjatë procedurës sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme.

Neni 273

Në qoftë se propozimi për sigurimin e provave është paraqitur gjatë procedurës kontestimore, për veprim është kompetente gjykata para së cilës është në vazhdim procedura.

Kur kërket sigurimi i provave para fillimit të procedurës, si dhe në rastet urgjente, po qe se procedura është në vazhdim, është kompetente gjykata më e ultë e shkallës së parë, në zonën e së cilës ndodhen sendet që duhen shikuar, respektivisht gjykata në zonën e së cilës banon personi që duhet dëgjuar.

Rreth propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni vendos kryetari i kolegjit apo gjyqtari i vetëm që zhvillon procedurën, e në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni gjyqtari i vetëm i gjykatës kompetente.

Neni 274

Në parashtrësën me të cilën kërkon sigurimin e provave, propozuesi ka për detyrë të tregojë fakte që duhen provuar, provat që duhen paraqitur dhe shkaqet për të cilat konsideron se më vonë nuk do të mund të paraqitet prova apo se paraqitja e saj do të vështirësohet. Në parashtrësë duhen treguar emri dhe mbiemri i kundërshtarit, përveç në qoftë se nga rrethanat rezulton se ai është i panjohur.

Neni 275

Parashtrësja, në të cilën është paraqitur propozimi për sigurimin e provave, do t'i dërgohet kundërshtarit, po qe se ky është i njohur. Në qoftë se ekziston rreziku i shtytjes, gjykata do të vendos mbi propozimin edhe pa deklarimin e kundërshtarit.

Në aktvendim, me të cilin aprovohet propozimi, gjykata do të caktojë seancën për paraqitjen e provave, do të tregojë fakte rreth të cilave do të paraqiten provat, si dhe faktet që do të paraqiten, e në qoftë se nevojitet do të emërojë edhe ekspertë.

Në qoftë se kundërshtarit nuk i është dërguar më parë parashtrësja, në të cilën është paraqitur propozimi për sigurimin e provave, ajo do t'i dërgohet së bashku me aktvendimin e gjykatës, me të cilin aprovohet propozimi për sigurimin e provave.

Kundërshtarit që është i panjohur apo është i panjohur vendqëndrimi i tij, gjykata mundet, për pjesëmarrjen e tij në seancë për paraqitjen e provave, t'ia caktojë përfaqësuesin e përkohshëm (neni 84). Mbi këtë caktim nuk nevojitet dhënia e shpalljes.

Në rastet urgjente gjykata mund të caktojë që paraqitja e provave të fillojë edhe para se aktvendimi, me të cilin aprovohet propozimi për sigurimin e provave, t'i dërgohet kundërshtarit.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin aprovohet propozimi për sigurimin e provave, si dhe kundër aktvendimit, me të cilin vendoset që paraqitja e provave të fillojë para se aktvendimi t'i dërgohet kundërshtarit, nuk lejohet ankimi.

Neni 276

Në qoftë se provat janë paraqitur para se të ketë filluar procedura, procesverbali mbi paraqitjen e pro-

vave do të ruhet pranë gjykatës, para se chiës janë paraqitur provat.

Në qoftë se procedura është në vazhdim e sipër, kurse sigurimin e provave nuk e ka paraqitur gjykata kontestimore, procesverbali do t'i dërgohet gjykatës kontestimore.

Kreu i njëzetë

PREGATITJA E SEANCËS KRYESORE

Neni 277

Pas marrjes së padisë bëhen përgatitjet për seancën kryesore.

Këto përgatitje përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë të paditurit në përgjigje, mbajtjen e seancës përgatitore dhe konvokimin e seancës kryesore.

Përgatitja e seancës kryesore drejtohet nga kryetari i kolegjit.

Gjatë përgatitjes së seancës kryesore palët mund të drejtojnë parashtrës, në të cilat do të tregohen faktet që kanë ndërmend t'i paraqesin në seancën kryesore, si dhe provat paraqitjen e të cilave mendojnë ta propozojnë.

Neni 278

Gjatë përgatitjes së seancës kryesore deri në seancën për seancën kryesore, kryetari i kolegjit është i autorizuar të vendosë: mbi hyrjen e paraprakut në kontestim, mbi pjesëmarrjen e ndërhyrës, mbi sigurimin e provave, mbi ndryshimin e padisë, mbi shpenzimet e procedurës në rast të tërheqjes së padisë, mbi ndërprerjen ose pushimin e procedurës, mbi masat e përkohshme të sigurimit, mbi bashkimin e kontestimeve, mbi ndarjen e procedurës, mbi caktimin e afateve gjyqësore ose mbi zgjatjen e tyre, mbi konvokimin e seancave, apo mbi shtytjen e tyre, mbi kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të ometimit të afatit, apo të seancës, mbi lirimin e palës nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, mbi sigurimin e shpenzimeve të kontestimit, mbi deponimin e parashtrës në emër të shpenzimeve për ndërmarrjen e veprimeve të veçanta në procedurë, mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, mbi dërgimin e letrave gjyqësore, mbi masat për korrigjimin e parashtrës, mbi rregullsinë e prokurave, si dhe mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me drejtimin e procedurës.

Kundër vendimeve që i merr kryetari i kolegjit gjatë përgatitjes së seancës kryesore, e që kanë të bëjnë me drejtimin e procedurës, nuk lejohet ankimi.

Neni 279

Kryetari i kolegjit, gjatë përgatitjes së seancës kryesore, mund të nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit dhe aktgjykim për shkak të mungesës dhe të pranojë në procesverbal pajtimin e palëve.

Ekzaminimi paraprak i padisë

Neni 280

Pas ekzaminimit paraprak të padisë kryetari i kolegjit është i autorizuar të nxjerr aktvendime nga neni 278 i këtij ligji, në qoftë se nuk është fjala për çështjet rreth të cilave nga vetë natyra e çështjes ose sipas dispozitave të këtij ligji, vendimi mund të merret vetëm gjatë procedimit të mëtejshëm.

Neni 281

Kur të vërtetohet se padia është e pakuptueshme ose jo e plotë, apo se ekzistojnë të meta që kanë të bëjnë me aftësitë e paditësit, ose të të paditurit për të qenë palë në kontestim, apo të meta në pikëpamje të përfaqësimit ligjor të palës, ose të meta që kanë të bëjnë me autorizimin e përfaqësuesit për ta filluar kontestimin, kur autorizimi i tillë është i nevojshëm, kryetari i kolegjit, për mënjanimin e këtyre të metave,

do të ndërmarr masa të nevojshme të parashikuara në këtë ligj (nenet 83 dhe 109).

Neni 282

Pas ekzaminimit paraprak të padisë, kryetari i kolegjit nxjerr aktvendimin, me të cilin padia hidhet poshtë po qe se vërtetohet se vendosja rreth kërkesë-padisë nuk i përket kompetencës gjyqësore (neni 26) apo se padia është paraqitur jo në kohën e duhur, po qe se me dispozita të veçanta është caktuar afati për paraqitjen e padisë.

Kryetari i kolegjit nxjerr edhe aktvendimin, me të cilin gjykata shpallet inkompetente (nenet 17 dhe 20) dhe objekti i cedohet gjykatës tjetër ordinare apo gjykatës të punës së bashkuar.

Neni 283

Në qoftë se konsideron se nuk ka bazë të mjaftueshme për marrjen e vendimit mbi ndonjë çështje që është shtruar gjatë ekzaminimit paraprak të padisë, kryetari i kolegjit do të lejë që për këtë çështje të marrë vendim pas marrjes së përgjigjes në padinë ose në seancën përgatitore.

Seanca përgatitore dhe përgjigja në padinë

Neni 284

Në qoftë se kryetari i kolegjit konsideron se në bazë të padisë mund të veprohet më tej, do të konvokojë si rregull, seancën përgatitore dhe do të urdhërojë që kopja e padisë t'i dërgohet të paditurit.

Seanca përgatitore nuk do të konvokohet kur për gjykim është kompetent gjyqtari i vetëm.

Kryetari i kolegjit mund ta konvokojë menjëherë seancën për seancën kryesore në qoftë se konsideron se, duke marrë parasysh thëniet në padi dhe natyrën e kontestit, nuk nevojitet mbajtja e seancës përgatitore.

Neni 285

Para konvokimit të seancës përgatitore, kryetari i kolegjit mund të kërkojë nga i paditurit të paraqes përgjigjen në padi, po qe se për shkak të ndërlikueshmërisë së kontestit apo të numrit të madh të kërkesave të paraqitura në padi, do të ishte e përshtatshme që i paditurit të deklarohet me shkrim mbi thëniet në padinë.

Përgjigja në padinë paraqitet brenda afatit të cilin e cakton kryetari i kolegjit, por ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e dërgimit të padisë. Përaçshmërisht, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të rastit, ky afat mund të jetë edhe deri në 30 ditë.

Në qoftë se i paditurit e paraqet përgjigjen në padinë, kryetari i kolegjit do të çmojë, duke marrë parasysh propozimet dhe thëniet e palëve, nëse nevojitet konvokimi i seancës përgatitore apo mund të konvokohet menjëherë seanca për seancën kryesore.

Në qoftë se i paditurit brenda afatit të caktuar nuk e paraqet përgjigjen në padinë, kryetari i kolegjit do të konvokojë seancën përgatitore ose seancën për seancën kryesore.

I paditurit mund të përgjigjet me shkrim në padinë megjithëse këtë gjë nuk ka e urdhëruar gjykata.

Pas marrjes së përgjigjes në padinë, kryetari i kolegjit mund të nxjerrë të gjitha aktvendimet që mund të nxirren gjatë ekzaminimit paraprak të padisë.

Neni 286

Seanca përgatitore duhet të caktohet në mënyrë që palëve t'u mbetet mjaft kohë për t'u përgatitur, e të paktën tetë ditë nga marrja e thirrjes.

Në thirrjen për seancën përgatitore do t'u urdhërohet palëve që në seancë të sjellin të gjitha dokumentet që u shërbejnë si provë, si dhe të gjitha sendet që duhet të shikohen në gjykatë.

Në qoftë se nevojitet që për seancën kryesore të paraqiten shkresa, dokumente dhe sende që ndodhen

pranë gjykatës ose pranë organit tjetër shtetëror ose organizatës, që i është besuar ushtrimi i autorizimit publik, kryetari i kolegjit do të urdhërojë që këto sende, respektivisht këto dokumente të nxirren me kohë.

Neni 287

Seanca pregatitore fillon me shtjellimin e padisë, e pastaj i padituri paraqet përgjigjen e vet në padinë.

Kur është e nevojshme, kryetari i kolegjit do të kërkojë nga palët sqarime lidhur me thëniet apo propozimet e tyre.

Neni 288

Në seancën pregatitore më parë zhvillohet shqyrtimi rreth çështjeve që kanë të bëjnë me pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës, si kur kryetari i kolegjit pas ekzaminimit të padisë ta ketë shtytur zgjidhjen e këtyre çështjeve, ashtu edhe kur ato janë filluar në përgjigje të padisë apo në seancën pregatitore. Rreth këtyre çështjeve në seancën pregatitore mund të paraqiten prova, po qe se kjo është e nevojshme.

Përpos aktvendimit që është i autorizuar ta nxjerrë në bazë të ekzaminimit paraprak të padisë, në seancën pregatitore kryetari i kolegjit nxjerr edhe aktvendimin mbi hedhjen poshtë të padisë, po qe se vërteton se rreth kërkesë-padisë është në vazhdim kontestimi, se çështja është gjykuar në formë të prerë, se rreth objektit të kontestit është përfunduar pajtimi gjyqësor, se paditësi në kontestimin e mëparshëm ka hequr dorë nga kërkesë-padia, apo se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për paraqitjen e padisë për vërtetim.

Në qoftë se kryetari i kolegjit nuk e aprovon kundërshtimin se ekziston ndonjë nga pengesat për zhvillimin e procedurës nga paragrafi 2 i këtij neni, do ta vazhdojë shqyrtimin, kurse vendimin mbi kundërshtimin do ta marrë kolegj veças, apo së bashku me vendimin mbi çështjen kryesore.

Në seancën pregatitore, kryetari i kolegjit ka në pikëpamje të drejtimit të procedurës të gjitha autorizimet që kanë kryetari i kolegjit dhe kolegj në seancën kryesore.

Neni 289

Kur konstaton se nuk ekziston pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës, kryetari i kolegjit, sipas rezultateve të shqyrtimit në seancën pregatitore, do të vendos se cilët dëshmitarë dhe ekspertë do të thirren për në seancën kryesore dhe cilat prova do të merren. Se cilat prej këtyre provave do të paraqiten vendos kolegj në seancën kryesore.

Në qoftë se kryetari i kolegjit nuk i aprovon propozimet e palëve mbi provat, palët mund t'i përsërisin propozimet e veta në seancën kryesore.

Neni 290

Në qoftë se kryetari i kolegjit konsideron se disa fakte kontestuese nevojitet të vërtetohen me anë të ekspertëve, kurse asnjëra nga palët nuk e kundërshton ekspertimin, kryetari i kolegjit do të emërojë ekspertë, do të vendos mbi kërkesat për përjashtimin e ekspertëve dhe do të ftojë njerën apo të dy palët që të deponojnë shumën e nevojshme për shpenzimet e ekspertëve.

Ekspertët e emëruar gjykata do t'i njoftojë mbi objektin që duhen ta shikojnë dhe do t'i ftojë që deri në seancën kryesore të pregatisin rezultatit dhe mendimin e vet (neni 260 paragrafi 1).

Po të nevojitet, kryetari i kolegjit mundet, me pëlqimin e palëve të bëjë këqyrjen në vend jashtë gjykatës. Në qoftë se kjo këqyrje në vend bëhet me pjesëmarrjen e ekspertëve, në këtë rast do të aplikohen dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 291

Në qoftë se në seancën pregatitore nuk vjen paditësi apo nuk vjen i padituri, kurse nuk ekzistojnë

kushte për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, kryetari i kolegjit do ta mbajë shqyrtimin me palën e pranishme.

Neni 292

Në seancën pregatitore kryetari i kolegjit, si rregull, u komunikon palëve ditën dhe orën se ku do të mbahet seanca kryesore.

Konvokimi i seancës për seancën kryesore

Neni 293

Seanca për seancën kryesore konvokohet nga kryetari i kolegjit.

Bashkë me thirrjen për në seancën kryesore të paditurit i dërgohet padia, po qe se nuk i është dërguar më parë.

Kryetari i kolegjit do t'i thërras palët në seancë, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët që ka vendosur në seancën pregatitore t'i thërras për në seancën kryesore. Në qoftë se seanca pregatitore nuk është mbajtur, kryetari i kolegjit do të vendos se cilët dëshmitarë që i kanë propozuar palët do t'i thërras, kurse do t'i paralajmërojë palët se në seancë mund të sjellin edhe dëshmitarë të tjerë.

Dispozitat e nenit 286 të këtij ligji do të aplikohen edhe në konvokimin e seancës për seancën kryesore.

Kreu i njëzetinjë

SEANCA KRYESORE

Procesi i seancës kryesore

Neni 294

Kryetari i kolegjit hap seancën kryesore dhe shpall objektin e shqyrtimit. Pastaj vërteton nëse kanë ardhur të gjithë persona të fituar, e në qoftë se nuk kanë ardhur, verifikon nëse janë thirrur rregullisht dhe nëse e kanë justifikuar mungesën e tyre.

Neni 295

Në qoftë se nga seanca e parë për në seancën kryesore ka munguar paditësi, apo në qoftë se në këtë seancë nuk vjen i padituri dhe nuk ekzistojnë kushte për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, si dhe kur në ndonjë seancë të mëvonshme mungon paditësi ose i padituri, shqyrtimi mund të mbahet.

Neni 296

Në qoftë se pala, apo përfaqësuesi ligjor i palës nuk është në gjendje të deklarohet qartë e në mënyrë të caktuar mbi objektin rreth të cilit bëhet shqyrtimi, kurse nuk ka autorizues, kryetari i kolegjit do t'i theksojë nevojën e angazhimit të autorizuesit.

Në qoftë se pala është në pamundësi që menjëherë ta angazhojë autorizuesin, kolegj, me propozimin e saj, do ta shtyjë seancën.

Neni 297

Në qoftë se nuk është mbajtur më parë seanca pregatitore, seanca e parë për seancën kryesore fillon me shtjellimin e padisë, e pastaj i padituri përgjigjet në thëniet e padisë.

Në qoftë se përpara seancës kryesore është mbajtur seanca pregatitore, kryetari i kolegjit do ta njoftojë kolegj me procesin dhe me rezultatet e kësaj seance. Palët mund ta plotësojnë shtjellimin e kryetarit të kolegjit.

Gjatë procesit të mëtejshëm të shqyrtimit do të diskutohet rreth propozimeve të palëve dhe fakteve të thënieve, me të cilat palët arsyetojnë propozimet e veta, respektivisht i kundërshtojnë propozimet e kundërshtarit, si dhe mbi provat e ofruara nga ana e tyre, do të paraqiten provat dhe do të shqyrtohen rezultatet e paraqitjes së tyre.

Palët mund të paraqesin edhe pikëpamjet e veta juridike që kanë të bëjnë me objektin e kontestit.

Kur është parashikuar në këtë ligj që pala mund të bëjë kundërshtim ose propozim të caktuar apo të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër kontestimor gjersa i padituri në seancën kryesore të mos hyjë në diskutim rreth çështjes kryesore, kundërshtimi i tillë, respektivisht propozimi i tillë mund të bëhet nga paditësi, respektivisht mund të ndërmarrë veprim tjetër kontestimor gjersa të mos e përfundojë shtjellimin në bazë të padisë, kurse i padituri gjersa të mos e përfundojë përgjigjen e vet në padinë.

Neni 298

Kryetari i kolegjit, duke bërë pyetje dhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, do të kujdeset që gjatë seancës të paraqiten të gjitha faktet vendimtare, të plotësohen thëniet jo të plota të palëve mbi faktet të rëndësishme, të theksohen ose të plotësohen njetet provuese që kanë të bëjnë me thëniet e palëve dhe, në përgjithësi, të jepen të gjitha sqarime të nevojshme për të bërë që të vërtetohet gjendja faktike me rëndësi për marrjen e vendimit.

Neni 299

Secila palë në shtjellimet e veta duhet të paraqesë të gjitha faktet e nevojshme për arsyetimin, e propozimeve të veta, të ofrojë prova të nevojshme për vërtetimin e thënieve të veta, si dhe të deklarojë mbi thëniet dhe mbi provat e ofruara të palës kundërshtare.

Palët, gjatë gjithë seancës kryesore, mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja.

Palët, edhe gjatë seancës kryesore, mund të drejtojnë parashitresa, në të cilat do të tregojnë fakte që mendojnë t'i parashirojnë në seancë, si dhe provat, paraqitjen e të cilave mendojnë t'i propozojnë.

Neni 300

Paraqitjen e provave e cakton kolegji me aktvendim, në të cilin do të theksohet fakti kontestues rreth të cilit duhet paraqitur prova dhe mjetet provues.

Provat e propozuara, që nuk i quan të rëndësishme për vendim, kolegji do t'i hedhë poshtë dhe me aktvendim do të theksojë arsyen e hedhjes poshtë.

Kundër aktvendimit, me të cilin caktohet ose hiqet poshtë paraqitja e provave, nuk lejohet ankimi i veçantë.

Në procesin e mëtejshëm të kontestimit gjykata nuk është e obliguar për aktvendimin e vet të mëprashëm mbi paraqitjen e provave.

Neni 301

Në qoftë se pala kundërshton se vendosja mbi kërkesë-padinë nuk hyn në kompetencën gjyqësore, se gjykata nuk është me kompetencë lëndore apo territoriale, se për të njejtën kërkesë, është në vazhdim kontestimi, se çështja është gjykuar në formë të prerë, se rreth objektit të kontestit është përfunduar pajtimi gjyqësor, apo se paditësi para gjykatës ka hequr dorë nga kërkesë-padia, gjykata do të vendosë nëse për këto kundërshtime do të shqyrtojë dhe do të vendosë veças nga çështja kryesore apo së bashku me të.

Në qoftë se gjykata nuk e aprovon kundërshtimin nga paragrafi 1 i këtij neni, rreth të cilit është bërë shqyrtimi bashkë me çështjen kryesore, apo në qoftë se gjykata pas shqyrtimit të veçuar nuk e aprovon kundërshtimin dhe vendos që seanca kryesore të vazhdojë menjëherë, aktvendimin mbi kundërshtimin do ta përfshijë vendimin mbi çështjen kryesore.

Kundër vendimit, me të cilin hiqen poshtë kundërshtimet e palëve, nuk lejohet ankimi i veçantë, në qoftë se gjykata ka vendosur që të vazhdojë menjëherë rreth çështjes kryesore.

Disa paragrafeve 1 deri 3 të këtij neni do të aplikohen edhe kur gjykata vendos kryesisht që

ndamas nga çështja kryesore të shqyrtojë rreth faktit nëse çështja hyn në kompetencë gjyqësore, nëse gjykata është me kompetencë lëndore, nëse është në vazhdim e sipër kontestimi, nëse çështja është gjykuar në formë të prerë, nëse paditësi ka hequr dorë para gjykatës nga kërkesë-padia, si dhe nëse për objektin e kontestit është përfunduar pajtimi gjyqësor.

Neni 302

Kur kryetari i kolegjit i jep fund dëgjimit të dëshmitarit të veçantë, të ekspertit, apo të palës, anëtarët e kolegjit mund t'i bëjnë pyetje direkt këtij personi.

Pala dhe përfaqësuesi i saj, ose autorizuesi i saj, me lejen e kryetarit të kolegjit, mund t'i bëjnë pyetje direkte palës kundërshtare, dëshmitarëve dhe ekspertëve.

Kryetari i kolegjit do t'ia ndalojë palës që të bëjë pyetje të caktuara, ose do t'ia ndalojë përgjigjen në pyetjen e bërë, në qoftë se në vetë pyetjen është përmbajtur se si duhet t'i përgjigjet, apo në qoftë se pyetja nuk ka të bëjë me objektin.

Në qoftë se kryetari i kolegjit ndalon që të bëhet ndonjë pyetje e caktuar apo të jepet përgjigja, pala mund të kërkojë që për këtë gjë të vendos kolegji.

Me kërkesën e palës, në procesverbal do të përfshihet pyetja të cilën kolegji e ka refuzuar, si dhe pyetja në të cilën është ndaluar përgjigja.

Neni 303

Dëshmitarët dhe ekspertët e dëgjuar mbeten në sallën e gjyqit, në qoftë se kryetari i kolegjit, pas deklarimit të palëve, nuk i lëshon fare apo nuk cakton që përkohësisht të largohen nga sala e gjyqit.

Kryetari i kolegjit mund të caktojë që dëshmitarët e dëgjuar më vonë të thirren përsëri dhe të dëgjohen edhe njëherë në praninë apo në mungesën e dëshmitarëve dhe të ekspertëve.

Neni 304

Kur kolegji e quan se objekti është shqyrtuar kështu që mund të merret vendimi, kryetari i kolegjit do të komunikojë se seanca kryesore ka përfunduar dhe pas kësaj kolegji do të tërhiqet në këshillin dhe votim për marrjen e vendimit.

Kolegji mund të vendos që seancën kryesore ta përfundojë edhe kur ka mbetur që të sjellen shkresa të veçanta që përmbajnë prova të nevojshme për marrjen e vendimit, apo në qoftë se duhet pritur procesverbali mbi provat e paraqitura nga gjyqtari i lutur, kurse palët heqin dorë nga shqyrtimi mbi këto prova, apo kolegji e quan se ky shqyrtim nuk nevojitet.

Neni 305

Kolegji mundet, gjatë këshillimit dhe votimit, të vendos që seanca kryesore e përfunduar të hapet përsëri në qoftë se kjo është e nevojshme për plotësimin e procedurës apo për sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme.

Publiciteti i seancës kryesore

Neni 306

Seanca kryesore është publike.

Në seancë mund të asistojnë vetëm personat madhore.

Personat që asistojnë në seancë nuk guxojnë të mbajnë armë apo mjete të rrezikshme.

Dispozita e paragrafit 3 të këtij neni nuk ka të bëjë me rojtare të personave që marrin pjesë në proces.

Neni 307

Kolegji mund ta përjashtojë publikum për krejt seancën kryesore ose për një pjesë të saj, po qe se këtë e lypin interesat e ruajtjes së fshehtësisë zyr-

tare, të punës apo personale, interesat e rendit publik apo arsytet e moralit.

Kolegji mund ta përjashtojë publikun edhe në rastin kur me masat e parashikuara në këtë ligj nuk do të mund të sigurohej mbajtja pa pengesë e shqyrtimit.

Neni 308

Përjashtimi i publikut nuk ka të bëjë me palët, me përfaqësuesit e tyre ligjorë, autorizuesit dhe ndërhyrësit.

Kolegji mund të lejojë që në seancën kryesore, në të cilën është përjashtuar publiku, të jenë të pranishëm personat e veçantë zyrtarë, si dhe punëtorët shkencorë e publikë, po që se kjo paraqet interes për shërbimin e tyre, respektivisht për veprimtarinë shkencore ose publike.

Me kërkesën e palës, kolegji mund të lejojë që në seancë të marrin pjesë më së shumti dy persona që i cakton ai.

Kryetari i kolegjit do t'i paralajmërojë personat që janë të pranishëm në seancë ku është përjashtuar publiku, se e kanë për detyrë ta ruajnë si fshehtësi çdo gjë që kanë mësuar në seancë dhe do t'u theksojnë pasojat e zbulimit të fshehtësisë.

Neni 309

Mbi përjashtimin e publikut vendos kolegji me aktvendim, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe i shpallur publikisht.

Kundër aktvendimit mbi përjashtimin e publikut nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 310

Dispozitat mbi publicitetin në seancën kryesore përshatshëmrisht do të vihen në zbatim edhe ndaj seancës pregatitore, ndaj seancës jashtë seancës kryesore para kryetarit të kolegjit, si dhe ndaj seancës para gjyqtarit të lutur.

Drejtimi i seancës kryesore

Neni 311

Kryetari i kolegjit drejton seancën kryesore, merr në pyetje palët, paraqet prova, u jep fjalën anëtarëve të kolegjit, palëve, përfaqësuesve dhe autorizuesve të tyre ligjor dhe shpall vendimet e kolegjit.

Detyra e kryetarit të kolegjit është të kujdeset që objekti i kontestit të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme, por që për këtë arsye procedura të mos zvaritet, kështu që shqyrtimi të përfundojë mundësisht në një seancë.

Në qoftë se personi që merr pjesë në shqyrtim e kundërshton ndonjë masë të kryetarit të kolegjit që ka të bëjë me drejtimin e seancës apo me ndonjë çështje të shtruar nga kryetari i kolegjit, anëtar i kolegjit ose personi tjetër që merr pjesë në proces, mbi kundërshtimin e tillë vendos kolegji.

Gjykata nuk është e obliguar nga aktvendimi i vet që ka të bëjë me drejtimin e seancës.

Kundër aktvendimit që ka të bëjë me drejtimin e seancës nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 312

Jashtë seancës për seancën kryesore kryetari i kolegjit nxjerr aktvendimin mbi ekzaminimin e parashtrësve, mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, mbi gjendjen e rregullt të prokurës, mbi depozimin e parashtrës për efekt të shpenzimeve për ndërmarrjen e veprimeve të veçanta në procedurë, mbi lirimimin nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, mbi sigurimin e shpenzimeve të kontestimit, mbi dërgimin e letrave gjyqësore, mbi sigurimin e provave, mbi masat e përkohshme të sigurimit, mbi ndërprerjen dhe pushimin e procedurës, mbi shpenzimet e procedurës me rastin e tërheqjes së padisë, mbi konvokimin e seancave dhe mbi shtytjen e tyre, mbi ba-

shkimin e kontestimeve, si dhe mbi caktimin e afateve e mbi zgjatjen e tyre.

Kryetari i kolegjit është gjithashtu i autorizuar, pas marrjes së procesverbalit mbi paraqitjen e provave para gjyqtarit të lutur, të caktojë që të bëhen korrigjime ose plotësime të nevojshme.

Jashtë seancës për seancën kryesore kryetari i kolegjit, është i autorizuar që me rastin e deklarimit të paditurit, të dhënë me shkrim ose në procesverbal pranë gjykatës kontestimore, të nxjerrë aktgjykimin në bazë të pohimit, si dhe të pranojë në procesverbal pajtimin gjyqësor.

Neni 313

Në qoftë se para së njejtës gjykatë zhvillohen disa kontestime midis personave të njejtë, apo në të cilat i njehti person është kundërshtar i paditësve të ndryshëm, ose i të paditurëve të ndryshëm, të gjitha këto kontestime mund të bashkohen me aktvendim të kolegjit për shqyrtimin e përbashkët të tyre, po që se me këtë gjë do të shpejtohej shqyrtimi, ose do të pakësoheshin shpenzimet. Për të gjitha kontestimet e bashkuara gjykata mund të nxjerrë aktgjykim të përbashkët.

Kolegji mund të caktojë që për shqyrtim të përbashkët para tij të bashkohen disa kontestime edhe atëherë kur për ndonjerën prej tyre është kompetent gjyqtari i vetëm i së njejtës gjykatë.

Kolegji mund të caktojë që të shqyrtohet veças mbi kërkesat e veçanta në të njejtën padi dhe pas mbarimit të shqyrtimit të veçuar mund të nxjerrë vendime të veçanta mbi këto kërkesa.

Neni 314

Kur kolegji vendos që të shtyhet seanca për seancën kryesore, kryetari i kolegjit do të kujdeset që për seancën e ardhshme të sigurohen të gjitha provat, paraqitja e të cilave është caktuar për në atë seancë dhe të bëhen përgatitje të tjera në mënyrë që shqyrtimi të mund të përfundojë në atë seancë.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin shtyhet seanca ose refuzohen propozimet e palëve mbi shtytjen e seancës, ankimi nuk lejohet.

Neni 315

Në qoftë se shtyhet seanca, seanca e re do të mbahet mundësisht para të njejtit kolegji.

Në qoftë se seanca e re mbahet para të njejtit kolegji, seanca kryesore do të vazhdojë dhe kryetari i kolegjit do të paraqes shkurtimisht procesin e seancave të mëparshme, por në këtë rast kolegji mund të vendos që shqyrtimi të fillojë përsëri.

Në qoftë se seanca mbahet para kolegjit të ndryshuar, seanca kryesore duhet të fillojë përsëri, por kolegji mundet, pasi të deklarohen palët për këtë gjë, të vendos që të mos dëgjohen përsëri dëshmtarët dhe ekspertët dhe të mos bëhet përsëri këyryja në vend, por të lexohen procesverbalet mbi paraqitjen e këtyre provave.

Neni 316

Gjykata mund ta dënojë gjatë procesit me gjobë deri në 1.000 dinarë palën, përfaqësuesin ligjor, autorizuesin ose ndërhyrësin, i cili me veprimet e veta kontestimore shpërdoron rëndë të drejtat e njohura me këtë ligj.

Mbajtja e rregullit në seancën kryesore

Neni 317

Detyra e kryetarit të kolegjit është që gjatë seancës kryesore të kujdeset për mbajtjen e rregullit në sallën e gjyqit dhe për dinjitetin e gjykatës.

Neni 318

Në qoftë se personi që merr pjesë në proces ose personi që si dëgjues është i pranishëm gjatë shqyrt-

timit fyen gjykatën apo pjesëmarrësit e tjerë në proces, pengon punën ose nuk u nënshtrohet urdhërave të kryetarit të kolegjit për mbajtjen e rregullit, kryetari i kolegjit do ta qortojë. Po qe se qortimi do të jetë i pasuksesshëm, kolegji mund ta largojë personin e caktuar nga salla e gjyqit ose ta dënojë me gjobë deri në 1.000 dinarë, kurse mundet edhe ta largojë dhe ta dënojë me gjobë.

Në qoftë se pala largohet nga salla e gjyqit, seanca do të mbahet pa praninë e saj.

Në qoftë se nga salla e gjyqit largohet autorizuesi, kolegji do ta shtyjë seancën, me kërkesën e palës, kurse në qoftë se pala nuk është e pranishme në seancë, kolegji kurodoherë do ta shtyjë seancën dhe do ta njoftojë se përfaqësuesi i saj është larguar nga seanca për shkak të prishjes së rregullit.

Kur gjykata e dënon me gjobë ose e largon nga salla e gjyqit avokatin apo praktikantin e avokatit si autorizues, do ta njoftojë për këtë gjë odën e avokatëve.

Ankimi kundër aktvendimit mbi dënimin me gjobë ose mbi largimin nga salla e gjyqit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 319

Në qoftë se avokati shoqëror i vetëqeverisjes, prokurori publik ose avokati publik, respektivisht personi që i zëvendëson, prish rregullin, kryetari i kolegjit do ta njoftojë për këtë gjë avokatin kompetent shoqëror të vetëqeverisjes, prokurorin publik, respektivisht avokatin publik, kurse kolegji mund ta shtyjë seancën dhe të kërkojë nga avokati shoqëror kompetent i vetëqeverisjes, prokurori publik, respektivisht nga avokati publik të caktojë personin tjetër për të marrë pjesë në kontestim.

Neni 320

Autorizimet që kanë për ruajtjen e rregullit në seancën kryesore kryetari i kolegjit dhe kolegji, i takojnë kryetarit të kolegjit në seancën pregatitore dhe në seancë jashtë seancës kryesore, si dhe gjyqtarit të lutur.

Kreu i njëzetedytë

PAJTIMI GJYQËSOR

Neni 321

Palët mund të përfundojnë pajtimin gjatë gjithë procedurës para gjykatës kontestimore të shkallës së parë mbi objektin e kontestit (pajtimi gjyqësor).

Pajtimi mund të ketë të bëjë me krejt kërkesë-padinë ose me një pjesë të saj.

Gjatë gjithë procedurës gjykata do t'u theksojë palëve mundësinë e pajtimit gjyqësor dhe do t'u ndihmojë të përfundojnë pajtimin.

Para gjykatës nuk mund të përfundohet pajtimi në pikëpamje të kërkesave që nuk mund t'i disponojnë palët (neni 3 paragrafi 3).

Kur gjykata nxjerr aktvendimin, me të cilin nuk lejon pajtimin e palëve, do të ndërpritet procedura gjersa kty aktvendim të mos marrë formën e prerë.

Neni 322

Marrëveshja e palëve mbi pajtimin përfshihet në procesverbal.

Pajtimi quhet i përfunduar kur palët pas leximit të procesverbalit mbi pajtimin e nënshkruajnë procesverbalin.

Palëve, me kërkesën e tyre do t'u jepet kopja e legalizuar e procesverbalit, ku është përfshirë pajtimi.

Neni 323

Gjykata gjatë gjithë procedurës do të kujdeset kryesisht nëse kontestimi zhvillohet rreth objektit mbi të cilin më parë është përfunduar pajtimi gjyqësor dhe në qoftë se vërteton se kontestimi zhvillohet rreth

objektit mbi të cilin është përfunduar më parë pajtimi gjyqësor, do ta hedhë poshtë padinë.

Neni 324

Personi që ka ndërmend të ngrejë padi mundet, me anë të gjykatës më të ultë të shkallës së parë, në zonën e së cilës pala kundërshtare ka vendbanimin e vet, të tentojë që të realizojë pajtimin.

Gjykata të cilës i është drejtuar një propozim i tillë do ta thërras palën kundërshtare dhe do ta vëjë në dijeni mbi propozimin për pajtim.

Shpenzimet e kësaj procedure i përballon paraqitësi i propozimit.

Kreu i njëzetatretë

AKTGJYKIMI

Neni 325

Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjet kryesore dhe me kërkesat aksesore.

Në qoftë se ekzistojnë disa kërkesa, gjykata për të gjitha këto kërkesa, si rregull, do të vendos me një aktgjykim.

Në qoftë se disa kontestime janë bashkuar për shqyrtim të përbashkët, ose për vendim definitiv është pjekur vetëm një kontestim, mund të nxirret aktgjykim vetëm për këtë kontestim.

Neni 326

Gjykata mund ta urdhërojë të paditurin që të kryejë veprim të caktuar vetëm në qoftë se ai ka arritur deri në përfundimin e seancës kryesore.

Në qoftë se gjykata aprovon kërkesën për ushqim, mund ta obligojë të paditurin edhe për veprime që nuk kanë arritur.

Aktgjykimin me të cilin i padituri obligohet që t'i dorëzojë apo t'i marrë përsipër sendet e dhëna me mëditje apo me qira, mund të nxirret edhe para shuarjes së këtyre marrëdhënieve.

Neni 327

Në qoftë se paditësi ka kërkuar në padi që t'i gjykohej ndonjë send, kurse njëkohësisht në padinë ose deri në përfundimin e seancës kryesore ka deklaruar se është i gatshëm që në vend të sendit të marrë një shumë të hollash, gjykata, po qe se e aprovon kërkesë-padinë, do të caktojë në aktgjykim se i padituri mund të lirohet nga dhënia e sendit, po qe se e paguan këtë shumë të hollash.

Neni 328

Kur Palës në aktgjykim i urdhërohet kryerja e ndonjë veprimi, do të caktohet edhe afati në të cilin këtë veprim ka për detyrë ta kryejë.

Po qe se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe, afati i kryerjes së veprimit është pesëmbëdhjetë ditë, por për veprimet që nuk përbëhen nga dhënia e të hollave, gjykata mund të caktojë afat më të gjatë. Në kontestet kambiale dhe të çeqeve ky afat është tetë ditë.

Afati për kryerjen e veprimit fillon të rrjedhë prej ditës së parë pas dorëzimit të kopjes së aktgjykimit (palës të cilës i është urdhëruar ekzekutimi).

Aktgjykimin i pjesëshëm

Neni 329

Në qoftë se prej disa kërkesë-padive, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit, vetëm disa prej tyre janë pjekur për vendim definitiv, ose në qoftë se vetëm një pjesë e kërkesës është pjekur për vendim definitiv, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të pjekura, respektivisht të pjesës së kërkesave, ta

përfundojë shqyrtimin dhe të nxjerrë aktgjykim (aktgjykim i pjesshëm).

Aktgjykimi e pjesshëm gjykata mund ta nxjerrë edhe kur është paraqitur kundërpadia, po qe se për vendim është pjekur vetëm kërkesa e padisë ose kërkesa e kundër-padisë.

Gjatë çmuarjes së çështjes nëse do të nxjerrë aktgjykim të pjesshëm, gjykata do të ketë sidomos parasysh madhësinë e kërkesës, ose të pjesës së kërkesës, që është pjekur për vendim.

Në pikëpamje të mjeteve juridike dhe të ekzekutimit, aktgjykimi i pjesshëm konsiderohet si aktgjykim në vete.

Aktgjykim i ndërmjetëm

Neni 330

Në qoftë se i padituri e ka kontestuar si bazën e kërkesë-padisë ashtu edhe shumën e kërkesë-padisë, kurse në pikëpamje të bazës çështja është pjekur për marrjen e vendimit, gjykata mundet, për shkaqe të përshtatshmërisë, më parë të nxjerrë aktgjykim vetëm mbi bazën e kërkesë-padisë (aktgjykim i ndërmjetëm).

Deri atëherë kur aktgjykimi i ndërmjetëm të ketë marrë formën e prerë, gjykata do të ndërprejë shqyrtimin mbi shumën e kërkesë-padisë.

Aktgjykimi në bazë të pohimit

Neni 331

Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e seancës kryesore e pohon kërkesë-padinë, gjykata do të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim të mëtejshëm, me të cilin aprovon kërkesë-padinë (aktgjykim i bazë të pohimit).

Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit edhe kur janë plotësuar kushtet e nevojshme, në qoftë se konstaton se është fjala për kërkesën që palët nuk mund ta disponojnë (neni 3 paragrafi 3).

Nxjerrja e aktgjykimit në bazë të pohimit do të shtyhet në qoftë se është e nevojshme që mbi rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni të merren më parë njoftime.

Pohimin e kërkesë-padisë, në seancë apo në parashtrësën shkresore, i padituri, mund ta revokojë edhe pa pëlqimin e paditësit deri në nxjerrjen e aktgjykimit.

Aktgjykimi për shkak të mungesës

Neni 332

Kur i padituri nuk vjen në seancën pregatitore deri në përfundimin e saj, ose në seancën e parë për në seancën kryesore po qe se seanca kryesore nuk është mbajtur, apo në qoftë se vjen në këto seanca por nuk dëshiron të hyjë në shqyrtime ose largohet nga seanca e nuk e kundërshton kërkesë-padinë, do të nxirret aktgjykim, me të cilin aprovet kërkesë-padia (aktgjykim për shkak të mungesës), po qe se janë plotësuar këto kushte:

- 1) në qoftë se i padituri është thirrur rregullisht;
- 2) në qoftë se paditësi propozon nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës;
- 3) në qoftë se i padituri nuk e ka kontestuar me parashtrësë kërkesë-padinë;
- 4) në qoftë se bazueshmëria e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e theksuara në padi;
- 5) në qoftë se faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka paraqitur vetë paditësi ose me faktet e njohuara për të gjithë;
- 6) në qoftë se nuk ekzistojnë rrethana të njohura për të gjithë nga të cilat rezulton se të paditurin e kanë penguar arsyet e justifikuar për të ardhur në seancë.

Nuk do të nxirret aktgjykimi për shkak të mungesës edhe kur të jenë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, në qoftë se gjykata konstaton se është fjala për kërkesën të cilën palët nuk mund ta disponojnë (neni 3 paragrafi 3).

Nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës do të shtyhet në qoftë se nevojitet që mbi rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni të merren më parë njoftime.

Në qoftë se nga faktet e theksuara në padi nuk rezulton bazueshmëria e kërkesë-padisë, kurse padia në seancë nuk është ndryshuar, gjykata do të nxjerrë aktgjykim me të cilin hidhet poshtë kërkesë-padia.

Nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës mund të shtyhet edhe në rastin kur nuk ka prova që tregojnë se i padituri është thirrur rregullisht, ndërsa nuk ka dyshim se thirrja i është dërguar. Në këtë rast kryetari i kolegjit do të caktojë afatin, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë ditë për dërgesën në vend, respektivisht më i gjatë se gjashtë muaj për dërgesën në botën e jashtme, për të parë nëse i padituri është thirrur rregullisht. Në qoftë se brenda këtij afati vërtetohet se i padituri është thirrur rregullisht, kryetari i kolegjit do të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës.

Kundër vendimit të gjykatës, me të cilin hidhet poshtë propozimi i paditësit që të nxirret aktgjykimi për shkak të mungesës, lejohet ankimi i veçantë.

Në rastet e parashikuara në paragrafet 3 dhe 5 të këtij neni, aktgjykimin për shkak të mungesës gjykata mund ta nxjerrë pa dëgjimin e palëve.

Forma e prerë e aktgjykimit

Neni 333

Aktgjykimi që nuk mund të kundërshtohet me ankimi merr formën e prerë në qoftë se me të është vendosur mbi kërkesën e padisë ose të kundër-padisë.

Gjykata gjatë gjithë procedurës kujdeset kryesisht nëse çështja është gjykuar në formë të prerë, e po qe se vërtetohet se kontestimi ka filluar mbi kërkesën rreth së cilës është marrë vendimi i formës së prerë, do ta hedhë poshtë padinë.

Në qoftë se në aktgjykim është vendosur mbi kërkesën që e ka theksuar i padituri me kundërshtim për kompensim, vendimi mbi qenien ose mbi mosqenien e kësaj kërkesë merr formën e prerë.

Neni 334

Gjykata është e obliguar për aktgjykimin e vet po sa ky të shpallet, e në qoftë se aktgjykimi nuk është shpallur, po të jetë dërguar.

Ndaj palëve aktgjykimi ka efekt vetëm prej ditës kur u është dërguar.

Nxjerrja dhe shpallja e aktgjykimit

Neni 335

Aktgjykimi nxirret dhe shpallet në emër të popullit.

Kur seanca kryesore mbahet para kolegjit, aktgjykimin e nxjerrin kryetari i kolegjit dhe anëtarët e kolegjit që kanë marrë pjesë në seancë, ku ka përfunduar seanca kryesore. Menjëherë pas përfundimit të seancës kryesore gjykata nxjerr aktgjykim, të cilin e shpall kryetari i kolegjit.

Në objektet e ndërlikuara gjykata mund ta shtyjë nxjerrjen e aktgjykimit për tetë ditë nga data e përfundimit të seancës kryesore. Në këtë rast aktgjykimi nuk do të shpallet, por gjykata do t'ua dërgojë kopjen e aktgjykimit palëve.

Në rastin nga neni 304 paragrafi 2 të këtij ligji, aktgjykimi do të nxirret jo më vonë se brenda tetë ditësh nga data e marrjes së shkresave, respektivisht të procesverbalit. Ky aktgjykim nuk do të shpallet.

Neni 336

Kur aktgjykimi të jetë shpallur, kryetari i kolegjit do ta lexojë botërisht dispozitivin dhe do t'i komunikojë shkurtimisht arsyet e aktgjykimit.

Kur bëhet shpallja e aktgjykimit mund të komunikohet se gjykata ka vendosur që rreth caktimit të shpenzimeve të vendoset më vonë. Në një rast të tillë caktimi i shpenzimeve bëhet prej kryetarit të kolegjit, kurse vendimi përfshihet në përbërjen shkresore të aktgjykimit.

Në qoftë se publiku në seancën kryesore është përjashtuar, dispozitivi i aktgjykimit kurodoherë do të lexohet botërisht kurse gjykata do të vendos nëse dhe sa do të përjashtohet publiku gjatë shpalljes së arsyeve të aktgjykimit.

Të gjithë të pranishmit do të dëgjojnë leximin e dispozitivit të aktgjykimit duke qëndruar në këmbë.

Hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit

Neni 337

Aktgjykimi duhet të hartohet me shkrim brenda tetë ditësh nga data e nxjerrjes së tij.

Kopjen origjinale të aktgjykimit e nënshkruan kryetari i kolegjit.

Palëve u dërgohet kopja e legalizuar e aktgjykimit së bashku me udhëzimin mbi të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik kundër aktgjykimit.

Neni 338

Aktgjykimi i hartuar me shkrim duhet të ketë parathënien, dispozitivin dhe arsyetimin e vet.

Parathënia e aktgjykimit përmban: emërtimin se aktgjykimi jepet në emër të popullit, titullin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe të anëtarëve të kolegjit, emrin dhe mbiemrin, profesionin dhe vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve e të autorizuesve të tyre, emërtimin e shkurtër të objektit të kontestit, ditën e përfundimit të seancës kryesore, emërtimin e palëve, të përfaqësuesve dhe të autorizuesve të tyre, që kanë marrë pjesë në këtë seancë, si dhe ditën kur është nxjerrë aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjykimit përmban vendimin e gjykatës mbi aprovimin ose mbi hedhjen poshtë të kërkesave të veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore dhe vendimin mbi qënien apo mbi mosqënien e kërkesës së theksuar për qëllime kompensimi (neni 333).

Në arsyetimi gjykata do të parashtrojë: kërkesat e palëve dhe thëniet e tyre mbi faktet në të cilat bazohen këto kërkesa, mbi provat, si dhe mbi dispozitat në të cilat gjykata e ka bazuar aktgjykimin e vet.

Në arsyetimin e aktgjykimit për shkak të mungesës ose të aktgjykimit në bazë të pohimit do të parashtrohen vetëm arsyet që justifikojnë nxjerrjen e aktgjykimeve të tilla.

Aktgjykimi plotësues

Neni 339

Në qoftë se gjykata ka ometuar të vendos mbi të gjitha kërkesat rreth të cilave duhet të vendoset me aktgjykim, ose ka ometuar të vendos mbi një pjesë të kërkesave, pala mundet, në afatin prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së aktgjykimit, t'i propozojë gjykatës kontestimore që të bëjë plotësimin e aktgjykimit.

Propozimi i paraqitur jo në kohën e duhur apo i pabazuar për plotësimin e aktgjykimit, do të hidhet poshtë, respektivisht do ta refuzojë kryetari i kolegjit, pa mbajtur seancë.

Neni 340

Kur kryetari i kolegjit konstaton se propozimi për plotësimin e aktgjykimit është i bazuar, do ta

konvokojë seancën kryesore para kolegjit për nxjerrjen e aktgjykimit mbi kërkesën që nuk është zgjidhur (aktgjykimi plotësues).

Aktgjykimi plotësues mund të nxirret edhe pa e hapur përsëri seancën kryesore, në qoftë se këtë aktgjykim e nxjerr i njëjti kolegji që ka nxjerrë edhe aktgjykimin paraprak, kurse kërkesa mbi të cilën kërkohej plotësimi është shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme.

Në qoftë se kolegji konstaton se propozimi për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues nuk është paraqitur në kohën e duhur apo se i pabazuar, do ta hedhë poshtë, respektivisht refuzojë propozimin me aktvendim.

Në qoftë se propozimi për plotësimin e aktgjykimit ka të bëjë vetëm me shpenzimet e procedurës, vendimin mbi propozimin e nxjerrë kryetari i kolegjit pa mbajtur seancën.

Neni 341

Në qoftë se, përpos propozimeve për plotësimin e aktgjykimit është paraqitur edhe ankimi kundër aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë do ta ndërprejë dërgimin e këtij ankimi gjykatës të shkallës së dytë gjersa të mos merret vendimi mbi propozimin për plotësimin e aktgjykimit dhe gjersa të mos skadojë afati për ankim kundër këtij vendimi.

Në qoftë se kundër vendimit mbi plotësimin e aktgjykimit bëhet ankimi, ky ankim, së bashku me ankimin kundër aktgjykimit paraprak, do t'i dërgohet gjykatës të shkallës së dytë.

Në qoftë se aktgjykimi i shkallës së parë kundërshtohet me ankim vetëm sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur me aktgjykim mbi të gjitha kërkesat e palëve që janë objekt i kontestimit, ankimi do të konsiderohet si propozim i palës për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues.

Korrigjimi i aktgjykimit

Neni 342

Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabime të tjera të hapura në shkrim dhe kalkulim, gabimet në formën dhe mospajtimi i kopjes së aktgjykimit me origjinalin, do t'i korrigjojë kryetari i kolegjit në çdo kohë.

Korrigjimi do të bëhet me aktvendim të veçantë dhe do të përfshihet në fund të kopjes origjinale, kurse palëve do t'u dërgohet kopja e aktvendimit.

Në qoftë se midis origjinalit dhe kopjes së aktvendimit ekziston mospajtimi në pikëpamje të ndonjë vendimi të përmbajtur në dispozitivin e aktgjykimit, palëve do t'u dërgohet kopja e korrigjuar e aktgjykimit, duke theksuar se me këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në një rast të tillë afati për ushtrimin e mjetit juridik fillon që nga dita e dërgimit të tekstit të korrigjuar të kopjes së aktgjykimit.

Mbi korrigjimin e aktgjykimit gjykata mund të vendos pa dëgjimin e palëve.

Kreu i njëzetekatërt

AKTVENDIMI

Neni 343

Të gjitha aktvendimet që nxirren në seancë shpallen nga kryetari i kolegjit.

Aktvendimi që është shpallur në seancë do t'u dërgohet palëve në kopje të legalizuara vetëm në qoftë se kundër këtij aktvendimi lejohet ankim i veçantë, apo në qoftë se në bazë të aktvendimit mund të kërkohej menjëherë ekzekutimi, ose po që se këtë e kërkon drejtimi i kontestimit.

Gjykata është e obliguar me aktvendime të veta në qoftë se ato nuk kanë të bëjnë me drejtimin e

2
3
4

kontestimit, apo në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar dishka tjetër.

Kur aktvendimi nuk dërgohet me shkrim, ai ndaj palëve ka efekt posa të shpallet.

Neni 344

Aktvendimet që i nxjerr gjykata jashtë seancës u komunikohen palëve duke ua dërguar kopjen e legalizuar të aktvendimit.

Në qoftë se me aktvendim hidhet poshtë propozimi i njerës palë pa dëgjimin paraprak të palës kundërshtare, kësaj pale aktvendimi nuk do t'i dërgohet.

Neni 345

Aktvendimi duhet të jetë i arsyetuar, në qoftë se me të hidhet poshtë propozimi i palës, apo në qoftë se në të vendoset mbi propozimet e palëve, që janë në kundërshtim njera me tjetrën, e mund të arsyetohet edhe në raste të tjera, kur kjo është e nevojshme.

Hartimi me shkrim i aktvendimit duhet të përmbajë gjithmonë hyrjen dhe dispozitivin, kurse arsyetimin vetëm në qoftë se sipas paragrafit 1 të këtij neni aktvendimi duhet të arsyetohet.

Neni 346

Aktvendimet e formës së prerë mbi dënimet e dhëna sipas dispozitave të këtij ligji ekzekutohen kryesisht.

Neni 347

Dispozitat e neneve 328, 334 paragrafi 2, të nenit 335 paragrafi 2, të nenit 336 paragrafi 2 dhe të neneve 337 deri 342 të këtij ligji vihen përshtatshmërisht në zbatim edhe ndaj aktvendimeve.

B. Procedura në bazë të mjeteve juridike

Kreu i njëzetepestë

MJETET JURIDIKE TË ZAKONSHME

1. Ankimi kundër aktgjykimit

E drejta e ankimit

Neni 348

Kundër aktgjykimit të nxjerrë në shkallë të parë palët mund të bëjnë brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e dërgimit të kopjes së aktgjykimit, në qoftë se në këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në kontestet e kambialeve e të çeqeve ky afat është tetë ditë.

Ankimi i bërë në kohën e duhur pengon që aktgjykimi të marrë formën e prerë në pjesën që kundërshtohet me ankim.

Mbi ankimin kundër aktgjykimit vendos gjykata e shkallës së dytë.

Neni 349

Pala mund të heqë dorë nga e drejta e ankimit që nga momenti kur është shpallur aktgjykimi, e në qoftë se aktgjykimi nuk është shpallur, atëherë që nga momenti kur i është dhënë kopja e aktgjykimit.

Deri në marrjen e vendimit të gjykatës të shkallës së dytë pala mund të heqë dorë nga ankimi i bërë.

Tërheqja ose heqja dorë nga ankimi nuk mund të revokohet.

Përmbajtja e ankimit

Neni 350

Ankimi duhet të përmbajë:

- 1) emërtimin e aktgjykimit kundër të cilit bëhet ankimi;
- 2) deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në një pjesë të caktuar;
- 3) arsyen e ankimit;
- 4) nënshkrimin e paraqitësit të ankimit.

Neni 351

Në qoftë se në bazë të të dhënave nga ankimi nuk mund të vërtetohet se cili aktgjykim kundërshtohet apo në qoftë se ankimi nuk është nënshkruar (ankimi jo i plotë), gjykata e shkallës së parë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi, do ta thërras ankuesin që, brenda afatit të caktuar, ta plotësojë ose ta korrigjojë ankimin me parashtrësë ose në procesverbal pranë kësaj gjykate.

Në qoftë se ankuesi në afatin e caktuar nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata do ta hedhë poshtë me aktvendim ankimin si jo të plotë.

Në qoftë se ankimi sipas përmbajtjes së vet ka të meta të tjera, gjykata e shkallës së parë do t'ia dërgojë gjykatës së shkallës së dytë ankimin, duke mos e thirrur ankuesin që ta plotësojë, respektivisht ta korrigjojë.

Neni 352

Në ankim mund të shtrohen fakte të reja dhe të propozohen prova të reja. Duke invokuar fakte të reja, ankuesi ka për detyrë të theksojë provat me të cilat do të vërtetoheshin këto fakte, e duke propozuar provat e reja ka për detyrë të theksojë fakte që me anë të këtyre provave duhen vërtetuar.

Kundërshtimi për kompensim që nuk është shtruar para gjykatës të shkallës së parë nuk mund të shtrohet në ankim.

Në qoftë se për shkak të shtruarjes së fakteve të reja dhe propozimit të provave të reja janë shkaktuar shpenzimet në procedurë me rastin e ankimit, këto shpenzime, pavarësisht nga rezultati i kontestit, do t'i përballojë ajo palë që ka shtruar fakte të reja, respektivisht që ka propozuar fakte të reja.

Shkaqet për të cilat aktgjykimi mund të kundërshtohet

Neni 353

Aktgjykimi mund të kundërshtohet:

- 1) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore;
- 2) për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- 3) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Aktgjykimi për shkak të mungesës nuk mund të kundërshtohet për arsye të vërtetimit të gjendjes faktike në mënyrë të gabueshme apo jo të plotë.

Aktgjykimi në bazë të pohimit mund të kundërshtohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo sepse deklarata mbi pohimin është dhënë në lajthim, apo nën ndikimin e dhunës ose të mashtrimit.

Neni 354

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk ka aplikuar ose ka aplikuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundur të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

- 1) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari ose ndihmësgjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;
- 2) në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari, apo ndihmësgjyqtari, i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet (neni 71 paragrafi 1 pikat 1 deri 5), respektivisht që është përjashtuar me aktgjykimin e gjykatës;
- 3) në qoftë se është vendosur mbi kërkesën në kontest që nuk hyn në kompetencën gjyqësore (neni 16);
- 4) në qoftë se gjykata ka vendosur mbi kërkesë-padinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e të njëjtit lloj, gjykata ordinare e

llojit tjetër, respektivisht gjykata vetëqeverisëse (neni 16), apo në qoftë se me rashin e kundërshtimit të palëve në vendim që është përfshirë në aktgjykim ka vendosur në mënyrë jo të drejtë se është me kompetencë territoriale, kurse pala për këtë arsye ankohet;

5) në qoftë se, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar aktvendimin e vet në disponimin e palejueshëm të palëve (neni 3 paragrafi 3);

6) në qoftë se, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës, ose aktgjykim në bazë të pohimit;

7) në qoftë se ndonjerës nga palët, me veprim të paligjshëm e sidomos me ometim të dërgimit, nuk i është dhënë mundësia të zhvillojë shqyrtimin para gjykatës;

8) në qoftë se, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjekë procesin në gjuhën e vet, kurse pala për këtë arsye ankohet;

9) në qoftë se gjykata e ka nxjerrë aktgjykimin pa shqyrtim kryesor, kurse e ka pasur për detyrë të zhvillojë shqyrtimin kryesor;

10) në qoftë se në procedurë si paditës, ose si i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën, që është person juridik, nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi kontestimore nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht autorizuesi i palës nuk ka pasur prokurë të nevojshme për zhvillimin e kontestimit, apo për veprime të veçanta në procedurë, në qoftë se zhvillimi i kontestimit, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;

11) në qoftë se është vendosur mbi kërkesën rrathë së cilës vazhdon kontestimi, apo rreth së cilës është nxjerrë më parë aktgjykim i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi një herë ka hequr dorë, ose mbi të cilin është përfunduar pajtimi gjyqësor;

12) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

13) në qoftë se aktgjykimin ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, apo kontradiktore me vetvetë ose me arsyet e aktgjykimit, apo në qoftë se aktgjykimin nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar arsyet mbi faktet vendimtare, ose këto arsye janë të paqarta ose kontradiktore, apo në qoftë se mbi faktet vendimtare ekzistojnë kontradikta midis asaj që në arsyet e aktgjykimit të theksohet rreth përmbajtjes së dokumenteve ose të procesverbalit mbi thëniet e bëra në procedurë dhe të vetë këtyre dokumenteve apo të procesverbalit.

Neni 355

Gjendja faktike e vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë ekziston kur gjykata ndonjë fakt vendimtar e ka vërtetuar gabimisht, respektivisht kur nuk e ka vërtetuar.

Gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë jo të plotë ekziston edhe kur për këtë gjë theksohen fakte të reja ose prova të reja.

Neni 356

Aplikimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka aplikuar dispozitën e së drejtës materiale, që është dashur ta aplikonte, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka aplikuar në mënyrë të drejtë.

Procedura në bazë të ankimit

Neni 357

Ankimi i paraqitet gjykatës që e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë në një numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën kundërshtare.

Neni 358

Ankimin e paraqitur jo në kohën e duhur, jo të plotë (neni 357 paragrafi 1) ose ankimin e palejueshëm do ta hedhë poshtë me aktvendim kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë pa mbajtjen e seancës.

Ankimi është jo në kohën e duhur në qoftë se është bërë pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e tij.

Ankimi është i palejueshëm në qoftë se ankimin e ka bërë personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e ankimit, ose personi që ka hequr dorë ose është tërhequr nga ankimi, ose në qoftë se personi që ka bërë ankimin nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankimit.

Ankimi kundër aktgjykimit në bazë të pohimit (neni 331) dhe kundër aktgjykimit për shkak të mungesës (neni 332) është i palejueshëm edhe kur është bërë për shkaqe për të cilat sipas ligjit nuk mund të bëhet (neni 353 paragrafet 2 dhe 3).

Kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë nuk mund ta hedhë poshtë ankimin për arsye se është bërë nga shkaqet për të cilat sipas ligjit nuk mund të bëhet.

Neni 359

Kopjen e ankimit të bërë në kohën e duhur, të plotë e të lejueshëm gjykata e shkallës së parë do t'ia dërgojë palës kundërshtare e cila, brenda tetë ditësh nga data e marrjes në dorëzim, mund t'i japë kësaj gjykate përgjigje në ankim.

Kopjen e përgjigjes në ankim do t'ia dërgojë gjykata e shkallës së parë ankuesit.

Përgjigja në ankim, e paraqitur jo në kohën e duhur, nuk do të hidhet poshtë, por do t'i dërgohet gjykatës të shkallës së dytë, e cila do ta marrë parasysh, po qe se kjo ka mundësi gjithnjë.

Neni 360

Pas marrjes së përgjigjes në ankim, ose pasi të ketë kaluar afati për përgjigjen në ankim, kryetari i kolegjit do t'ia dërgojë ankimin dhe përgjigjen në ankim, po qe se është bërë, së bashku me shkresat, gjykatës të shkallës së dytë.

Në qoftë se ankuesi pohon se në procedurën e shkallës së parë janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, kryetari i kolegjit të gjykatës së shkallës së parë do ta japë spjegimin me rastin e thënieve të ankimit që kanë të bëjnë me këto shkelje e, sipas nevojë, do t'ia zbatojë edhe gjyrmime për të verifikuar vërtetësinë e thënieve respektive në ankim.

Neni 361

Kur shkresat në bazë të ankimit i vijnë gjykatës të shkallës së dytë, kryetari i kolegjit ankimor cakton gjyqtarin raportues.

Gjyqtari raportues mundet, sipas nevojë, prej gjykatës të shkallës së parë të marrë raportin mbi shkeljet e dispozitave të procedurës dhe të kërkojë, për vërtetimin e këtyre shkeljeve, zbatimin e gjurmimeve.

Neni 362

Gjykata e shkallës së dytë vendos mbi ankimin, si rregull, pa zhvillimin e shqyrtimit.

Kur kolegji i gjykatës të shkallës së dytë konstaton se, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, nevojitet që para gjykatës të shkallës së dytë të paraqiten përsëri provat, do të konvokojë seancën para gjykatës të shkallës së dytë.

Neni 363

Në shqyrtim thirren palët, respektivisht përfaqësuesit ose autorizuesit e tyre ligjorë, si dhe ata dëshmitarë dhe ekspertë, për të cilët gjykata vendos që të dëgjojnë.

Në qoftë se në seancë mungon një apo të dy palët gjykata do të zhvillojë shqyrtimin rreth ankimit dhe do të marrë vendim, duke marrë parasysh sidomos

ate që është shtruar në ankim dhe në përgjegje të ankimit.

Shqyrtimi para gjykatës të shkallës së dytë fillon me raportin e raportuesit, i cili paraqet gjendjen e çështjes duke mos dhënë mendimin e vet rreth bazueshmërisë së ankimit.

Pas kësaj do të lexohet aktgjykimi, ose pjesa e aktgjykimit, me të cilin ka të bëjë ankimi, e sipas nevojë, edhe procesverbali mbi seancën kryesore para gjykatës të shkallës së parë. Pastaj ankuesi do ta arsyetojë ankimin e vet, kurse pala kundërshtare përgjigjen në ankim.

Pala mund të paraqes në seancë fakte dhe të propozojë prova që nuk i ka paraqitur, respektivisht që nuk i ka propozuar në ankim, por nuk mund të theksojë kundërshtimin për kompensim që nuk është theksuar para gjykatës të shkallës së parë.

Neni 364

Në qoftë se në nenet 362 dhe 363 të këtij ligji nuk është caktuar dishka tjetër, dispozitat mbi seancën kryesore para gjykatës të shkallës së parë (nenet 294 deri 320) vihen përshtatshëmrisht në zbatim edhe ndaj shqyrtimit para gjykatës të shkallës së dytë.

Kufijt e ekzaminimeve të aktgjykimit të shkallës së parë

Neni 365

Gjykata e shkallës së dytë ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën kundërshtohet me ankim, e në qoftë se nga ankimi nuk shihet se në cilën pjesë kundërshtohet aktgjykimi, gjykata e shkallës së dytë do ta marrë sikundër aktgjykimi kundërshtohet në pjesën në të cilën pala nuk ka pasur sukses në kontest.

Gjykata e shkallës së dytë ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të arsyeve të treguara në ankim, duke pasur kujdes kryesisht për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 2 të këtij ligji dhe për aplikimin e drejtë të drejtës materiale.

Për kapërcimin e kërkesë-padisë gjykata e shkallës së dytë kujdeset vetëm me kërkesën e palës.

Vendimet e gjykatës të shkallës së dytë mbi ankimin

Neni 366

Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit ose në bazë të shqyrtimit të mbajtur mund ta hedhë poshtë ankimin si jo të kohshëm, jo të plotë apo si të palejueshëm, ta refuzojë ankimin si të pabazuar dhe të lejë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë, ta prish këtë aktgjykim dhe t'ia drejtojë objektin gjykatës të shkallës së parë për rigjykim, ta prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta hedhë poshtë padinë, ose ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë mund ta prish aktgjykimin edhe kur pala kërkon ndryshimin e tij, por mund ta ndryshojë aktgjykimin megjithëse pala kërkon që ai të priset.

Neni 367

Ankimin jo të kohshëm, jo të plotë, ose të palejueshëm do ta hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, në qoftë se këtë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë (neni 358).

Neni 368

Gjykata e shkallës së dytë do ta refuzojë me aktgjykim ankimin si të pabazuar dhe do ta lejë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë kur konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat aktgjykimi kundërshtohet, si dhe arsyet për të cilat kujdeset kryesisht.

Neni 369

Gjykata e shkallës së dytë do ta prishë me aktvendim aktgjykimin e shkallës së parë në qoftë se vër-

teton se ekziston shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore (neni 354) dhe objektin do t'ia kthejë të njejtës gjykatë të shkallës së parë, ose do t'ia cedojë gjykatës kompetente të shkallës së parë për mbajtjen e seancës kryesore të re. Në këtë aktvendim gjykata e shkallës së dytë do të vendos edhe se cilat veprime të zbatuara, të përfshira nga shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore, prishen.

Në qoftë se në procedurë para gjykatës të shkallës së parë janë bërë shkelje të dispozitave nga neni 354 paragrafi 2 pikat 3 dhe 11 të këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë do ta prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Në qoftë se në procedurë para gjykatës të shkallës së parë është bërë shkelja e dispozitave nga neni 354 paragrafi 2 pika 10 e këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë, duke marrë parasysh karakterin e shkeljes, do ta prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe do t'ia kthejë objektin gjykatës kompetente të shkallës së parë, ose do ta prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Neni 370

Gjykata e shkallës së dytë do ta prishë me aktvendim aktgjykimin e gjykatës të shkallës së parë dhe do t'ia kthejë objektin kësaj gjykate për rigjykim në qoftë se konsideron se, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, duhet të mbahet seanca kryesore e re para gjykatës të shkallës së parë, përveç në qoftë se ka vendosur që seancën ta mbajë vetë.

Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së dytë do të veprojë edhe kur pala nuk e ka kundërshtuar aktgjykimin për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë, në qoftë se me rastin e vendosjes mbi ankimin shfaqet dyshimi i bazuar se faktet në të cilat është bazuar aktgjykimi i shkallës së parë janë vërtetuar në mënyrë të drejtë.

Në qoftë se gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit ose në shqyrtim konstaton se, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, duhet vërtetuar fakte të reja dhe të paraqiten prova të reja, do ta prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe objektin do t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Neni 371

Kur gjykata e shkallës së dytë e prish aktgjykimin e gjykatës të shkallës së parë dhe objektin ia kthen të njejtës gjykatë për rigjykim, mund të urdhërojë që seanca kryesore e re të mbahet para kolegjit tjetër.

Neni 372

Në qoftë se vërtetohet se me aktgjykimin e shkallës së parë është kapërcyer kërkesë-padia, gjykata e shkallës së dytë, sipas karakterit të kapërcimit të kërkesë-padisë, do ta prishë me aktvendim aktgjykimin e shkallës së parë dhe objektin do t'ia kthejë për rigjykim kësaj gjykate, respektivisht me aktgjykim do ta ndryshojë vendimin e kundërshtuar.

Neni 373

Gjykata e shkallës së dytë do ta ndryshojë me aktgjykim aktgjykimin e shkallës së parë:

1) në qoftë se në bazë të shqyrtimit ka vërtetuar gjendjen faktike ndryshe nga ajo në aktgjykimin e shkallës së parë;

2) në qoftë se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar gabimisht dokumentet apo provat e paraqitura indirekt, kurse vendimi i gjykatës të shkallës së parë është bazuar vetëm në këto prova;

3) në qoftë se gjykata e shkallës së parë nga faktet që ka vërtetuar ka nxjerrë konkluzion të padrejtë mbi ekzistimin e fakteve të tjera, kurse në këto fakte është bazuar aktgjykimi;

4) në qoftë se konsideron se gjendja faktike në aktgjykimin e shkallës së parë është vërtetuar drejt,

por gjykata e shkallës së parë e ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale.

Neni 374

Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin në dëm të palës që është ankuar, në qoftë se vetëm ajo ka bërë ankim.

Neni 375

Në arsyetimin e aktgjykimit, respektivisht të aktvendimit gjykata e shkallës së dytë duhet t'i çmojë thëniet ankimore, që kanë rëndësi vendimtare dhe të theksojë shkaqet që i ka marrë në konsiderim kryesisht.

Kur aktgjykimi i shkallës së parë priset për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në arsyetim duhen theksuar dispozitat që janë shkelur dhe ku janë bërë shkeljet.

Në qoftë se aktgjykimi i shkallës së parë priset e objekti i kthehet gjykatës të shkallës së parë për rigjykim për të vërtetuar drejt gjendjen faktike, do të theksohet se ku qendrojnë të metat në vërtetimin e gjendjes faktike, respektivisht pse faktet dhe provat e reja kanë rëndësi dhe ndikojnë në nxjerrjen e vendimit të drejtë.

Neni 376

Gjykata e shkallës së dytë do t'ia kthejë gjykatës të gjitha shkresat e shkallës së parë me një numër të mjaftueshëm kopjesh të legalizuara të vendimit të vet për t'ua dërguar palëve dhe personave të tjerë të interesuar.

Neni 377

Gjykata e shkallës së parë ka për detyrë të zhvillojë të gjitha veprimet kontestimore dhe të shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese, në të cilat ka theksuar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e vet.

Në seancën kryesore të re palët mund të paraqesin fakte të reja e të propozojnë prova të reja.

Në qoftë se aktgjykimi priset për shkak se aktvendimin e ka nxjerrë gjykata inkompetente, shqyrtimi i ri para gjykatës të shkallës së parë do të mbahet sipas dispozitave që vlejnë për mbajtjen e seancës kryesore në rast ndryshimi të kolegjit (neni 315 paragrafi 3).

2. Ankimi kundër aktvendimit

Neni 378

Kundër aktvendimit të gjykatës të shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është caktuar që ankimi nuk lejohet.

Po qe se ky ligj cakton shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i gjykatës të shkallës së parë mund të kundërshtohet vetëm në ankimin kundër vendimit definitiv.

Neni 379

Ankimi i paraqitur në kohë pezullon ekzekutimin e aktvendimit, në qoftë se me këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe.

Aktvendimi kundër të cilit nuk lejohet ankimi i veçantë mund të ekzekutohet menjëherë.

Neni 380

Duke vendosur mbi ankimin, gjykata e shkallës së dytë mundet:

1) ta hedhë poshtë ankimin si jo të kohshëm, jo të plotë, ose të palejueshëm (neni 358 paragrafet 1 deri 3 dhe neni 378 paragrafi 1);

2) ta refuzojë ankimin si të pabazuar dhe ta lejojë fuqi aktvendimin e gjykatës të shkallës së parë;

3) ta aprovtojë ankimin dhe aktvendimin ta ndryshojë ose ta prishë, e sipas nevojë, objektin ta kthejë për procedim të përsëritur.

Neni 381

Në procedurën në bazë të ankimit kundër aktvendimit përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e vlefshme për ankim kundër aktgjykimit, përveç dispozitave mbi përgjigjen në ankimin dhe mbi mbajtjen e shqyrtimit para gjykatës të shkallës së dytë.

Kreu i njëzetegjashtë

MJETET JURIDIKE TË JASHTËZAKONSHME

1. Revizioni

Neni 382

Kundër aktgjykimit të formës së prerë, të nxjerrë në shkallë të dytë, palët mund të bëjnë revizion brenda 30 ditësh nga data e skadimit të kopjes së aktgjykimit.

Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit, ose me kryerjen e ndonjë veprimi tjetër, në qoftë se vlera e objektit të kontestit të pjesës së kundërshtuar të aktgjykimit të formës së prerë nuk kapërcen 5.000 dinarë.

Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesë-padia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi tjetër, në qoftë se vlera e objektit të kontestit, të cilën paditësi e ka theksuar në padi, nuk kapërcen 5.000 dinarë.

Përfshimisht, edhe kur është fjala për kërkesë-padinë nga paragrafet 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni është kundërherë i lejueshëm:

- 1) në kontestet mbi ushqimin;
- 2) në kontestet nga marrëdhëniet e punës;
- 3) në kontestet nga drejta e autorit;
- 4) në kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përdorimin e shpikjeve e të përparimeve teknike, të mostrave, të modeleve e të damkave dhe të së drejtës së përdorimit të firmës ose të emrit, si dhe në kontestet nga gara jolojale;

5) në kontestet pasurore, duke përfshirë edhe kontestet mbi shpërbëimin e dëmit, që lindin nga punët juridike kundërkushtetuese dhe kundërligjore dhe nga veprimet me të cilat organizata e punës së bashkuar ose punonjësit në territorin e republikave të tjera, respektivisht të krahinave autonome të tjera, e si rrjedhim edhe republikat e tjera respektivisht krahasat autonome të tjera vihen në një pozitë të pabarabartë në tregun unik jugosllav.

Neni 383

Mbi revizionin vendos gjykata supreme në republikë, respektivisht në krahinë autonome.

Neni 384

Revizioni i paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë, kundër të cilit është deklaruar.

Neni 385

Revizioni mund të deklarohet:

1) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 2 të këtij ligji, përveç në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale (neni 354 paragrafi 2 pika 4), në qoftë se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, ndërsa e ka pasur për detyrë ta mbajë seancën kryesore (neni 354 paragrafi 2 pika 9), në qoftë se është vendosur mbi kërkesën rreth së cilës kontestimi është në vazhdim (neni 354 paragrafi 2 pika 11), apo në qoftë se është përfshirë publiku në kundërshtim me ligjin në seancën kryesore (neni 354 paragrafi 2 pika 12);

2) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 1 të këtij ligji që është bërë në procedurën para gjykatës të shkallës së dytë;

3) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë revizionit mund të deklarohet vetëm në qoftë se kjo shkellje është bërë vetëm në procedurën para gjykatës të shkallës së dytë.

Revizioni nuk mund të deklarohet për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë.

Kundër aktgjyqimit të nxjerrë në shkallë të dytë, me të cilin vihet në fuqi aktgjyqimi në bazë të pohimit, revizioni nuk mund të deklarohet vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 1 pikat 1 dhe 2 dhe në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 386

Gjykata e revizionit bën ekzaminimin e aktgjyqimit të kundërshtuar vetëm në atë pjesë në të cilën ai kundërshtohet me revizion dhe në kuadrin e arsyeve të theksuara në revizion, duke pasur kujdes kryesisht për shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 2 pika 10 të këtij ligji dhe për aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Neni 387

Palët mund të shtrojnë në revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm në qoftë se ato kanë të bëjnë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të të cilave mund të deklarohet revizioni.

Neni 388

Revizioni i paraqitet gjykatës që e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën, palën kundërshtare dhe prokurorin publik kompetent për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 403).

Neni 389

Revizionin jo të kohshëm, jo të plotë, apo të palejueshëm do ta hedhë poshtë me aktvendim kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë, pa mbajtur seancën.

Revizioni është i palejueshëm në qoftë se e ka deklaruar personi që nuk është i autorizuar për të parashtruar revizion, ose personi që ka hequr dorë nga revizioni, apo në qoftë se personi që ka deklaruar revizion nuk ka interes juridik për të parashtruar revizion, apo në qoftë se revizioni është deklaruar kundër aktgjyqimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të parashtrohet.

Neni 390

Kopja e revizionit të kohshëm të plotë e të lejueshëm do t'i dërgohet nga kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë palës kundërshtare dhe prokurorit publik kompetent për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 403).

Prokurorit publik nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i dërgohet, së bashku me revizion, edhe kopja e aktgjyqimit kundër të cilit është deklaruar revizioni.

Në afatin prej 30 ditësh nga data e dërgimit të revizionit pala kundërshtare mund t'i paraqes gjykatës përgjigjen në revizion, kurse prokurori publik kompetent mund të deklarohet mbi revizionin e parashtruar.

Pas marrjes së përgjigjes, respektivisht të deklarimit mbi revizionin, ose pas kalimit të afatit për përgjigje, respektivisht për deklarim, kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë do ta dërgojë revizionin dhe do të përgjigjet në revizion, respektivisht deklarimin mbi revizionin, po qe se i janë paraqitur, me të gjitha shkresat, gjykatës së revizionit me anë të gjykatës të shkallës së dytë.

Neni 391

Mbi revizionin gjykata e revizionit vendos pa shqyrtim.

Neni 392

Revizionin jo të kohshëm, jo të plotë dhe të palejueshëm do ta hedhë poshtë gjykata e revizionit me aktvendim në qoftë se këtë gjë, brenda kufijve të autorizimeve të veta (neni 389), nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë.

Neni 393

Gjykata e revizionit do ta refuzojë me aktgjykim revizionin si të papabazuar në qoftë se vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është deklaruar revizioni, si dhe arsyet për të cilat kujdeset kryesisht.

Neni 394

Në qoftë se vërteton se ekziston shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, për shkak të së cilës mund të deklarohet revizioni, përveç shkeljeve të theksuara në paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, gjykata e revizionit do ta prishë me aktvendim tërësisht apo pjesërisht aktgjykimin e gjykatës të shkallës së dytë dhe të gjykatës të shkallës së parë, ose vetëm aktgjykimin e gjykatës të shkallës së dytë dhe objektin do ta kthejë për rigjykim të njejtit apo tjetrit kolegji të gjykatës të shkallës së parë apo gjykatës së shkallës së dytë, respektivisht gjykatës tjetër kompetente.

Në qoftë se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, apo gjykatës së shkallës së dytë është bërë shkelja e parashikuar në nenin 354 paragrafi 2 pikat 3 dhe 11 të këtij ligji, përveç në qoftë se është vendosur mbi kërkesën rreth së cilës është në vazhdim kontestimi, gjykata e revizionit do t'i prishë me aktvendim vendimet e nxjerra dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Në qoftë se në procedurën para gjykatës të shkallës së parë apo gjykatës të shkallës së dytë është bërë shkelja e parashikuar në nenin 354 paragrafi 2 pika 10 të këtij ligji, gjykata e revizionit, duke marrë parasysh karakterin e shkeljes, do të veprojë sipas dispozitës së paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 395

Në qoftë se gjykata e revizionit vërteton se e drejta materiale është aplikuar gabimisht, do ta aprovojë në aktgjykim revizionin dhe do ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar.

Po qe se gjykata e revizionit konstaton se për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe se për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjyqimit të kundërshtuar, me aktvendim do ta aprovojë revizionin, do ta prish tërësisht apo pjesërisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë ose vetëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe objektin do t'ia kthejë për rigjykim kolegjit të njejtë apo kolegjit tjetër të gjykatës të shkallës së parë respektivisht të gjykatës të shkallës së dytë.

Neni 396

Në qoftë se vërteton se me aktgjykim të formës së prerë, të nxjerrë në shkallë të dytë, është kapërcyer kërkesë-padia, gjykata e revizionit, sipas karakterit të kapërcimit të kërkesë-padisë, do ta prish me aktvendim aktgjykimin e gjykatës të shkallës së dytë dhe objektin do t'ia kthejë për rigjykim gjykatës të shkallës së dytë, respektivisht me aktgjykim do ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar.

Neni 397

Në qoftë se me rastin e vendosjes mbi revizionin e deklaruar në kontestim nga neni 382 paragrafi 4 pika 5 të këtij ligji dyshohet në mënyrë të bazuar se faktet në të cilat është bazuar vendimi i kundërshtuar janë vërtetuar drejt, gjykata e revizionit do ta prishë me aktvendim vendimin e kundërshtuar, e sipas nevojë edhe vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulta, kurse objektin do t'ia kthejë të njejtit kolegji ose

kolegjit tjetër të gjykatës të shkallës së parë apo të gjykatës të shkallës së dytë, respektivisht gjykatës tjetër kompetente.

Neni 398

Vendimi i gjykatës së revizionit i dërgohet gjykatës së shkallës së parë me anë të gjykatës së shkallës së dytë.

Kopja e vendimit të gjykatës së revizionit i dërgohet prokurorit publik kompetent (neni 403).

Neni 399

Në qoftë se në nenet 382 deri 398 të këtij ligji nuk është caktuar dishka tjetër në procedurën me rastin e revizionit përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e këtij ligji mbi ankimin kundër aktgjykimit nga neni 349 paragrafi 2 dhe 3, nenet 350, 351 dhe 356, neni 358 paragrafi 5, neni 359 paragrafi 2 dhe 3, neni 360 paragrafi 2, nenet 361, 366, 371 dhe nenet 374 deri 377 të këtij ligji.

Neni 400

Palët mund të deklarojnë revizion edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin procedura ka përfunduar në formë të prerë.

Revizioni kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet në kontestimet, në të cilat nuk do të ishte i lejueshëm revizioni kundër aktgjykimit të formës së prerë (neni 382 paragrafi 2 dhe 3).

Revizioni është i kurdohërë i lejueshëm kundër aktvendimit të gjykatës të shkallës së dytë, me të cilin hidhet poshtë ankimi i bërë, respektivisht me të cilën lihet në fuqi aktvendimi i gjykatës të shkallës së parë mbi hedhjen poshtë të revizionit.

Në procedurën me rastin e revizionit kundër aktvendimit përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e këtij ligji mbi revizionin kundër aktgjykimit.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Neni 401

Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh.

Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nga paragrafi 1 i këtij neni llogaritet:

1) kundër vendimit të marrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është bërë ankimi — prej ditës kur ky vendim nuk ka mundur më të kundërshtohet me ankim;

2) kundër vendimit të marrë në shkallë të dytë, kundër të cilit nuk është deklaruar revizioni — prej ditës kur ky vendim i është dërguar asaj pale që i është dërguar më së vonë.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, të nxjerrë në shkallë të dytë, kundër të cilit palët kanë deklaruar revizion, prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm brenda 30 ditësh nga data kur i është dërguar revizioni i asaj pale, revizioni i së cilës i është dërguar më heret (neni 390 paragrafi 1).

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet kundër vendimit, të cilin, me rastin e revizionit ose të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ka marrë gjykata me kompetencë për të vendosur mbi këto mjete juridike (neni 383).

Neni 402

Mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos gjykata nga neni 383 i këtij ligji.

Neni 403

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 401 i këtij ligji ngritet nga prokurori publik, i caktuar me ligjin republikan, respektivisht krahinor.

Neni 404

Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

1) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, përveç në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale (neni 354 paragrafi 2 pika 4), po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore (neni 354 paragrafi 2 pika 9), po qe se është vendosur mbi kërkesën rreth së cilës kontestimi është në vazhdim (neni 354 paragrafi 2 pika 11), apo në qoftë se, në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore (neni 354 paragrafi 2 pika 12);

2) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Prokurori publik nuk mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Neni 405

Sipas dispozitës së nenit 394 paragrafi 1 të këtij ligji gjykata me kompetencë për të vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë do të veprojë edhe kur vërteton se ekziston shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 1 të këtij ligji, që është bërë në procedurën para gjykatës të shkallës së parë.

Neni 406

Në qoftë se kundër të njejtit vendim janë paraqitur si revizioni ashtu edhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata e parashikuar në nenin 383 të këtij ligji do të vendos mbi mjetet juridike me një vendim.

Neni 407

Mbi seancën në të cilën gjykata do të vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë do të njoftohet prokurori publik kompetent (neni 403).

Neni 408

Kur vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në ekzaminimin e shkeljeve që i thekson prokurori publik në kërkesën e vet.

Në qoftë se në nenet 401 deri 407 të këtij ligji nuk është caktuar dishka tjetër, në procedurën me rastin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e nenit 384, të neneve 387 deri 395, si dhe të neneve 397 deri 399 të këtij ligji.

3. Kërkesa e prokurorit publik federativ për mbrojtjen e ligjshmërisë

Neni 409

Prokurori publik federativ mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë, me të cilin është shkelur ligji federativ ose traktati ndërkombëtar.

Prokurori publik federativ mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm pasi kundër vendimit të kundërshtuar ka shfrytëzuar mundësinë e ushtrimit të ankimit, të revizionit e të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë para gjykatave të republikës, respektivisht të krahinës autonome, respektivisht pasi ushtrimi i këtyre mjeteve juridike nuk ka qenë më i mundur.

Prokurori publik federativ nuk mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Federative, të nxjerrë me rastin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ose me rastin e kërkesës për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë para Gjykatës Federative.

Neni 410

Prokurori publik federativ mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm për shkaqe për të cilat kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të ngritet nga prokurori publik në republikë, respektivisht në krahinën autonome (neni 404).

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ngritet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (neni 354) në objektet në të cilat vendimi mbi bazueshmërinë e kërkesë-padisë bazohet vetëm në aplikimin e ligjit republikan, respektivisht të ligjit krahinor.

Neni 411

Mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të prokurorit publik federativ vendos Gjykata Federative.

Neni 412

Prokurori publik federativ mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh. Afati nga paragrafi 1 i këtij neni llogaritet:

1) në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë nuk është deklaruar revizioni dhe as që është ngritur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji — nga skadimi i afatit për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të prokurorit publik kompetent në republikë, respektivisht në krahinën autonome (neni 401);

2) në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë është deklaruar revizioni, ose është ngritur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji — prej ditës kur është bërë dërgimi i fundit i vendimit të marrë me rastin e këtyre mjeteve juridike të palëve dhe prokurorit publik kompetent në republikë, respektivisht në krahinën autonome (neni 403).

Prokurori publik Federativ nuk mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë para skadimit të afatit për deklarimin e revizionit, respektivisht ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji, e në qoftë se këto mjete juridike do të paraqiten, nuk mund ta ngrejë kërkesën para se gjykata kompetente të ketë marrë vendim mbi to.

Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 3 të këtij neni, në qoftë se prokurori publik kompetent në republikë, respektivisht në krahinë autonome deklaroi se nuk do ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, prokurori publik federativ mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pasi të kenë kaluar afatet në të cilat revizionin kanë mundur ta ushtrojnë palët, e në qoftë se revizioni nuk lejohet, kërkesën mund ta ngrejë prej ditës së theksuar në nenin 401 paragrafi 2 të këtij ligji.

Në rastin nga paragrafi 4 i këtij ligji, prokurori publik federativ, bashkë me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duhet ta bashkangjës deklaraten e prokurorit publik kompetent në republikë, respektivisht në krahinën autonome se nuk do ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Federative, prokurori publik federativ mund të heqë dorë nga kërkesa e paraqitur.

Neni 413

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë i paraqitet direkt Gjykatës Federative, në një numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse.

Kopja e kërkesës do t'u dërgohet nga Gjykata Federative palëve ndërgjyqëse, të cilat, brenda 15 ditësh nga data e dërgimit, mund të deklarohen mbi kërkesën.

Neni 414

Në qoftë se vendimi i formës së prerë do të prishet dhe objekti do të kthehet për rigjykim, gjykata ka për detyrë të paraqes të gjitha veprimet kontestimore dhe t'i shpërtojë të gjitha çështjet në të cilat ia ka theksuar Gjykata Federative.

Në procedurën e re para gjykatës të shkallës së parë dhe gjykatës të shkallës së dytë palët mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja.

Në qoftë se përpos vendimit të gjykatës më të ultë është prishur edhe vendimi i gjykatës më të lartë, objekti i dërgohet gjykatës më të ultë me anë të gjykatës më të lartë.

Neni 415

Në qoftë se në nenet 409 deri 414 të këtij ligji nuk është caktuar ndryshe, në procedurën me rastin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të prokurorit publik federativ, përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e nenit 384, të neneve 387 deri 395, të neneve 397 deri 399, të neneve 405, 407 dhe 408 paragrafi 1 të këtij ligji.

4. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm para Gjykatës Federative të vendimit të formës së prerë

Neni 416

Në kontestimin nga neni 34 pika 2 të këtij ligji palët mund t'ia paraqesin Gjykatës Federative kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, me të cilin revizioni ose kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga neni 401 i këtij ligji refuzohet, respektivisht aprovohet dhe vendimi i kundërshtuar ndryshohet, brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të vendimit të kundërshtuar.

Pala nuk mund ta paraqes kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë të Gjykatës Federative të nxjerrë me rastin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë apo me rastin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë.

Neni 417

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë mund të paraqitet vetëm për shkaqe për të cilat mund të deklarohet revizioni (neni 385).

Neni 418

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë i paraqitet direkt Gjykatës Federative në një numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën, palën kundërshtare dhe për prokurorin publik federativ.

Kopja e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë Gjykata Federative do t'ua dërgojë palës kundërshtare dhe prokurorit publik federativ, të cilët mund të deklarohen rreth kërkesës brenda 15 ditësh.

Neni 419

Në qoftë se kundër të njëjtit vendim prokurori publik federativ ka ngritur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe pala ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, Gjykata Federative do të vendos mbi këto mjete juridike me një vendim.

Neni 420

Në qoftë se në nenet 416 deri 419 të këtij ligji nuk është caktuar dishka tjetër, në procedurën me rastin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë para Gjykatës Federative përshtatshmërisht do të vihen në zbatim dispozitat e nenit 384, të neneve 386 deri 395 dhe të neneve 397 deri 399 të këtij ligji.

5. Përsëritja e procedurës

Neni 421

Procedura që me vendim të gjykatës ka përfunduar në formë të prerë, mund të përsëritet në bazë të propozimit të palës.

1) në qoftë se gjatë marrjes së vendimit ka marrë pjesë gjyqtari, respektivisht ndihmësgjyqtari, i cili sipas ligjit është dashur të përjashtohet (neni 71 paragrafi 1 pikat 1 deri 5), respektivisht i cili me aktvendim të gjykatës është përjashtuar;

2) në qoftë se ndonjerës nga palët, me veprim të paligjshëm e sidomos me ometimin e dërgimit, nuk i është dhënë mundësia të zhvillojë shqyrtimin para gjykatës;

3) në qoftë se në procedurë ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi kontestimore nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht autorizuesi i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedimit apo për veprime të veçanta në procedurë, po që se zhvillimi i kontestimit, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedim nuk është lejuar më vonë;

4) në qoftë se vendimi i gjykatës bazohet në thëniet të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve;

5) në qoftë se vendimi i gjykatës bazohet në dokumentin që është fallsifikuar ose ku është legalizuar përmbajtja e pasaktë;

6) në qoftë se vendimi i gjykatës është marrë për shkak të veprës penale të gjyqtarit, respektivisht të ndihmësgjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor, ose të autorizuesit të palës, të palës kundërshtare ose të ndonjë personi të tretë;

7) në qoftë se pala fiton mundësinë ta përdorë vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili më parë, midis palëve të njëjta, është nxjerrë mbi të njëjtën kërkesë;

8) në qoftë se vendimi i gjykatës bazohet në një vendim tjetër të gjykatës, ose në vendimin e ndonjë organi tjetër, kurse ky vendim ndryshohet, prishet, respektivisht anulohet në formë të prerë;

9) në qoftë se pala mëson për fakte të reja ose gjen apo fiton mundësinë të përdorë prova të reja në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendimi më i favorshëm po të ishin përdorur këto fakte apo prova në procedurën e mëparshme.

Neni 422

Për shkaqe të theksuara në nenin 421 pikat 1 deri 3 të këtij ligji nuk mund të kërkohet përsëritja e procedurës, në qoftë se ky shkak është paraqitur pa sukses në procedurën e mëparshme.

Për shkak të rrethanave të theksuara në nenin 421 pikat 1, 7, 8 dhe 9 të këtij ligji, përsëritja e procedurës mund të lejohet vetëm në qoftë se pala, pa faj të vet, nuk ka mundur t'i shtrojë këto rrethana para se të ketë marrë fund procedura e mëparshme me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 423

Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda tridhjetë ditësh, e pikërisht:

1) në rastin nga neni 421 pika 1 të këtij ligji, që nga dita kur pala të ketë mësuar për këtë shkak;

2) në rastin nga neni 421 pika 2 të këtij ligji, që nga dita kur vendimi t'i jetë dorëzuar palës;

3) në rastin nga neni 421 pika 3 të këtij ligji, në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, që nga dita kur vendimi t'i jetë dorëzuar këtij personi; në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi kontestimore nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor, që nga dita kur vendimi t'i jetë dorëzuar palës, respektivisht përfaqësuesit të saj ligjor, e në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht autorizuesi i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës

ose për veprime të veçanta në procedurë, që nga dita kur pala të ketë mësuar për këtë shkak;

4) në rastet nga neni 421 pikat 4 deri 6 të këtij ligji, që nga dita kur pala të ketë mësuar për aktgjykim të formës së prerë në procedurën penale, e në qoftë se procedura penale nuk mund të zbatohet, atëherë që nga dita kur të ketë mësuar për pezullimin e kësaj procedure ose për rrethanat për shkak të të cilave procedura nuk mund të fillohet;

5) në rastet nga neni 421 pikat 7 dhe 8 të këtij ligji, që nga dita kur pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak i përsëritjes së procedurës;

6) në rastin nga neni 421 pika 9 të këtij ligji, që nga dita kur pala ka mundur të shtrojë para gjykatës fakte të reja, respektivisht mjete të reja provuese.

Në qoftë se afati i caktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të fillonte të rrjedhte para se vendimi të ketë marrë formën e prerë, ky afat do të llogaritet që kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, në qoftë se kundër tij nuk është ushtruar mjeti juridik, respektivisht që nga dita e dërgimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës më të lartë, i cili është dhënë në shkallë të fundit.

Pasi të ketë kaluar afati prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveç në qoftë se përsëritja kërkohet për shkaqe të theksuara në nenin 421 pikat 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 424

Propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet kurdoherë gjykatës që e ka marrë vendimin në shkallë të parë.

Në propozimin duhen theksuar sidomos: baza ligjore sipas së cilës kërkohet përsëritja, rrethanat nga të cilat rezulton se propozimi është paraqitur në afatin ligjor dhe provat që argumentojnë thëniet e propozuesve.

Neni 425

Propozimet për përsëritjen e procedurës së pakohshme (neni 423), jo të plota (neni 424 paragrafi 2) ose të palejueshme (neni 423) do t'i hedhë poshtë me aktvendim kryetari i kolegjit pa mbajtjen e seancës.

Në qoftë se kryetari i kolegjit nuk e ka hedhur poshtë propozimin, do t'ia dërgojë një kopje të propozimit palës kundërshtare sipas dispozitave të nenit 142 të këtij ligji, e cila ka të drejtë që brenda pesëmbëdhjetë ditësh t'i përgjigjet propozimit. Kur gjykatës t'i vijë përgjigja në propozim, ose kur të ketë kaluar afati për dhënien e përgjigjes, kryetari i kolegjit do të caktojë afatin e shqyrtimit të propozimit.

Në qoftë se përsëritja e procedurës kërkohet për shkakun e theksuar në nenin 421 pika 9 të këtij ligji, kryetari i kolegjit mund ta bashkojë shqyrtimin e propozimit rreth përsëritjes së procedurës me shqyrtimin e çështjes kryesore.

Neni 426

Seanca për shqyrtim mbi propozimin për përsëritjen e procedurës mbahet para kryetarit të kolegjit të gjykatës të shkallës së parë, përveç në qoftë se shqyrtimi mbi propozimin nuk është bashkuar me shqyrtimin e çështjes kryesore.

Neni 427

Pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e propozimit, kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë merr vendim mbi propozimin, përveç në qoftë se shkakun për përsëritjen e procedurës ka të bëjë vetëm me procedurën para gjykatës më të lartë (neni 428).

Në aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës do të caktohet se prishet vendimi i marrë në procedurën e mëparshme.

Kryetari i kolegjit do të caktojë shqyrtimin kryesor vetëm pasi aktvendimi me të cilin lejohet përsëritja e procedurës të ketë marrë formën e prerë, por në këtë aktvendim mund të vendosë që menjëherë të fillojë shqyrtimi i çështjes kryesore. Në seancën kryesore të re palët mund të paraqesin fakte të reja dhe të shqyrtimin e çështjes kryesore.

Kundër aktvendimit, me të cilin lejohet përsëritja e procedurës, nuk lejohet ankimi i veçantë, në qoftë se kryetari i kolegjit ka vendosur të fillojë menjëherë shqyrtimin e çështjes kryesore.

Në qoftë se kryetari i kolegjit ka lejuar përsëritjen e procedurës dhe ka vendosur që menjëherë të shqyrtohet çështja kryesore, apo në qoftë se propozimi për përsëritjen e procedurës është shqyrtuar së bashku me çështjen kryesore, aktvendimi me të cilin lejohet përsëritja e procedurës dhe prishet vendimi i marrë në procedurën e mëparshme përfshihet në vendimin mbi çështjen kryesore.

Neni 420

Në qoftë se shkaku për përsëritjen e procedurës ka të bëjë vetëm me procedurën para gjykatës më të lartë, kryetari i kolegjit të gjykatës të shkallës së parë, pasi të jetë mbajtur seanca për shqyrtimin e propozimit për përsëritjen e procedurës, do t'ia dërgojë objektin kësaj gjykate më të lartë për marrjen e vendimit.

Kur objekti të ketë arritur pranë gjykatës më të lartë, kryetari i kolegjit do të veprojë sipas dispozitave të nenit 361 të këtij ligji.

Rreth propozimit për përsëritjen e procedurës gjykata më e lartë do të vendosë pa shqyrtim.

Kur gjykata më e lartë konstaton se është justifikuar propozimi për përsëritjen e procedurës dhe se nuk ka nevojë të mbahet seanca kryesore e re, do ta prish vendimin e vet, si dhe vendimin e gjykatës më të lartë, po që se ky ekziston, dhe do të marrë vendim të ri mbi çështjen kryesore.

6. Raporti midis propozimit për përsëritjen e procedurës dhe të mjeteve të tjera juridike të jashtëzakonshme

Neni 429

Në qoftë se në afatin për deklarimin e revizionit pala paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës vetëm për shkaqe për të cilat mund të deklarohet edhe revizioni, do të konsiderohet se pala ka deklaruar revizion.

Në qoftë se pala deklaron revizion për shkaqe nga neni 354 paragrafi 2 pika 11 të këtij ligji dhe njëkohësisht apo pas kësaj paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës për cilindo shkak të parashikuar në nenin 421 të këtij ligji, gjykata do ta ndërprejë procedurën me rastin e propozimit për përsëritjen e procedurës deri në mbarim të procedurës sipas revizionit.

Në qoftë se pala ushtron revizionin për cilindo shkak, përveç për shkakun e parashikuar në nenin 354 paragrafi 2 pika 11 të këtij ligji, e njëkohësisht apo pas kësaj paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës për shkaqe të parashikuara në nenin 421 pikat 4 deri 6 të këtij ligji që janë argumentuar me aktgjykim të formës së prerë të nxjerrë në procedurën penale, gjykata do ta ndërprejë procedurën në bazë të revizionit deri në mbarim të procedurës me rastin e propozimit për përsëritjen e procedurës.

Në të gjitha rastet e tjera në të cilat pala deklaron revizion dhe njëkohësisht ose pas kësaj paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës, gjykata do të vendosë se cilën procedurë do ta vazhdojë dhe cilën do ta ndërprejë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e sidomos shkaqet për të cilat të dy mjetet juridike janë paraqitur dhe provat që i kanë propozuar palët.

Neni 430

Dispozitat e nenit 429 paragrafet 1 dhe 3 të këtij ligji aplikohen edhe kur pala ka paraqitur më parë propozimin për përsëritjen e procedurës, e pas kësaj ka deklaruar revizion.

Në të gjitha rastet e tjera, në të cilat pala paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës dhe pas kësaj e deklaron revizionin gjykata, si rregull, do ta ndërprejë procedurën mbi revizionin deri në mbarim të procedurës me rastin e propozimit për përsëritjen e procedurës, përveç në qoftë se konstaton se ekzistojnë shkaqet serioze për të vepruar ndryshe.

Neni 431

Aktvendimi nga neni 429 i këtij ligji nxirret nga kryetari i kolegjit i gjykatës të shkallës së parë në qoftë se propozimi për përsëritjen e procedurës vjen në gjykatën e shkallës së parë para se objekti me rastin e revizionit t'i jetë drejtuar gjykatës së revizionit. Në qoftë se propozimi për përsëritjen e procedurës vjen pasi objekti me rastin e revizionit t'i jetë dërguar gjykatës së revizionit, aktvendimin nga neni 429 i këtij ligji e nxjerr gjykata e revizionit.

Aktvendimin nga neni 430 i këtij ligji e nxjerr kryetari i kolegjit i shkallës së parë, përveç në qoftë se objekti, në kohën kur revizioni i vjen gjykatës të shkallës së parë, me rastin e propozimit për përsëritjen e procedurës drejtuar gjykatës më të lartë për marrjen e vendimit (neni 428 paragrafi 1), në të cilin rast aktvendimin e nxjerr gjykata më e lartë.

Kundër aktvendimit të gjykatës nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni nuk lejohet ankimi.

Neni 432

Dispozitat e neneve 429 deri 431 të këtij ligji përshtatshëmrisht do të vihen në zbatim edhe kur prokurori publik kompetent në republikë, respektivisht në krahinë autonome, apo prokurori publik federativ ngrit kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, respektivisht kur pala paraqet kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, para Gjykatës Federative, kurse pala përpara, njëkohësisht ose pas kësaj e paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës.

Pjesa e tretë

VEPRIME TË POSAÇME

Kreu i njëzeteshtatë

PROCEDURA NË KONTESTIMET NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 433

Në qoftë se nuk ekzistojnë dispozita të veçanta të këtij kreu, në kontestimet nga marrëdhëniet e punës do të vihen në zbatim dispozita të tjera të këtij ligji.

Neni 434

Në procedurën në kontestimet nga marrëdhëniet e punës, e sidomos gjatë përcaktimit të afateve e të seancave, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes urgjente të kontesteve të punës.

Neni 435

Gjatë procedurës gjykata mund të caktojë edhe kryesisht masat e përkohshme që aplikohen në procedurën ekzekutive për parandalimin e veprimit të dhunshëm, apo për mënjanimin e dëmit të palkompensueshëm. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 436

Në aktgjykim, në të cilin urdhëron ekzekutimin e ndonjë veprimi, gjykata do të caktojë afatin prej tetë ditësh për ekzekutimin e tij.

Neni 437

Afati i paraqitjes së ankimit është tetë ditë.

Kreu i njëzetetetë

PROCEDURA NË KONTESTIMET PËR SHKAK TË PENGIMIT TË POSEDIMIT

Neni 438

Në qoftë se nuk ekzistojnë dispozita të veçanta të këtij kreu, në kontestimet për shkak të pengimit të posedimit do të aplikohen dispozita të tjera të këtij ligji.

Neni 439

Padia me të cilën kërkohet mbrojtja ose kthimi i gjendjes së fundit të posedimit të sendit apo të së drejtës (padia për shkak të pengimit të posedimit) duhet të paraqitet brenda tridhjetë ditësh nga data kur paditësi të ketë mësuar për pengimin dhe kryerësin. Pasi të ketë kaluar një vjet nga data kur ka lindur pengimi kjo padi nuk mund të paraqitet.

Neni 440

Kur caktohen afatet dhe seancat në bazë të padive për shkak të pengimit të posedimit, gjykata do të ketë kurdohetë kujdes për nevojën e zgjidhjes urgjente sipas karakterit të secilit rast të veçantë.

Neni 441

Shqyrtimi rreth padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në shqyrtimin dhe argumentimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të krijuar. Përjashtohet shqyrtimi mbi të drejtën e posedimit, mbi bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose mosndërgjegjshmërinë e posedimit apo mbi kërkesat për shpërblimin e dëmit.

Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata do të shqyrtojë mbi kundërshtimin e të paditurit se paditësi i ka marrë posedimin me forcë, në mënyrë të fshehtë apo me mashtrim vetëm në qoftë se nga dita kur i padituri ka mësuar se paditësi ia ka marrë posedimin deri në ditën kur e ka kthyer posedimin nuk ka kaluar më tepër se tridhjetë ditë.

Në qoftë se që nga dita kur të paditurit i është marrë posedimi ka kaluar më tepër se një vjet ky kundërshtim nuk mund të merret në shqyrtim.

Neni 442

Gjatë procedurës gjykata mundet kryesisht dhe pa dëgjimin e palës kundërshtarë të caktojë masat e përkohshme që aplikohen në procedurën e ekzekutimit për mënjanimin e rrezikut urgjent të dëmtimit të kundërligjshëm ose për parandalimin e dhunës apo për mënjanimin e dëmit të pakompensueshëm. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi i veçantë.

Neni 443

Aktvendimi me të cilin rregullohet gjendja faktike e posedimit nuk ndalon realizimin e mëvonshëm të së drejtës së posedimit dhe të kërkesave që varen nga kjo e drejtë.

Afati për përmbushjen e detyrave që u janë urdhëruar palëve do të caktohet nga gjykata sipas rrethanave të rastit të veçantë.

Afati i paraqitjes së ankimit është tetë ditë.

Për shkaqe të rëndësishme gjykata mund të vendos që ankimi të mos e pezullojë ekzekutimin e aktvendimit.

Kundër aktvendimeve të nxjerra në kontestime për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk lejohet.

Neni 444

Paditësi humb të drejtën që në procedurën ekzekutive të kërkojë ekzekutimin e aktvendimit në të

cilin të paditurit në bazë të padisë për shkak të pengimit të posedimit i urdhërohet kryerja e veprimi të caktuar, në qoftë se nuk ka kërkuar ekzekutimin brenda 30 ditësh pas kalimit të afatit që është caktuar me aktvendim për ekzekutimin e këtij veprimi.

Neni 445

Përsëritja e procedurës së përfunduar në formë të prerë për shkak të pengimit të posedimit lejohet vetëm për shkaqe të parashikuara në nenin 421 pikat 2 dhe 3 të këtij ligji, e pikërisht vetëm në afatin prej 30 ditësh nga data kur aktvendimi mbi pengimin e posedimit të ketë marrë formën e prerë.

Kreu i njëzetetë

LËSHIMI I URDHËRPAGESËS

Neni 446

Kur kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesë në të holla të rrjedha për pagesë, kurse kjo kërkesë provohet me dokument autentik, që i bashkëngjitet padisë në origjinal ose në kopjen e legalizuar, gjykata do t'i lëshojë të paditurit një urdhër për përmbushjen e kërkesë-padisë (urdhërpagesë).

Si dokumente autentike konsiderohen sidomos:

- 1) dokumentet zyrtare;
- 2) dokumentet private, ku nënshkrimin e obliguesit e ka legalizuar organi kompetent për legalizime;
- 3) kambialet dhe çeket me protest dhe me llogari rikthyese, në qoftë se ato nevojiten për themelimin e kërkesës;

- 4) ekstraktet nga regjistrat e legalizuara të punës;
- 5) faturat;
- 6) dokumentet që sipas dispozitave të veçanta kanë rëndësinë e dokumenteve zyrtare.

Urdhërpagesën do ta lëshojë gjykata megjithëse paditësi në padinë nuk ka propozuar lëshimin e urdhërpagesës, kurse janë plotësuar të gjitha kushtet për lëshimin e urdhërpagesës.

Neni 447

Kur kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesë në të holla të rrjedha për pagesë që nuk e kapërcejnë shumën prej 500 dinarësh, gjykata do të lëshojë urdhërpagesën kundër të paditurit megjithëse në padinë nuk janë bashkëngjitur dokumentet autentike, po që se në padinë është parashtruar baza dhe shuma e detyrimeve dhe janë theksuar provat në bazë të të cilave mund të vërtetohet saktësia e thënieve të padisë.

Urdhërpagesa nga paragrafi 1 i këtij neni mund të lëshohet vetëm kundër debitorit kryesor.

Neni 448

Urdhërpagesën e lëshon kryetari i kolegjit, pa mbajtur seancën.

Në urdhërpagesë gjykata do të caktojë se i padituri ka për detyrë që brenda tetë ditësh, kurse në kontestet e kambialeve dhe të çekeve brenda tre ditësh, pas marrjes së urdhërpagesës ta plotësojë kërkesën e padisë bashkë me shpenzimet që i ka caktuar gjykata, ose në të njëjtin afat të ngrejë prapësimin kundër urdhërpagesës. Në urdhërpagesë gjykata do ta paralajmërojë të paditurin se do t'i hedhë poshtë kundërshtimet që nuk janë bërë në kohën e duhur.

Urdhërpagesa u dërgohet të dy palëve.

Të paditurit i dërgohet së bashku me urdhërpagesë edhe kopja e padisë me anekse.

Neni 449

Në qoftë se gjykata nuk e aprovon propozimin për lëshimin e urdhërpagesës, do të vazhdojë procedurën në bazë të padisë.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin aprovet propozimi për lëshimin e urdhërpagesës nuk lejohet ankimi.

Neni 450

Urdhërpagesën i padituri mund ta kundërshtojë vetëm me prapësim. Në qoftë se urdhërpagesa kundërshtohet vetëm në pikëpamje të vendimit mbi shpenzimet, ky vendim mund të kundërshtohet vetëm me ankim kundër aktvendimit.

Në pjesën në të cilën nuk është kundërshtuar me prapësim, urdhërpagesa bëhet e plotëfuqishme.

Neni 451

Kundërshtimet e bëra jo në kohën e duhur, jo të plota dhe të palejueshme do t'i hedhë poshtë kryetari i kolegjit pa mbajtur seancën.

Në qoftë se kundërshtimet janë bërë në kohën e duhur, kryetari i kolegjit do të vlerësojë nëse nevojitet ta konvokojë seancën përgatitore apo të caktojë menjëherë seancën për seancën kryesore.

Gjatë seancës përgatitore dhe seancës kryesore palët mund të parashtojnë fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja, kurse i padituri mund të theksojë edhe kundërshtime të reja në pikëpamje të pjesës së kundërshtuar të urdhërpagesës.

Në vendimin mbi çështjen kryesore gjykata do të vendos nëse urdhërpagesa mbahet në fuqi tërësisht apo pjesërisht ose prishet.

Neni 452

Në qoftë se i padituri kundërshton duke theksuar se nuk kanë ekzistuar bazat ligjore për lëshimin e urdhërpagesës (nenet 446 dhe 447), apo se ekzistojnë pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës, gjykata do të vendos më parë mbi këtë kundërshtim. Në qoftë se konstaton se kundërshtimi i tillë është i bazuar, do ta prishë me aktvendim urdhërpagesën dhe pasi aktvendimi të ketë marrë formën e prerë do të fillojë shqyrtimin mbi çështjen kryesore, kur është me vend një shqyrtim i tillë.

Në qoftë se gjykata nuk e aprovon këtë kundërshtim, do të kalojë në shqyrtimin e çështjes kryesore, kurse aktvendimin e gjykatës do ta përfshijë në vendimin mbi çështjen kryesore.

Në qoftë se me rastin e prapësimit të mosarritjes për pagesë gjykata konstaton se kërkesa e padisë ka ardhur për pagesë pas lëshimit të urdhërpagesës, por para përfundimit të seancës kryesore, gjykata do ta prishë me aktgjykim urdhërpagesën dhe do të vendos mbi kërkesë-padinë (neni 326 paragrafi 1).

Neni 453

Gjykata mund të shpallet kryesisht inkompetente nga ana territoriale jo më vonë se deri në lëshimin e urdhërpagesës.

I padituri mund të bëjë prapësimin e inkompetencës territoriale vetëm në kundërshtimin e bërë kundër urdhërpagesës.

Neni 454

Në qoftë se gjykata pas lëshimit të urdhërpagesës shpallet inkompetente nga ana lëndore, do ta prishë urdhërpagesën dhe pasi aktvendimi mbi inkompetencën të ketë marrë formën e prerë do t'ia cetojë objektin gjykatës kompetente.

Në qoftë se gjykata pas lëshimit të urdhërpagesës vërteton se është inkompetente nga ana territoriale, nuk do ta prishë urdhërpagesën, por pasi aktvendimi të ketë marrë formën e prerë, me të cilin është shpallur inkompetente, do t'ia cetojë objektin gjykatës kompetente.

Neni 455

Kur gjykata në rastet e parashikuara me këtë ligj nxjerr aktvendimin me të cilin hidhet poshtë padia, do ta prishë edhe urdhërpagesën.

Neni 456

Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit vetëm deri në paraqitjen e kundërshtimit.

Në qoftë tërhiqet padia, gjykata do ta prishë me aktvendim urdhërpagesën.

Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e seancës kryesore heq dorë nga të gjitha kontestimet e bëra, urdhërpagesa mbetet në fuqi.

Kreu i tridhjetë

PROCEDURA NË KONTESTET E VLERËS SË VOGËL

Neni 457

Në qoftë se nuk ekzistojnë dispozita të veçanta të këtij kreu, në procedurën e kontesteve me vlerë të vogël do të aplikohen dispozitat e tjera të këtij ligji.

Neni 458

Kontestet e vlerës së vogël, në vështirim të dispozitave të këtij kreu janë kontestet në të cilat kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesa në të holla që nuk kapërcejnë shumën prej 1.000 dinarësh.

Si konteste të vlerës së vogël konsiderohen edhe konteste, në të cilat kërkesë-padia nuk ka të bëjë me kërkesa në të holla, kurse paditësi në padinë ka theksuar se e pranon që në vend të përmbushjes së kërkesës së caktuar të pranojë një shumë të caktuar të hollash që nuk e kapërcen shumën nga paragrafi 1 i këtij neni (neni 40 paragrafi 1).

Si konteste të vlerës së vogël konsiderohen edhe konteste në të cilat objekti i kërkesë-padisë nuk është shumë të hollash por dorëzim i sendit të luejtshëm, vlera e të cilit, që paditësi e ka theksuar në padinë, nuk e kapërcen shumën nga paragrafi 1 i këtij neni (neni 40 paragrafi 2).

Neni 459

Nuk konsiderohen konteste me vlerë të vogël, në kuptim të dispozitave të këtij kreu, kontestet mbi sendet e paluejtshme, kontestet nga marrëdhëniet e punës dhe kontestet për shkak të pengimit të posedimit.

Neni 460

Procedura në konteste me vlerë të vogël, do të zbatohet edhe me rastin e kundërshtimeve kundër urdhërpagesës, në qoftë se vlera e pjesës së kontestuar të urdhërpagesës nuk e kapërcen shumën prej 1.000 dinarësh.

Neni 461

Procedura në kontestet me vlerë të vogël zbatohet para gjykatave më të ulta të shkallës së parë, në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 462

Në procedurën në konteste me vlerë të vogël lejohet ankim i veçantë vetëm kundër aktvendimit, me të cilin përfundohet procedura.

Aktvendime të tjera, kundër të cilave sipas këtij ligji lejohet ankim, mund të kundërshtohen vetëm me ankim kundër vendimit, me të cilin përfundohet procedura.

Aktvendimet nga paragrafi 2 i këtij neni nuk u dërgohen palëve, por shpallen në seancë dhe përfshihen në përmbajtjen shkresore të vendimit.

Neni 463

Në procedurën në konteste me vlerë të vogël, procesverballi mbi shqyrtimin kryesor, përpos të dhënave nga neni 124 paragrafi 1 të këtij ligji, përmban:

- 1) deklaratat e palëve me rëndësi esenciale; e sidomos ato me të cilat, tërësisht apo pjesërisht, njihet kërkesë-padia ose hiqet dorë nga kërkesë-padia apo nga ankim, apo ndryshohet ose tërhiqet padia;
- 2) përmbajtjen esenciale të provave të theksuara;
- 3) vendimet kundër të cilave lejohet ankim dhe që janë shpallur në seancën kryesore;

4) nëse palët kanë qenë të pranishme në shpalljen e aktgjykimit dhe, po qe se kanë qenë të pranishme, se janë udhëzuar në kërkodita mund të bëjnë ankim.

Neni 464

Në qoftë se paditësi e ndryshon kërkesë-padinë, kështu që vlera e objektit të kontestit e kapërcen shumën prej 1.000 dinarësh, procedura do të përfundohet sipas dispozitave të këtij ligji mbi procedurën e zakonshme.

Në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës kryesore, që zhvillohet sipas dispozitës së këtij ligji mbi procedurën e zakonshme, e zvogëlon kërkesë-padinë, kështu që nuk e kapërcen shumën prej 1.000 dinarësh, procedura e mëtejshme do të zbatohet sipas dispozitave të këtij ligji mbi procedurën në kontestet me vlerë të vogël.

Neni 465

Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën e parë për në seancën kryesore, kurse është thirrur rregullisht, do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në qoftë se nga ndonjë seancë e mëvonshme mungojnë të dy palët, gjykata do ta shtyjë seancën. Po qe se edhe në këtë seancë nuk vijnë të dy palët, do të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.

Në procedurën në konteste me vlerë të vogël nuk aplikohen dispozitat e këtij ligji mbi pushimin e procedurës.

Në fletëthirrjen për në seancën kryesore do të theksohet, përveç tjerash, se do të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë po qe se nuk vjen në seancën e parë për në seancën kryesore, se në procedurën në kontestet me vlerë të vogël nuk aplikohen dispozitat mbi pushimin e procedurës dhe se në këtë procedurë palët duhet t'i parashirojnë të gjitha faktet dhe provat deri në përfundimin e seancës kryesore, sepse në ankimin kundër aktgjykimit nuk mund të parashirohen fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, si dhe që vendimi të mund të kundërshtohet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Neni 466

Aktgjykimi në procedurën në konteste me vlerë të vogël shpallet menjëherë pas përfundimit të seancës kryesore.

Kopja e aktgjykimit i dërgohet kurdoherë palës që nuk ka qenë e pranishme gjatë shpalljes, kurse palës që ka qenë e pranishme gjatë shpalljes i dërgohet vetëm me kërkesën e saj. Këtë kërkesë pala mund ta shirojë nëse vloni në seancën në të cilën aktgjykimi mund të shpallet.

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit gjykata ka për detyrë t'i udhëzojë palët e pranishme mbi kushtet në të cilat mund të bëjnë ankim (neni 467).

Neni 467

Aktgjykimi ose aktvendimi, me të cilin përfundohet kontesti në procedurën në konteste me vlerë të vogël, mund të kundërshtohet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 2 të këtij ligji dhe për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Në procedurën me rastin e ankimit në kontestet me vlerë të vogël nuk aplikohen dispozitat e nenit 370 të këtij ligji.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë, respektivisht kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, palët mund të bëjnë ankim brenda tetë ditësh.

Afati i ankimit llogaritet që nga dita e shpalljes së aktgjykimit, respektivisht të aktvendimit, e në qoftë se aktgjykimi, respektivisht aktvendimi i është dërguar palës, afati llogaritet që nga data e dërgimit.

Në procedurën në konteste me vlerë të vogël, afati nga neni 323 paragrafi 2 dhe nga neni 339 paragrafi 1 të këtij ligji është tetë ditë.

Ankimi ku janë shtruar shkaqet për të cilat ankimi nuk mund të bëhet do të hidhet poshtë si i palejuashëm.

Kundër vendimit të gjykatës të shkallës së dytë nuk lejohet revizioni.

Neni 468

Kur gjykata në kontest me vlerë të vogël (neni 458) konstaton se është kompetent dhe se s'ka arsye për hedhjen poshtë të padisë, respektivisht për cedin e objektit gjykatës kompetente ordinare apo gjykatës vetëqeverisëse (nenet 16 dhe 21), do t'ia cedojë padinë këshillit të pajtimit për të tentuar pajtimin.

Gjykata do t'ia cedojë padinë këshillit të pajtimit vetëm në qoftë se të dy palët kanë vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e tyre në territorin e së njëjtës komunë, apo në qoftë se janë të inkuadruara në punë në të njëjtën organizatë të punës së bashkuar apo në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse ku ekziston këshilli i pajtimit.

Në qoftë se brenda dy muajsh nga data e dërgimit të padisë gjykata merr prej këshillit të pajtimit raportin se palët janë pajtuar, apo se paditësi e ka tërhequr padinë, gjykata do ta hedhë poshtë padinë. Në qoftë se këshilli i pajtimit raporton se palët nuk i janë përgjegjur thirrjes për pajtim apo se tentativa e pajtimit nuk ka pasur sukses, ose në qoftë se në afatin e theksuar këshilli i pajtimit nuk e dërgon raportin mbi tentativën e pajtimit, gjykata do ta konvokojë seancën për seancën kryesore.

Kreu i tridhjetenjë

PROCEDURA PARA GJYKATAVE TË ARBITRAZHIT

Neni 469

Për kontestet mbi të drejtat që disponohen lirisht përveç për kontestet për të cilat është kompetente gjykata jugosllave në bazë të dispozitave të ligjit mbi kompetencën ekskluzive në kontestet me element ndër-kombëtar, palët mund të kontraktjnë kompetencën e gjykatës së arbitrazhit, në qoftë se njëra prej tyre është person i huaj fizik ose juridik.

Organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse munden që kontestet nga marrëdhëniet reciproke të cilat i rregullojnë vetë ose që rezultojnë nga e drejta që disponojnë lirisht, po qe se me ligj ose me aktin e përgjithshëm vetëqeverisëse në pajtim me ligjin nuk është përcaktuar që llojet e caktuara të kontestëve t'i zgjidhin vetëm gjykatat ordinare, gjykatat e punës së bashkuar ose gjykatat e tjera vetëqeverisëse, t'i parashirojnë para gjykatave të përhershme të arbitrazhit, të themeluara pranë odave ekonomike dhe organizatave të tjera të parashikuara me ligj.

Organizatat shoqërore dhe shoqatat e qytetarëve munden që kontestet nga marrëdhëniet reciproke që rezultojnë nga veprimtaria e tyre ekonomike, si dhe nga marrëdhëniet e tilla me personat shoqërorë-juridikë nga paragrafi 2 i këtij neni dhe me qytetarët nga paragrafi 4 i këtij neni mbi të drejtat që disponojnë lirisht, t'i parashirojnë para gjykatave të përhershme të arbitrazhit, të themeluara pranë odave ekonomike dhe organizatave të tjera të parashikuara me ligj.

Qytetarët që janë posedues të dyqaneve munden që kontestet nga marrëdhëniet reciproke që rezultojnë nga veprimtaria e tyre ekonomike, si dhe nga marrëdhëniet e tilla me personat shoqërorë-juridikë nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni mbi të drejtat që disponojnë lirisht, t'i shirojnë para gjykatave të përhershme të arbitrazhit pranë odave ekonomike dhe organizatave të tjera të parashikuara me ligj.

Kompetenca e gjykatave të arbitrazhit në raste të tjera mund të parashikohet vetëm me ligj.

Neni 470

Kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit mund të lidhet si në pikëpamje të kontestit të caktuar, ashtu edhe në pikëpamje të kontesteve të ardhshme që mund të rezultojnë nga marrëdhënia e caktuar juridike. Kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit është e plotëfuqishme vetëm në qoftëse se është përfunduar në formë të shkruar.

Kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit është përfunduar në formë të shkruar edhe kur përfundohet me anë të shkëmbimit të letrave, telegrameve ose të komunikimeve me teleprinterë.

Kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit mund të provohet vetëm me dokumente.

Neni 471

Kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit quhet e përfunduar në mënyrë të plotëfuqishme edhe kur dispozita mbi kompetencën e gjykatës së arbitrazhit është përmbatjur në kushtet e përgjithshme për përfundimin e veprimtimit juridik.

Neni 472

Numri i gjyqtarëve të gjykatës së arbitrazhit duhet të jetë tek.

Në qoftë se me kontratën e palëve nuk është caktuar numri i gjyqtarëve, secila palë cakton nga një gjyqtar, kurse këta zgjedhin kryetarin.

Gjyqtarët e gjykatave ordinare dhe gjyqtarët që punojnë në gjykatat e punës së bashkuar mund të zgjedhen vetëm kryetar të gjykatës së arbitrazhit.

Neni 473

Në qoftë se palët për vendosjen mbi kontestin e caktuar kanë kontraktuar kompetencën e gjykatës së arbitrazhit, gjykata të cilës i është paraqitur padia në të njëjtin kontest dhe midis palëve të njëjta në kundërshtimin e të paditurit, do të shpallet inkompetente, do t'i prishë veprimet e zbatuara në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Kundërshtimin nga paragrafi 1 i këtij neni i padituri mund ta bëjë jo më vonë se në seancën pregaditore, e po që se seanca pregaditore nuk mbahet, atëherë në seancën kryesore para se të hyjë në shqyrtim rreth çështjes kryesore.

Neni 474

Palën e cila sipas kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit duhet ta caktojë gjyqtarin e gjykatës së arbitrazhit, mund ta thërras pala kundërshtare që brenda pesëmbëdhjetë ditësh ta kryejë këtë caktim dhe ta njoftojë për këtë gjë.

Thirrja në vështirësi të paragrafit 1 të këtij neni është e plotëfuqishme vetëm në qoftë se pala që e dërgon cakton gjyqtarin e vet të arbitrazhit dhe për këtë gjë njofton palën kundërshtare.

Kur sipas kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit caktimin e gjyqtarit duhet ta bëjë personi i tretë, secila palë mund t'i drejtojë këtij personi thirrjen e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Personi që është thirrur që të emrojë gjyqtarin e gjykatës së arbitrazhit është i obliguar për caktimin që është bërë posa ky caktim t'i jetë komunikuar kundërshtarit, respektivisht njerës nga palët.

Neni 475

Në qoftë se gjyqtari i gjykatës së arbitrazhit nuk caktohet në kohën e duhur, kurse nga kontrata nuk rezulton dishka tjetër, gjyqtarin do ta caktojë gjykata me propozimin e palës.

Në qoftë se gjyqtarët e zgjedhur nuk mund të pajtohen rreth zgjedhjes së kryetarit, kurse nga kontrata nuk rezulton dishka tjetër, kryetarin do ta caktojë gjykata, me propozimin e secilit gjyqtar apo të palës.

Për caktimin e gjyqtarit, respektivisht të kryetarit të gjykatës së arbitrazhit, është kompetente gjykata e

cila do të ishte kompetente për kontestin në shkallë të parë po të mos ishte përfunduar kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit.

Kundër aktvendimit të gjykatës nuk lejohet ankimi.

Pala që nuk dëshiron ta shfrytëzojë autorizimin nga paragrafi 1 ose nga paragrafi 2 i këtij neni mund të kërkojë me anë të padisë që gjykata kompetente për caktim të shpallë shuarjen e vlerës së kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit.

Neni 476

Përveç rastit nga neni 475 i këtij ligji, secila palë mund të kërkojë me anë të padisë që gjykata ta shpallë shuarjen e vlerës së kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit:

1) në qoftë se palët nuk mund të pajtohen mbi zgjedhjen e gjyqtarëve që ato duhet bashkërisht t'i caktojnë;

2) në qoftë se personi që në vetë kontratën mbi gjykatën e arbitrazhit është caktuar gjyqtar i gjykatës së arbitrazhit nuk dëshiron ose nuk mundet ta ushtrtojë këtë detyrë.

Rreth kërkesës vendos gjykata e parashikuar në nenin 475 paragrafi 3 të këtij ligji.

Në seancën për shqyrtim mbi kërkesën gjykata do t'i thërras palët, por gjykata mund ta marrë vendimin edhe në rastin kur palët që janë thirrur rregullisht nuk vijnë.

Neni 477

Gjyqtari i gjykatës së arbitrazhit ka për detyrë të përjashtohet kur ekzistojnë shkaqet e përjashtimit të parashikuara në nenin 71 të këtij ligji. Për të njëjtat shkaqe palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës së arbitrazhit.

Pala që e ka caktuar vetë, apo së bashku me palën kundërshtare gjyqtarin e arbitrazhit, mund të kërkojë përjashtimin e tij vetëm në qoftë se shkak i përjashtimit ka lindur, ose pala ka mësuar për te pasi është caktuar gjyqtari i arbitrazhit.

Në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe, mbi përjashtimin vendos gjykata e parashikuar në nenin 475 paragrafi 3 të këtij ligji.

Neni 478

Në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe, gjyqtarët e arbitrazhit do të caktojnë procedurën para gjykatës së arbitrazhit.

Neni 479

Dëgjimi i dëshmitarëve para gjykatës së arbitrazhit bëhet pa bërë betimin.

Ndaj dëshmitarëve, palëve dhe personave të tjerë që marrin pjesë në procedurë, gjykata e arbitrazhit nuk mund të përdorë mjete të dhunës dhe as të japë dënime.

Gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë nga gjykata ordinare, me kompetencë territoriale për dhënie e ndihmës juridike (neni 179), që të paraqes prova të veçanta të cilat vetë nuk ka mundësi t'i paraqes. Ndaj procedurës për paraqitjen e provave do të aplikohen dispozitat e këtij ligji mbi paraqitjen e provave para gjyqtarit të lutur.

Neni 480

Kur gjykata e arbitrazhit përbëhet nga më tepër se një gjyqtar, aktgjykimi jepet me shumicën e votave, në qoftë se në kontratën mbi gjykatën e arbitrazhit nuk është caktuar ndryshe.

Në qoftë se nuk mund të realizohet shumica e nevojshme e votave, gjykata e arbitrazhit ka për detyrë t'i njoftojë palët për këtë gjë.

Në qoftë se për rastin nga paragrafi 2 i këtij neni palët nuk janë marrë vesh ndryshe, secila prej tyre mund të kërkojë me anë të padisë që gjykata e parashikuar në nenin 475 paragrafi 3 të këtij ligji të

caktotë shuarjen e vlerës së kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit.

Neni 481

Aktgjykimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të jetë i arsyetuar, në qoftë se palët nuk kanë kontraktuar dishka tjetër.

Origjinali i aktgjykimit dhe të gjitha kopjet i nënshkruajnë të gjithë gjyqtarët e arbitrazhit. Aktgjykimi vlen edhe kur gjyqtari nuk e nënshkruan aktgjykimin po qe se e kanë nënshkruar shumica e gjyqtarëve dhe në qoftë se në aktgjykim është konstatuar mungesa e këtij nënshkrimi.

Palëve u dërgohen kopjet e aktgjykimit me anë të gjykatës së parashikuar në nenin 475 paragrafi 3 të këtij ligji. Gjykatat e përhershme të arbitrazhit bëjnë vetë dërgimin e aktgjyqimeve të veta.

Neni 482

Origjinali i aktgjykimit, si dhe vërtetimet mbi dërgimin e bërë ruhen pranë gjykatës të parashikuar në nenin 475 paragrafi 3 të këtij ligji, e në qoftë se aktgjykimin e ka dhënë gjykata e përhershme e arbitrazhit, atëherë pranë kësaj gjykate.

Neni 483

Aktgjykimi i gjykatës së arbitrazhit ka ndaj palëve fuqinë e aktgjykimit të formës së prerë, në qoftë se me kontratë nuk është parashikuar shumësia e kundërshtimit të aktgjykimit para gjykatës së arbitrazhit të shkallës më të lartë.

Me kërkesën e palës, gjykata e parashikuar në nenin 485 paragrafi 3 të këtij ligji, do të vejë në kopjen e aktgjykimit vërtetimin mbi formën e prerë dhe mbi ekzekutueshmërinë. Gjykatat e përhershme të arbitrazhit vejnë vetë vërtetimin mbi formën e prerë dhe mbi ekzekutueshmërinë në aktgjykimet e veta.

Neni 484

Aktgjykimi i gjykatës së arbitrazhit mund të anulohet në bazë të padisë së palës.

Për të vendosur në bazë të padisë është kompetente gjykata që parashikon neni 475 paragrafi 3 të këtij ligji.

Neni 485

Anulimi i aktgjykimit të gjykatës së arbitrazhit mund të kërkohej:

1) në qoftë se nuk është përfunduar fare kontrata mbi gjykatën e arbitrazhit, apo në qoftë se kjo kontratë nuk ka qenë e plotëfuqishme (nenet 469 deri 471);

2) në qoftë se në pikëpamje të përbërjes së gjykatës së arbitrazhit, apo në pikëpamje të vendosjes është shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, apo të kontratës mbi gjykatën e arbitrazhit;

3) në qoftë se aktgjykimi nuk është arsyetuar në kuptim të nenit 481 paragrafi 1 të këtij ligji, apo në qoftë se origjinalin dhe kopjet e aktgjykimit nuk janë nënshkruar sipas mënyrës së caktuar në nenin 481 paragrafi 2 të këtij ligji;

4) në qoftë se gjykata e arbitrazhit e ka kapërcyer kufirin e detyrës së vet;

5) në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, apo kontradiktor me vetvetë;

6) në qoftë se gjykata e arbitrazhit e ka gjykuar palën me një veprim të atillë që sipas ligjit nuk lejohet ose është përgjithësisht i ndaluar;

7) në qoftë se ekziston ndonjë nga shkaqet e përsëritjes së procedurës nga neni 421 i këtij ligji.

Neni 486

Padia për anulimin e aktgjykimit të gjykatës së arbitrazhit mund të paraqitet gjykatës kompetente brenda tridhjetë ditësh. Në qoftë se anulimi kërkohej për shkaqet e theksuara në nenin 485 pikat 1 deri 6 të këtij ligji, ky afat llogaritet që nga dita kur

aktgjykimi ti jetë dërguar palës, e në qoftë se pala ka mësuar më vonë për shkakun, atëherë që nga dita e mësimit. Në pikëpamje të llogaritjes së afatit kur kërkohej anulimi nga shkakun i theksuar në nenin 485 pika 7 të këtij ligji, do të aplikohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 423 paragrafet 1 dhe 2 të këtij ligji.

Pasi të kenë kaluar pesë vjet nga dita kur aktgjykimi i gjykatës së arbitrazhit të ketë marrë formën e prerë, nuk mund të kërkohej anulimi i këtij aktgjykimi.

Neni 487

Palët nuk mund të heqin dorë me marrëveshje nga aplikimi i dispozitave të nenit 477 paragrafet 1 dhe 2, të nenit 481 paragrafet 2 dhe 3 dhe të nenit 484 deri të nenit 486 të këtij ligji.

Kreu i tridhjetedytë

PROCEDURA NË KONFLIKTET EKONOMIKE

Sfera e aplikimit

Neni 488

Në procedurën në konfliktet ekonomike do të aplikohen dispozitat e këtij ligji, në qoftë se në dispozitat e këtij kreu nuk është caktuar dishka tjetër.

Neni 489

Rregullat mbi procedurën në konfliktet ekonomike aplikohen:

1) në kontestet ku të dy palët janë bashkësitë shoqërore-politike, organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit apo organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse;

2) në kontestet që kanë të bëjnë me anijet dhe me lundrimin në det e në ujrat e brendshme, si dhe në kontestet ndaj të cilave aplikohet e drejta e lundrimit (kontestet e lundrimit) përveç kontesteve në transportin e udhëtarëve.

Neni 490

Rregullat mbi procedurën në konfliktet ekonomike aplikohen edhe në kontestet midis personave nga neni 489 pika 1 të këtij ligji dhe personave të huaj fizikë e juridikë, që rezultojnë nga marrëdhëniet e tyre ekonomike reciproke, si dhe në konteste të tilla reciproke të personave të huaj fizikë ose juridikë.

Neni 491

Rregullat mbi procedurën në konfliktet ekonomike aplikohen edhe kur në konflikt, përpos personave nga neni 489 pika 1 dhe të nenit 490 të këtij ligji, si bashkëndërgjyqësia nga neni 196 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji marrin pjesë edhe persona të tjerë fizikë apo juridikë.

Kompetenca dhe përbërja e gjykatës

Neni 492

Në kontestet për vërtetimin e qenies apo të mosqenies së kontratës, për zbatimin ose zgjidhjen e kontratës, si dhe në kontestet për shpërbimin e dëmit për shkak të moszbatimit të kontratës, përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, me kompetencë territoriale është edhe gjykata e vendit ku, sipas marrëveshjes së palëve, i padituri ka për detyrë ta zbatojë kontratën.

Neni 493

Kur gjykata gjykon në procedurën e konflikteve ekonomike në shkallë të parë, kolegji përbëhet prej një gjyqtari si kryetar i kolegjit dhe dy ndihmësgjyqtarëve.

Kur gjykon në shkallë të dytë në seancën e kolegjit, kolegji përbëhet prej dy gjyqtarëve, një nga

të cilët është kryetari i kolegjit, dhe prej një ndihmësgjyqtari.

Neni 494

Në procedurën në konfliktet ekonomike gjyqtari i vetëm gjykon në qoftë se vlera e objektit të konfliktit nuk është mbi 30.000 dinarë.

Gjyqtari i vetëm zbaton procedurën dhe merr vendime në objektet e ndihmës juridike dhe të sigurimit të provave.

Pregaditja e seancës kryesore

Neni 495

Në procedurën në konfliktet ekonomike padia kurdoherë do t'i dërgohet të paditurit në përgjigje.

Pas marrjes së përgjigjes në padi ose pasi të ketë kaluar afati për përgjigje në padinë, kryetari i kolegjit do të vendos nëse do të konvokojë seancën pregaditore ose seancën për seancën kryesore. Seanca pregaditore do të konvokohet vetëm në qoftë se kjo, duke marrë parasysh ndëlikueshmërinë e objektit dhe rrethanat e tjera, do të kontribuonte në zgjidhjen më të shpejtë apo më të lirë të kontestit.

Në rastet urgjente kryetari i kolegjit mundet, menjëherë pas ekzaminimit paraprak të padisë, të konvokojë seancën pregaditore ose seancën për seancën kryesore. Kundër këtij vendimi të kryetarit të kolegjit nuk lejohet ankimi.

Kryetari i kolegjit është i autorizuar që në rastet urgjente të konvokojë seancën me telefon ose telegram.

Neni 496

Kur pasi të ketë marrë përgjigjen në padinë kryetari i kolegjit vërteton se midis palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për marrjen e vendimit, mund ta marrë vendimin mbi kontestin pa e thirrur seancën.

Mjetet juridike

Neni 497

Revizioni në konfliktet ekonomike nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit të pjesës së kundërshtuar të aktgjykimit të formës së prerë nuk është mbi 30.000 dinarë.

Revizioni në konfliktet ekonomike është kurdoherë i lejueshëm në konfliktet nga neni 382 paragrafi 4 pika 3, 4 dhe 5 të këtij ligji.

Dispozita të tjera

Neni 498

Në qoftë se të dy palët propozojnë me marrëveshje që seanca të shtyhet për të tentuar pajtimin, gjykata do ta aprovojë këtë propozim dhe menjëherë do t'i njoftojë palët mbi ditën dhe orën se kur do të mbahet seanca e re.

Neni 499

Përfundimisht nga dispozita e nenit 216 paragrafi 1 të këtij ligji, nuk do të vijë pushimi i procedurës në qoftë se në seancën pregaditore ose në seancën e parë për në seancën kryesore mungojnë të dy palët.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do ta shtyjë seancën, e në qoftë se edhe në seancën tjetër nuk vijnë të dy palët, do të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.

Neni 500

Në procedurën në konfliktet ekonomike vlejnë këto afate:

1) afati prej 30 ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme nga neni 118 paragrafi 3 të këtij ligji;

2) afati prej tetë ditësh për ankim kundër aktgjykimit, respektivisht aktvendimit, kurse afati prej tre ditësh për paraqitjen e përgjigjes në ankim.

Neni 501

Në procedurën në konfliktet ekonomike palët nuk mund të japin jashtë seancës deklarata verbale në procesverbal pranë gjykatës.

Dokumenti në bazë të të cilit lëshohet urdhërpagesa sipas nenit 446 të këtij ligji nuk duhet t'i bashkangjitet medoemos origjinalit ose kopjes së legalizuar. Mjafton që kopja e dokumentit të tillë të jetë legalizuar nga organi i autorizuar i personit juridik.

Në procedurën në konfliktet ekonomike nuk do të aplikohen dispozitat e nenit 447 të këtij ligji.

Neni 502

Në procedurën në konfliktet ekonomike, kontestet me vlerë të vogël janë konteste ku kërkesë-padia ka të bëjë me kërkesë të hollash që nuk është mbi 5.090 dinarë.

Si konteste me vlerë të vogël konsiderohen edhe kontestet ku kërkesë-padia nuk ka të bëjë me kërkesë të hollash, kurse paditësi në padinë ka theksuar se e pranon që në vend të përmbushjes së kërkesës së caktuar të pranojë shumën e caktuar të hollash që nuk e kapërcen shumën nga paragrafi 1 i këtij neni (neni 40 paragrafi 1).

Si konteste me vlerë të vogël konsiderohen edhe kontestet ku objekti i kërkesë-padisë nuk është shumë të hollash, por dorëzim i sendit të luejtshëm, vlera e të cilit, që e ka theksuar paditësi në padinë, nuk është mbi shumën nga paragrafi 1 i këtij neni (neni 40 paragrafi 2).

Në procedurën në kontestet me vlerë të vogël në konfliktet ekonomike padia nuk i dërgohet të paditurit në përgjigje.

Pjesa e katërt

Kreu i tridhjetetretë

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR PROCEDURËN PARA GJYKATËS FEDERATIVE NË KONTESTET PASURORE MIDIS REPUBLIKAVE, RESPEKTIVISHT KRAHINAVE AUTONOME DHE MIDIS FEDERATËS DHE REPUBLIKËS, RESPEKTIVISHT KRAHINËS AUTONOME

Neni 503

Në procedurën para Gjykatës Federative në kontestet pasurore midis republikave, respektivisht krahinave autonome dhe midis Federatës dhe republikës, respektivisht krahinës autonome do të aplikohen dispozitat e kreut të parë deri në kreun e njëzetekatërt dhe të kreut njëzetegjashtë, kapitna e pestë, të këtij ligji, në qoftë se në nenet pasuese nuk është caktuar dishka tjetër.

Neni 504

Në procedurën para Gjykatës Federative pushimi i procedurës vjen vetëm në qoftë se palët për këtë gjë mirren vesh para përfundimit të seancës kryesore.

Gjykata Federative do t'i dërgojë kurdoherë padinë të paditurit në përgjigje. Afati i paraqitjes së padisë në padinë do të caktohet nga kryetari i kolegjit, vartësisht nga karakteri dhe ndërlikueshmëria e kontestit.

Në procedurën para Gjykatës Federative nuk aplikohen dispozitat e nenit 332 të këtij ligji.

Neni 505

Vendimi i Gjykatës Federative, i nxjerrë në shkallë të parë, ka formën e prerë.

Neni 506

Kundër vendimit të Gjykatës Federative nga neni 505 i këtij ligji palët mund të paraqesin kërkesën

për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit brenda gjashtë muajsh nga data e dërgimit të vendimit. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet vetëm për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Mbi kërkesën e palëve vendos Gjykata Federative në përbërjen e caktuar në nenin 45 të këtij ligji.

Kopjen e kërkesës Gjykata Federative do t'ia dërgojë palës kundërshtare, e cila brenda tre muajsh nga data e dërgimit të kërkesës mund të deklarohet mbi kërkesën e paraqitur.

Neni 507

Në procedurën me rastin e kërkesës nga neni 506 i këtij ligji përshtatshmërisht vihen në zbatim dispozitat e neneve 386, 392, 393, 395 dhe 414 paragrafet 1 dhe 2 të këtij ligji.

Pjesa e pestë

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 508

Në qoftë se para hyrjes në fuqi të këtij ligji është dhënë aktgjykim i shkallës së parë apo aktvendimi, me të cilin përfundohet procedura para gjykatës të shkallës së parë, procedura e mëtejshme do të zbatohet sipas dispozitave të deritashme.

Në qoftë se pas hyrjes në fuqi të këtij ligji prishet vendimi i shkallës së parë nga paragrafi 1 i këtij neni, procedura e mëtejshme do të zbatohet sipas këtij ligji.

Mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është ngritur para gjykatës kompetente sipas dispozitave të deritashme, do të vendoset sipas këtyre dispozitave.

Neni 509

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten pa fuqi:

1) Ligji mbi procedurën kontestimore («Gazeta Zyrtare e RPFJ», Nr. 4/57 dhe 52/61 dhe «Gazeta Zyrtare e RSFJ», Nr. 12/65, 1/71 23/72 dhe 6/74);

2) Ligji mbi zgjidhjen e konflikteve nga marrëdhëniet afare reciproke të organizatave të punës së bashkuar para gjykatave të përhershme të arbitrazhit («Gazeta Zyrtare e RSFJ», Nr. 22/73);

3) Dispozitat e neneve 40 deri 45 të Ligjit mbi Gjykatën Federative («Gazeta Zyrtare e RSFJ», Nr. 21/74).

Dispozitat e Ligjit mbi procedurën kontestimore rreth kompetencës lëndore e mbi procedurën e konflikteve martesore e mbi konfliktet për vërtetimin dhe kontestimin e atësisë vlejné, në vështrim të neneve 14 dhe 15 paragrafi 2 të Ligjit kushtetues mbi zbatimin e Kushtetutës së RSFJ, deri në ditën e caktuar me ligjin republikan, respektivisht me ligjin krahinor.

Neni 510

Deri në miratimin e ligjit mbi procedurën përmbartimore, në pikëpamje të kompetencës së gjykatës për të vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të prokurorit publik kompetent kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të miratuara në procedurën përmbartimeve, të kushteve për paraqitjen e kërkesave e të procedurës, do të vihen përshtatshmërisht në zbatim dispozitat e këtij ligji (nenet 401 deri 415).

Neni 511

Dispozitat e nenit 408 të këtij ligji do të aplikohen prej ditës së caktuar me ligjin republikan, respektivisht me ligjin krahinor.

Neni 512

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 1977.

30.

Në mbështetje të nenit 337 pika 1 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nxjerri këtë

D E K R E T

MBI SHPALLJEN E LIGJIT MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT MBI PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Shpallet Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative më 24 dhjetor 1976.

PR Nr. 554

Beograd, më 24 dhjetor 1976

Kryetari i Republikës,
Josip Broz Tito, d. v.

Kryetari,
i Kuvendit të RSFJ,
Kiro Gligorov, d. v.

L I G J

MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT MBI PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 1

Në Ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative («Gazeta Zyrtare e RSFJ», Nr. 18/65), në nenin 1 paragrafi 1, fjalët: «organet e administratës shtetërore» zëvendësohen me fjalët: «organet e administratës së bashkësive shoqërore-politike».

Paragrafi 2 ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: «(2) Sipas këtij ligji kanë për detyrë të veprojnë edhe organizatat e punës së bashkuar, organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, organizatat shoqërore, shoqatat e qytetarëve dhe organizatat e tjera (në tekstin e mëtejshëm: organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse), kur në ushtrimin e autorizimeve publike, që u janë besuar me ligj dhe me vendim të kuvendit të komunës të bazuar në ligj, vendosin në çështjet nga paragrafi 1 i këtij neni.»

Neni 2

Në nenin 4 paragrafi 1 ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje:

«(1) Organet, organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse që veprojnë në çështjet administrative e vendosin në bazë të ligjit, të dispozitave të tjera të organeve shtetërore dhe në bazë të akteve të përgjithshme vetëqeverisëse të organizatave e të bashkësive vetëqeverisëse që i miratojnë ato në bazë të autorizimeve publike.»

Neni 3

Pas nenit 5 shtohet emërtimi i kaptinës së re dhe të nenit 5a, me këtë përmbajtje:

«Parimi i efikasitetit

Neni 5a

Kur organet, organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse vendosin në çështjet administrative, kanë për detyrë të sigurojnë realizimin efikas të të drejtave dhe të interesave të punonjësve e të qytetarëve, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse.»

Neni 4

Në nenin 9 paragrafi 1 fjalët: «autorizimi ligjor» zëvendësohen me fjalët: «autorizimet e dhëna me ligj».